

Arkitektura
Tradicionale dhe Metodat
e Dokumentimit

Traditional
Architecture and Documentation
Methodologies

CH
WB

Cultural
Heritage without Borders
KULTURIKU LINDAN GRANDES



Dokumentimi
i shtatë shtëpive tradicionale
në Prizren

Documentation
of seven traditional houses
in Prizren

Arkitektura

Tradicionale dhe Metodat
e Dokumentimit

Traditional

Architecture and Documentation
Methodologies

Përmbajtja / Contents

1 Hyrje - Arkitektura tradicionale e Prizrenit
Introduction -Traditional Architecture in Prizren

2 Parathënie
Foreword

3 Rreth projektit
About the project

Faza I / Phase I

4 Raport i projektit “Dokumentimi i shtëpive tradicionale në Prizren” – Shqipe Nixha
Project Report: “The Documentation of Traditional Houses in Prizren” – Shqipe Nixha

5 Shtëpitë e rilevuara 1-2
The Documented Houses 1-2

Shtëpia e Familjes Mullafazliu / Mullafazliu House
Shtëpia e Familjes Rekathati / Rekathati House

6 Faza II
Phase II

Kursi 17 – Arkitektura Tradicionale dhe metodat e dokumentimit / Project development

7 Ligjëratat Lecture Series

Ligjëratat e Emin Rizës / By Emin Riza:

Arkitektura tradicionale në rajon / Traditional Architecture of the Region
Banesa Qytetare Kosovare e Shekujve XVIII-XIX dhe Klasifikimi i saj
Kosovan Urban Dwellings of 18th and 19th centuries and their classification
Dokumentimi i monumenteve / The Documenting of Monuments

Ligjëratat e Teuta Jashari / By Teuta Jashari:

Metodat e Dokumentimit / Documentation Methodologies

8 Shtëpitë e rilevuara 3-7 The Documented Houses 3-7

Shtëpia e Familjes Bajmaku / Bajmaku House
Shtëpia e Familjes Bërlajolli / Bërlajolli House
Shtëpia e Familjes Kirajtani / Kirajtani House
Shtëpia e Familjes Mashkulli / Mashkulli House
Shtëpia e Familjes Qyse / Qyse House

9 Evaluimi Evaluation

10 Përvoja nga terreni Experiences from field

11 Falënderimet Acknowledgements

12 Ekipi realizues i publikimit Project team

CH
WB

Cultural
Heritage without Borders
KULTURARV UTAN GRÄNSER

Hyrje / Introduction

Shpesh i referuar si Kryeqyteti Kulturor i Kosovës, Prizreni është njëri prej qyteteve më të pasura me trashëgimi kulturore në Kosovë. Trashëgimia kulturore e Prizrenit shprehet në formën e saj ndërtimore dhe shpirtërore. Xhamitë, Kishat, Teqetë, Urat, Shtëpitë e vjetra tradicionale, lokalitetet arkeologjike, na dëshmojnë për një nivel të lartë të zhvillimit kulturor të qytetit prej antikitetit e deri në ditët e sotme. Kultu- ra shpirtërore e shprehur në jetën shoqërore dhe fetare të qytetarëve të Prizrenit e pasuron edhe më shumë mozaikun, duke i dhënë kuptim traditës dhe mënyrës së jetesës në Prizren.

Krahas objekteve fetare të njohura, në Prizren gjenden edhe një numër i madh i shtëpive të vjetra tradicionale, të ndërtuara në mes të shekujve XVIII-XIX, të cilët kanë vlerë të lartë reprezentative. Në lidhje me karakteristikat arkitektonike dhe urbanistike të objekteve banuese të shek- ullit XVIII-XIX-XX, flasin shumë shembuj të ruajtur, raporte të shkruara dhe hulumtime shkencore dhe profesionale, shtëpi tradicionale karakteristike, të cilat janë ndërtuar nga bejlerët, zanatlinjtë dhe titullarët e asaj kohe. Këto objekte na mundësojnë të kuptojmë shumë në lidhje me zhvillimin e funksionit dhe karakteristikat ndërtimore, arkitektonike dhe urbanistike, mënyrën e jetesës në ato kohë, njëkohësisht kanë vlerë të veçantë në zhvillimin e formësimit arkitektonik të qytetit dhe më gjerë.

Deri në ditët e sotme kanë mbijetuar një numër i caktuar i shtëpive, si: Shtëpia e Musa Shehzades, familjes Pomaku, Adem Aga Gjonit, familjes Grazhdo, familjes Dukagjini, e shumë shtëpi tjera që karakterizohen me

Prizren, often referred to as the 'cultural capital of Kosovo', is also one of the cities richest in cultural heritage in the Balkans. This is represented through its methods of construction and a wealth of sacred and civic monuments (consisting of mosques, churches, tekkes and bridges as well as traditional houses) with archaeological investigations testifying to a high level of cultural development dating from prehistoric and Roman times. Its spiritual monuments complete the rich urban mosaic by giving meaning to the social and religious traditions and ways of life of the town. In addition to religious edifices, Prizren's cultural assets also comprise numerous traditional vernacular dwellings, constructed during the 18th and 19th centuries, and about which there have been many professional, scientific analyses documenting the architectural and urban characteristics of these residential buildings. These buildings' architectural and urban characteristics enable us to understand the evolution of function and development of construction, and play a vital role in the architectural expression of Prizren and its surroundings.

Some of these valued buildings have survived until now - the houses of Musa Shehzade, the Pomaku, Grazhdo and Dukagjini families, and of Adem Aga Gjoni – among many others that are characterised by their spatial arrangements and rich interiors. A number of them have already been documented while a considerable number are still waiting to be recorded.

Changing political, social and economic contexts, alterations in climate,

mënyrën e formësimit hapësinor të tyre dhe me elementet e pasura të enterierit.

Një numër i tyre janë inventarizuar dhe dokumentuar, përderisa për një numër të konsiderueshëm, nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm.

Koha, ndryshimet klimatike, neglizhenca e njerëzve, moskujdesi, mungesa e fondeve, janë disa prej faktorëve që kanë ndikuar që shumë shtëpi të jenë në gjendje mjaft të vështirë fizike. Krahas sigurimit të fondeve për restaurimin e këtyre objekteve, hap me rëndësi është edhe dokumentimi i tyre. Kjo do të ndikonte në pasurimin e arkivit të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve dhe në përjetësimin e këtyre objekteve përmes prezantimit grafik. Po ashtu, dokumentimi do të ishte një prej hapave më modest dhe fillestar që do të mund të ndërmerrej në ruajtjen, restaurimin dhe, pse jo, edhe të promovimit të tyre.

negligence and inadequate maintenance, and a desperate lack of funds are the main factors which have resulted in the dereliction of these houses. Besides financial support for restoration projects, a crucial first step is the documentation of these buildings. This allows their inclusion in the archive of the Kosovo Institute for the Protection of Monuments (KIPM) and, as a detailed graphical record, ensures the buildings remain comprehensible and relevant to future generations.

Parathënie / Foreword

Dokumentimi i ndërtesave nënkupton mbledhjen e të dhënave grafike dhe tekstuale për një ndërtesë historike. Dokumentimi është bazë për të krijuar idenë e hapësirës së ndërtesës dhe ndërlidhjen e saj me rrethinën. Kjo, pastaj do të ndihmon vrojtuesit për të kuptuar kontekstin shoqëror dhe kulturor të njerëzve në periudha të ndryshme historike. Ndërtesat sjellin dëshmitë, gjurmët historike dhe përmes tyre është lehtë pastaj të ndërtohen situata historike që do të ndihmonin për të ndërtuar/kuptuar identitetin e njeriut/komunitetit. Në të njëjtën kohë dokumentimi ndihmon në fazat e restaurimit dhe konservimit të ndërtesave.

Në Kosovë ka shumë pak ndërtesa të dokumentuara. Nuk dihet saktë numri i atyre që janë dokumentuar, për shkak se materiali dokumentar është i pasistemuar dhe i ruajtur në vende/depo me kushte të pavolitshme. Ka raste që materiali arkivor është edhe i humbur.

Kjo situatë e vështirëson punën në terren, sidomos në raste kur ndërtesat janë të dëmtuara ose kur pjesët e tyre janë humbur. Kësisoj, mungesa e dokumentacionit hap rrugë për spekulime. Spekulumet me ndërtesa historike janë joprofesionale dhe, si të tilla, ndalohen përmes konventave ndërkombëtare - Karta e Venedikut.

Nga kjo situatë, duhet të nxjerrim mësim: Të gjitha ndërtesat historike duhet të dokumentohen dhe të arkivohen! Sot është e mundur që i gjithë dokumentimi të bëhet me teknologji të avancuar. Arkivimi, gjithashtu mund të sistemohet në arkiva digjitale, të cilat duhet të jenë në dispozicion të publikut, veçmas të profesionistëve dhe shkollarëve.

The documentation of buildings provides a resource of graphical and textual information related to an historic building. It reveals the basic spatial concept of that building and its interconnection with its surrounding context, which will later aid researchers in understanding the social and cultural configuration of a particular society throughout different periods in its history. The built environment is tangible historical evidence of the development of concepts of identity, whether individual or communal. Equally, documentation helps in later phases of the conservation and restoration of buildings.

The small number of documented buildings in Kosovo remains an estimate since the material collected is not systemised and is kept in storage under poor conditions; there have also been occasions when these records have been lost. This situation makes field work harder, especially in the cases where buildings are damaged or partially ruined. The lack of documentation generates speculation which is an inaccurate and unprofessional approach, and is forbidden by international treaties such as the Charter of Venice.

It is important that all historic buildings be documented and inventoried, a process which is now facilitated through advanced technologies and the use of digital archives, and which should be at the public's disposal, especially to professionals and students in this field. Cultural Heritage without Borders (CHwB), in collaboration with the University of Prishtina, Prishtina International University (PISU)

CHWB, në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, Universitetin Veror dhe Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren, zhvilloi projektin për dokumentimin e disa shtëpive tradicionale në Prizren. Ishte kjo një përpjekje për të nënvizuar rëndësinë e Dokumentimit. Përveç kësaj, bashkërisht arritëm që në arkivat këtyre institucioneve, sot të jenë të ruajtur edhe shtatë dosje me të dhënat për shtatë ndërtesa historike.

Sali Shoshi

Udhëheqës i OJQ Trashëgimia Kulturore pa Kufij, zyra në Kosovë

and the Institute for the Protection of Monuments in Prizren (IPMPz), implemented a project for the documentation of traditional houses in Prizren. This resulted in the inclusion within the institutional archives of several dossiers of data relating to seven historic buildings.

This report aims to highlight the appropriate methodologies for and the importance of the documentation of historic buildings in Kosovo.

Sali Shoshi

Cultural Heritage without Borders, Head of Kosovo office

Rreth projektit / About this project

Qëllimi i këtij projekti hulumtues dhe edukativ është ngritja e kapaciteteve të profesionistëve dhe studentëve të cilët merren me studimin dhe dokumentimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, siç janë shtëpitë tradicionale të Prizrenit, duke i kontribuar procesit të gjithëmbarshëm të dokumentimit dhe të promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore kombëtare të Kosovës.

Partnerët e përfshirë në implementimin e projektit janë:

Trashëgimia Kulturore pa Kufij, CHwB

Instituti për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren

Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës – Drejtimi Arkitekturë

Universiteti Ndërkombëtar Veror i Prishtinës

Palët e mësipërme nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit dhe ndanë përgjegjësitë për zbatimin e projektit. Mbase kjo është një ndër praktikat më të mira për një gjithëpërfshirje të Institucioneve përgjegjëse të edukimit dhe të përkujdesjes ndaj trashëgimisë.

Projekti është zhvilluar në dy faza.

The aim of this project is to improve the capacity of professionals and students involved in the recording of valuable assets of vernacular cultural heritage of Kosovo, such as the traditional houses of Prizren, and which, as live research and education projects, contribute to the overall process of documentation and promotion of national heritage buildings.

The partners involved in the implementation process were:

Cultural Heritage without Borders, CHwB

The Institute for the Protection of Monuments, Prizren

Faculty of Civil Engineering and Architecture, University of Prishtina

Architecture Department, Prishtina International Summer University

The above parties signed a Memorandum of Understanding where the responsibilities and obligations of each were clearly determined within the project's implementation.

It presents a guide to best practice for the involvement of responsible institutions in the education about and protection of cultural heritage.

The project consisted of two phases.

Faza I

Në fazën e parë matjet e dy shtëpive tradicionale janë zhvilluar në kuadër të lëndës Mbrojtja e Trashëgimisë Arkitekturore, në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.

Dy grupe të studentëve, kanë kryer riveimin dhe studimin e dy shtëpive tradicionale në Prizren, Shtëpia e Familjes Mullafazliu dhe Rakathati, të përzgjedhura nga Instituti për Mbrojtje të Monumenteve, Prizren.

Riveimet e këtyre shtëpive janë zhvilluar gjatë muajit prill 2010, kurse përpunimi grafik ka vazhduar në Prishtinë, në kuadër të lëndës Mbrojtja e Trashëgimisë Arkitektonike.



BASHKËPUNIMI CHWB – UNIVERSITETI I PRISHTINËS – INSTITUTI PËR MBROJTJE TË MONUMENTEVE NË PRIZREN
COLLABORATION BETWEEN CHWB – UNIVERSITY OF PRISHTINA – INSTITUTE FOR PROTECTING MONUMENTS IN PRIZREN

Phase I

During the first phase of the project, field measurements for two traditional houses were instigated within this framework as part of an academic course for the Protection of Architectural Heritage at the Faculty of Civil Engineering and Architecture, University of Prishtina. Two groups of students conducted the surveying and documentation of two traditional houses in Prizren, initially proposed by the Institute for the Protection of Monuments in Prizren. The graphic documentation of the Mullafazliu and Rekathati family houses was undertaken in April 2010, while the completion of these projects continued in Prishtina as part of the academic course in the Protection of Architectural Heritage.



BASHKËPUNIMI CHWB – UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR VEROR I PRISHTINËS
COLLABORATION BETWEEN CHWB – PRISHTINA INTERNATIONAL SUMMER UNIVERSITY

Përmbledhje nga Memorandumi i Bashkëpunimit, i nënshkruar ndërmjet palëve

Summary of Memoranda of Understanding

Instituti për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren (IMMPz), Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës – departamenti i Arkitekturës pranë Universitetit të Prishtinës (UP-FNA), Universiteti Ndërkombëtar Veror i Prishtinës (UNVP) dhe Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) nënshkruan dy memorandume bashkëpunimi për organizimin e kursit Arkitektura Tradicionale dhe Metodologjia e Dokumentimit për të dy fazat e projektit. Ky ishte një hap i rëndësishëm në bashkëpunimin në mes organizatave, i cili ka ndihmuar dokumentimin profesional dhe të plotë të një numri të objekteve të rëndësishme historike, që do të shërbejnë si model i përshtatshëm për zhvillimin e edukimit arkitektonik, së bashku me lëvizjet drejt një mbrojtje më koherente dhe zyrtare të trashëgimisë kulturore. Përfaqësuesit e secilës organizatë obligohen t'i përmbushin detyrat e dala nga ky projekt i përbashkët, duke hapur një dialog më efikas për të mundësuar komunikim më të gjerë të interesave. CHwB ka pasur një bashkëpunim të ngushtë dhe përgjegjësi ndaj UP-FNA dhe IMMPz, në lidhje me organizimin e përgjithshëm të kursit, menaxhimin dhe koordinimin e projektit, si dhe caktimin e objekteve për studim. Nga IMMPz, si palë kryesore dhe përfaqësuese e qytetit mikpritës të Prizrenit, është kërkuar që të bëjë përcaktimin e shtëpive që do të përfshihen në dokumentim dhe të sigurojë qasje në to për studentët dhe mbikëqyrësit. UNVP ka ftuar një përfaqësues të CHwB-së që të marrë pjesë në panelin e zgjedhjes së studentëve, të cilët do të regjistroheshin në kursin veror, në mënyrë që të zgjedhin kandidatët më të përshtatshëm për detyrat e

The Institute for the Protection of Monuments in Prizren (IPMPz), the University of Prishtina Faculty of Civil Engineering and Architecture (UP-FCEA), Prishtina International Summer University (PISU) and Cultural Heritage without Borders (CHwB) signed two separate Memoranda of Understanding for the organisation of the 2010 course in Traditional Architecture and Documentation Methodologies for the two phases of the project. This was an important step in cross-organisation collaboration that has enabled a thorough and professional documenting of a number of historically valuable buildings, and can be seen to serve as an appropriate model for architectural educational development in tandem with moves towards more coherent and official heritage protection.

Representatives from each organisation were assigned to the collaborative project, opening up a more effective dialogue and enabling a greater communication of interests. CHwB had a close collaboration with and responsibility to UP-FCEA and IPMPz, with regards to the overall organisation of the course, project management and coordination, and assignment of sites for study. IPMPz, as the main party based in the host city of Prizren, was required to allocate the houses to be surveyed and to provide access to these sites for students and supervisors. PISU invited one member of CHwB to participate on the panel that selected students for enrolment in the summer course, in order to choose the most appropriate candidates for the tasks involved.

përfshira. Nora Arapi dhe Enes Toska ishin të angazhuar si Koordinatorë të Projektit, duke marrë përsipër hartimin e një programi të detajuar në aspektin teorik dhe praktik në përputhje me rekomandimet dhe qëllimin e UNVP. Koordinimi dhe mbikëqyrja e studentëve dhe punës është bërë nga ekipi i përbashkët, i përbërë prej përfaqësuesve të CHwB, UNVP, UP-FNA dhe IMMPz.

Nora Arapi and Enes Toska were employed as Project Coordinators, undertaking the drafting of a detailed programme for the theoretical and practical aspects that tied in with the recommendations and ambitions of PISU. A team consisting of CHwB, PISU, UP-FCEA and IPMPz shared the coordination and supervision of students and work.



EDICIONI I 10-TË I UNIVERSITETIT NDËRKOMBËTAR VEROR TË PRISHTINËS
10TH EDITION OF PRISHTINA INTERNATIONAL SUMMER UNIVERSITY



KURSI 17. ARKITEKTURA TRADICIONALE DHE METODAT E DOKUMENTIMIT
COURSE 17. TRADITIONAL ARCHITECTURE AND DOCUMENTATION METHODOLOGIES

Raporti i Projektit: “Dokumentimi i shtëpive tradicionale në Prizren”

Project Report: “The Documentation of Traditional Houses in Prizren”

Tashmë është e ditur dhe e thënë se, treva e Kosovës ka një thesar të çmuar të trashëgimisë historike kulturore. Kjo trashëgimi në mënyrë të vazhdueshme, shekuj me radhë i është ekspozuar veprimeve shkatërrimtare, qoftë nga faktori natyrë apo njeri.

Në Kosovën e pasluftës është trashëguar një gjendje e rëndë e trashëgimisë kulturo-historike si pasojë e trajtimit joadekuat të saj, vandalizmit urban dhe arkitektural, respektivisht rrënimëve, shkatërrimeve dhe devastimeve që i janë bërë dhe i bëhen edhe sot e kësaj dite trashëgimisë historike kulturore. Por, mbi të gjitha janë veprimet joadekuate, në emër të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë, kur veprohet në bazë të parimeve diskutabile konservuese – restauruese ! Kjo gjendje e rëndë e trashëgimisë si dhe e ambientit të degraduar në mënyrë të vazhdueshme ka filluar të ndikojë në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e trajnimit dhe edukimit në trashëgimi.

Praktika ka dëshmuar se, studentët e arsimuar mirë, janë më shumë të interesuar në trashëgimi sesa ata të cilët nuk kanë njohuri paraprake në këtë fushë. Për këtë arsye është e nevojshme që edukimi dhe arsimimi në trashëgiminë kulturo -historike të fillojë sa më herët që është e mundur, sepse ngritja e njohurive, përkushtimi më i madh dhe vlerësimi për trashëgiminë, do të ndikojnë në etikën profesionale dhe shprehitë dëmtuese aktuale drejt kësaj fushe.

Studentëve të arkitekturës, mësimi për trashëgiminë kulturore – historike, nuk u shërben vetëm për të pasuruar mendimin dhe njohuritë për

It is widely appreciated that the territory of Kosovo holds a wealth of historic cultural heritage. Over the centuries, this legacy has been exposed to destructive actions of both an environmental and human nature. In the post-war context, Kosovo has inherited a difficult situation in relation to its heritage as a result of its inadequate maintenance, and urban and architectural vandalism (demolition, destruction and looting) that continue today. Above all, the conservation and protection of heritage is woefully inadequate, often resulting in interventions that do more lasting damage to the historic fabric than the processes of time. The threat to Kosovo’s historic fabric and its steadily degrading environment has recently resulted in an increased awareness about the importance of training and education in this context.

Practice has shown that students who are specifically trained in the field of heritage and conservation are more attuned to the demands of historic buildings than those who have no previous knowledge in this field. It is therefore necessary that education in cultural and historical heritage begins as early as possible in the course of architectural study because an increased knowledge of and greater commitment to heritage assessment will affect professional ethics towards threatened historic fabric. Learning about cultural-historical heritage not only serves to enrich architecture students’ understanding of the history of architecture, but also establishes a suitable relationship between the existing context and new construction. The architect will fulfil his creative role in the built

historinë e arkitekturës, për përkujdesjen ndaj saj, por u shërben edhe për krijimin e marrëdhënieve të vërteta në mes të arkitekturës së vjetër dhe të re. Arkitekti do t'i përgjigjet në tërësi profesionit vetëm atëherë kur af-tësitë e tij kreative i mbështet në respektimin e hapësirës dhe strukturës kompozicionale ekzistuese.

Për të arritur këto objektiva dhe në vazhden e reformimit të Univer-sitetit të Prishtinës, edhe Departamenti i Arkitekturës, respektiv-isht Katedra e Historisë së Arkitekturës dhe Artit, ka ndërmarr hapat e parë për reformimin e planprogramit mësimor. Në këtë kontest për lëmin e Trashëgimisë Kulturore janë paraparë dy kurse për nive-lin bachelor : Mbrojtja e Trashëgimisë Arkitekturore (sem VIII - obliga-tive) dhe Arkitektura Regjionale (sem VIII – zgjedhore) si dhe një kurs Teoria dhe Praktika e Restaurimit për studimet e nivelit Master (sem IX – obligative). Ç'është e vërteta, përgatitjet paraprake për lëndët e propozuara janë konceptuar shumë më herët (që në vitet e 80-ta). Në lëndën «Historia e Arkitekturës» u zhvilluan ushtrimet në skicimin dhe paraqitjen aksonometrike të objekteve të trashëgimisë kulturore që do t'i orientoj studentët në kontaktin e drejtpërdrejtë me monumentet dhe zonat historike, fillimisht të një hapësire më të gjerë duke u foku-suar gjithnjë e më shumë kah hapësira e Kosovës. Përkundër kual-itetit relativisht të mirë kjo pjesë e programit nuk mund të kënaqte as për së afërmi nevojat për edukimin në këtë fushë. Për këtë arsye, plan-programi u zgjerua në vitin 2000 me futjen e kurseve të sipërcituara.

environment only by integrating contemporary professional tasks within the larger context and situation from which they must inevitably derive, the background for which is materially tangible and more temporally subtle. To achieve these objectives and in the course of reforming the University, the Department of Architecture and Art History (part of the Faculty of Architecture) has undertaken measures to reform the curricu-lum. Two Bachelors of Arts courses have been introduced to the area of cultural heritage: the Protection of Architectural Heritage (compulsory module for VIII semester) and Regional Architecture (elective module for VIII semester). In addition there is a Masters course in Theory and Prac-tice of Restoration (compulsory module for IX semester).

Preliminary preparations for the proposed subjects were in fact conce-ived much earlier, during the 1980s. Exercises in sketching and the axonometric representation of heritage monuments are an important part of the History of Architecture course, bringing students into di-rect contact with the monuments and historical sites in Kosovo. De-spite the relatively high quality of this part of the programme, it did not satisfy the educational needs in this field. For this reason, the cur-riculum in 2000 was expanded with the introduction of the above-mentioned courses. The new curriculum allows students to obtain a general knowledge in this field. They are able to understand the na-ture of cultural heritage: its role and significance in the past, its rel-evance to the present, and why it is vulnerable and being damaged.

Planprogrami i ri u mundëson studentëve të marrin njohuritë themelore të nevojshme në këtë fushë. Ata aftësohen të kuptojnë çështje trashëgimie kulturore; rëndësia dhe roli në të kaluarën dhe sot; pse është e rrezikuar dhe e dëmtuar. Ligjëratat i mësojnë studentët për rëndësinë e hulumtimit, analizës së gjendjes aktuale dhe vlerësimin e saj, sikurse edhe për metodat e mbrojtjes dhe intervenimet e mundshme—konservimin, rehabilitimin, rekonstruimin, zhvendosjen, revitalizimin, adaptimin dhe interpolimin. Ligjëratat, me shembuj të shumtë vërtetojnë se restaurimi dhe adaptimi janë detyra kreative por gjithashtu komplekse, të vështira dhe sfiduese. Theksi është vënë në peshën kreative të interpolimit të strukturës së re në ambientin historik. Qëllimi kryesor i ligjëratave është që t'i trajtoj arkitektët e ardhshëm që t'i trajtojnë drejtë zonat kulturo-historike.

Ushtrimet praktike përbëhen nga hulumtimet bazike, analizat historike dhe artistike dhe valorizimin. Me qëllim që vlerësimi i objektit të jetë i plotë dhe objektiv, ushtrimet janë konceptuar ashtu që të merren parasysh të gjithë faktorët që kanë të bëjnë me të (pra historiku, arti, konstrukcioni, teknikat e ndërtimit etj.)

Hulumtimet bazike, analizat dhe valorizimi bëhen në bazë të dokumentacionit arkitektoniko-teknik të cilin e ofrojnë institucionet e trashëgimisë. Për fat të keq, institucionet tona të trashëgimisë disponojnë me një dokumentacion tejet modest dhe akoma përballen me një gjendje të rëndë të evidentimit dhe dokumentimit të fondit të pasur të trashëgimisë, e cila

Lectures teach students about the importance of research, analysis and evaluation of the current situation, as well as practical methods of protection and intervention, conservation, rehabilitation, reconstruction, relocation, revitalization, integration and adaptation. Precedent studies demonstrate that restoration and adaptation are not only creative tasks but also introduce complex and difficult challenges. An emphasis is placed on the creative impact of inserting new structures into a historic environment. The main purpose of the lectures is to encourage young architects to treat cultural and historical sites with appropriate respect.

Practical exercises consist of research, historical and artistic analysis as well as valorisation. The exercises are designed to take into account all factors relating to a building's function and relevance (such as its history, artistic merit and construction) in order to objectively assess it as a whole, and are undertaken in accordance with the technical architectural documentation required by heritage institutions.

Unfortunately, institutions dealing with cultural heritage in Kosovo currently possess limited documentation and still face difficulties in entering and recording the heritage being regularly lost. In this context, practical tasks are focused primarily on collating the appropriate documentation in combination with wider educational benefits: students learn methods of composing documents, institutions enrich their archives and the heritage dossier is extended through graphical records. The Faculty of Civil Engineering and Architecture has organized field exercises in the form

çdo ditë rrezikon të humbet. Në këtë kontekst, ushtrimet praktike janë fokusuar kryesisht në hartimin e dokumentacionit arkitektoniko-teknik me dobi të shumëfishtë; studentët mësojnë metodologjinë e hartimit të dokumentacionit, institucionet e pasurojnë arkivin e tyre dhe fondi i trashëgimisë përjetësohet përmes prezantimit grafik. Për disa vite me radhë, fatkeqësisht me shkëputje, duke iu falënderuar donacioneve nga Sorosi (viti akademik 2000/01), e sidomos nga Organizata Joqeveritare «Trashëgimia kulturore pa Kufij», Suedi, Zyra në Kosovë, (CHWB) (viti akademik 2004/2005; 2005/2006 dhe 2009/2010), kemi organizuar ushtrimet në terren në formë të punëtorive disaditore në Prizren, Gjakovë, Pejë, dy vite me radhë në Dranoc, dhe së fundi sërish në Prizren. Studentët kanë punuar në rilevimin e objekteve të trashëgimisë, në hulumtimet e drejtpërdrejta si dhe në analizat historike dhe arkitektonike. Kjo formë e ushtrimeve të kursit është treguar shumë e suksesshme, duke qenë se studentët ishin në kontakt të drejtpërdrejtë me monumentet e trashëgimisë, që ndikoi në interesimin dhe vetëdijësimin e tyre për këtë lëmi, kuptuan rëndësinë dhe shfaqën brengën për mirëqenien dhe fatin e saj të mëtejme. Për më tepër, puna e përbashkët në terren u tregua tejet efiçente e shprehur me pjesëmarrjen aktive të studentëve në diskutimet konstruktive lidhur me problemet e trajtimit të trashëgimisë, sensibilizuan opinionin e gjerë për qasje më serioze ndaj trashëgimisë, si dhe tërhoqën vërejtjen për rrezikun nga veprimet e pakontrolluara dhe jo profesionale.

of workshops lasting several days thanks to donations from Soros (academic year 2000/01) and from CHWB-Sweden (for academic years 2004/5, 2005/6 and 2009/10) in Prizren, Gjakovë, Pejë and Dranoc.

Students were engaged in documenting heritage monuments, conducting research and historical architectural analyses. This form of study proved highly successful, since students were brought into direct contact with heritage buildings and it has led to their increased interest and awareness in this field. They have realized the importance of cultural heritage and showed concern for its welfare and future protection and use. Moreover, collaborative on-site work has proven extremely effective in encouraging the active participation of students in constructive discussions regarding heritage issues. They have sensitized overall public opinion for a more serious consideration of Kosovo's heritage and drawn attention to the danger of uncontrolled, informal and unregulated actions in the built environment.

“We want to come into close contact with the monuments - in order to understand them directly, make proper assessments of the situation and then make the right decisions” was a frequent demand from participating students. CHWB responded by inviting their participation in the project for the “Documentation of Traditional Houses in Prizren” for the academic year 2009/10.

The purpose and objectives of this organizations' programme is to contribute to capacity building and the continuing professional development

Edhe këtë vit akademik, 2009/2010, kërkesës së vazhdueshme të studentëve «Duam të jemi pranë monumentit - me qëllim që ta njohim drejtpërdrejt, të bëjmë vlerësim të mirëfilltë të gjendjes dhe pastaj të mund të marrim vendime të drejta», iu përgjigj organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufij, duke ia bërë pjesë të projektit të saj “Dokumentimi i shtëpive tradicionale në Prizren”.

Qëllimi dhe objektiva e projektit të kësaj organizate, për të kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve dhe studentëve në përgatitjen e projekteve dhe dokumentimit të trashëgimisë kulturore, sidomos në nxitjen e bashkëpunimit më efektiv të institucioneve arsimore, në këtë rast, Departamenti i Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës dhe atyre profesionale, përkatësisht Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren, u kurorëzua me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, ku të gjitha palët morën përgjegjësitë e veta.

Metodologjia dhe aktivitetet e parapara në projekt janë kompatible me fazën e dytë të detyrës të paraparë me planprogram nga lënda «Mbrojtja e Trashëgimisë Ndërtimore» pra, krijimin e dokumentacionit arkitektonik-teknik të objekteve të përzgjedhura. Me këtë rast u formuan dy grupe të studentëve të cilët për një javë, prej 19-24 prill, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen profesionale të stafit të CHWB-së, IMMPz-së dhe Katedrës së Historisë së Arkitekturës dhe Artit, punuan në rilevimin e gjendjes ekzistuese të dy shtëpive tradicionale, shtëpisë së familjes Mullafazliu dhe familjes Rekathati në Prizren.

of architects and students in the preparation of projects and documentation of cultural heritage, particularly in promoting more effective cooperation between educational and professional institutions. In this case, the collaboration between the Department of Architecture/University of Prishtina and the Institute for the Protection of Monuments in Prizren was officialised with a Memorandum of Understanding signed by all the parties involved. The methodology and activities employed in this project, and in the creation of technical architectural documentation for selected monuments, are compatible with the second phase of the curriculum prescribed under “Protection of Heritage Construction”. Two groups of students worked for a week (April 19-24 2010) under the leadership and professional supervision of CHWB’s staff, IPM in Prizren and the Department of Art and Architectural History, to document the existing condition of two traditional buildings in Prizren - the houses of the Mullafazliu and Rekathati Families.

Students gathered data and made the necessary measurements of the houses and their urban settings, collating drawings (site plans, floor plans, longitudinal and transversal sections, facade elevations, architectural details, internal and external constructional and decorative elements); making studies of spatial arrangement, function, materials and construction techniques, extent and cause of damage, the stages of construction, past alterations, and photographically recording this in digital form. Survey techniques consisted of hand-drawn sketches, taking metric

Studentët mblodhën të dhënat dhe bënë matjet e nevojshme të shtëpive dhe rrethinës së tyre, që nënkupton rilevimet me skicat e situacionit, planimetrive të të gjitha niveleve, prerjet vertikale gjatësore dhe tërthore, fasadat, hollësitat e arkitektonike, konstruktive dhe elementet dekorative në eksterier dhe enterier, pastaj, studimin e dispozicionit, funksionit, materialeve dhe teknikës së ndërtimit, shkaqet e dëmtimeve, fazave të ndërtimit, transformimet e kohës, si dhe dokumentimin fotografik në formë digjitale.

Rilevimet me skica të hartuara me dorë të lirë, të plotësuara me matje metrike, duke shfrytëzuar metodat e ndryshme (matjet e pjesshme, të njëpasnjëshme, matjet me sistemin e diagonaleve, respektivisht trekëndëshave etj.), përbëjnë edhe të dhënat për vendndodhjen e monumentit, kohën dhe datën e skicimit, autorët e matjeve dhe informata apo komente të tjera të identifikuar gjatë punës në teren.

Më tej detyra është zhvilluar në fakultet, në kuadër të ushtrimeve të lëndës. Të dhënat e mbledhura në teren janë përpunuar në mënyrë kompjuterike, me programet adekuate, dhe është krijuar dokumentimi grafik i shtëpive të familjes Mullafazliu dhe Rekathati, në shkallë 1:50, 1:20, 1:10, të përshatshme për planet e zakonshme të monumenteve.

Përveç, kopjes digjitale është paraparë edhe kopja e "fortë" e projektit të rilevimit e cila do të përpunohet me dorë, vizatime të cilat do të shprehin me denjësisht dhe në mënyrë më autentike vlerat arkitektonike dhe estetike të kësaj krijimtarie, duke vënë në pah shkathtësitë krijuese dhe shijen

measurements using different methods (e.g. partial, consecutive and diagonal/triangulation system measurements) and included data concerning the monument's location, the time and date of the survey, the authors of measurements and relevant additional information and comments. The site data collected for the Rekathati and Mullafazliu family houses was then converted into computer documentation at the Faculty using the appropriate technical software at scales of 1:50, 1:20 and 1:10.

The project documentation is comprised of both digital and hand-drawn information. These drawings express the architectural and aesthetic values of this heritage with dignity and authenticity, highlighting the creative skills and artistic taste of the vernacular craftsman.

The subsequent phase - "The Theory and Practice of Restoration" - covered historical and artistic scrutiny, value-analysis of the structure to determine the type of intervention to be undertaken, the protection measures and necessary interventions to ensure the durability of the building. It will be necessary to improve and expand the curriculum in the field of heritage in order to ensure proper results from this complex responsibility. It is clear that the overall success of heritage protection is not possible without professional expert assistance, cooperation with the cultural heritage authorities, state and municipal authorities and ordinary citizens and legal owners of the heritage buildings.

CHwB already plays a crucial role in conducting research within the field of heritage and conservation by organising workshops and professional

artistike të mjeshtrit popullor. Faza vijuese që do të pasojë, në kuadër të lëndës "Teoria dhe Praktika e restaurimit", është analiza historike dhe artistike e monumentit të rilevuar, valorizimi i strukturës, i cili determinon llojin e intervenimit që duhet të ndërmerret, regjimin e mbrojtjes, si dhe ndërhyrjet e nevojshme për të siguruar jetëgjatësinë e trashëgimisë.

Në të ardhmen, është e nevojshme që planprogrami në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë të përmirësohet dhe të zgjerohet me qëllim që të sigurojë rezultate të përshtatshme nga kjo detyrë komplekse dhe me përgjegjësi. Është e qartë, që sukcesi i përgjithshëm në mbrojtjen e trashëgimisë, nuk është i mundur pa ndihmën profesionale të ofruar nga ekspertët, bashkëpunimin me autoritetet e trashëgimisë kulturore, autoritetet shtetërore dhe komunale si dhe banorët e thjeshtë, përkatësisht pronarët e fondit të trashëgimisë. Është i pamohueshëm roli i organizatës joqeveritare Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB,) e njohur tashmë për hulumtime të ndryshme në fushën e trashëgimisë, organizimin e punëtorive, trajnime, publikimin e fletushkave të dobishme për edukimin e popullatës, investimet në mbrojtjen dhe revitalizimin e trashëgimisë kulturore, por mbi të gjitha, iniciativat dhe aktivitetet e vazhdueshme që i ofron institucioneve të larta arsimore. Dëshmia më e mirë për këtë është bashkëpunimi i suksesshëm dhe i vazhdueshëm me Departamentin tonë, përkatësisht Katedrën e Historisë së Arkitekturës dhe Artit, duke na dhënë ndihmesë të madhe në përpjekjet tona për reformimin dhe avancimin e procesit mësimor, për ç'gjë u jemi mirënjohës.



KURSI 17
COURSE 17



KURSI 17
COURSE 17



KURSI 17
COURSE 17



KURSI 17
COURSE 17

training seminars, raising public awareness through the publication of leaflets and press releases, investing in the protection and rehabilitation of cultural heritage, and especially through initiating activities that offer ongoing collaborations with higher education institutions. The best evidence of the ongoing cooperation and continued success of this programme is seen in the collaboration between the Department of History of Architecture and Art and CHwB on joint projects.

Mr. Sc. Shqipe Nixha

Universiteti i Prishtinës,
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës.

Mr. Sc. Shqipe Nixha

University of Prishtina,
Faculty of Civil Engineering and Architecture

Shtëpitë e rilevuara: Mullafazliu dhe Rekathati

The Documented Houses: Mullafazliu and Rekathati

Shtëpia e Familjes Mullafazliu / House of the Mullafazliu Family

Historia e Familjes

Shtëpia e familjes Mullafazliu gjendet në rrugën Saraçët, aty ku më parë ka ekzistuar tregu i Saraçhanes.

Në bazë të intervistës që bëmë me Elvane (Mullafazliu) Imamin, vajzë e kësaj shtëpie, shtëpinë e ka ndërtuar stërgjyshi i saj Mulla (hoxhë), me prejardhje nga fshati Topojan i Shqipërisë.

Mulla ka pasur dy djem, Shefqeti dhe vëllai i tij që e thërrisin Amixha. Djali i Shefqetit, Xhevdet Mullafazliu kishte pesë djem dhe një vajzë. Sot në këtë shtëpi jeton njëri prej djemve të tij, Mustafa Mullafazliu së bashku me gruan dhe fëmijët.

Në bazë të kronologjisë në këtë shtëpi jeton gjenerata e pestë, prej nga mund të dalim në përfundim që shtëpia është ndërtuar rreth para 180 vjetësh. Pra, i takon ndërtimeve të shekullit XIX. Familja ka qenë e pasur dhe e ngritur. Fëmijët kanë qenë të shkolluar. Familja përpos pronës në Prizren, ka pasur në pronësi edhe një kullë në Gelancë, që është shkatërruar para gjashtë vitesh.

History of the family

The Mullafazliu Family house is situated in Saraçët Street, in the location of the former Saraçhane market. According to interviews with Elvane Mullafazliu Imami (the daughter), the house was built by her great-grandfather Mulla (imam), who originated from the village of Topojan in Albania. Mulla had two sons, Shefqet and Amixha. Shefqet's son, Xhevdet Mullafazliu, had five sons and a daughter. Today one of his sons, Mustafa Mullafazliu, lives in the house with his wife and children. The family's chronology suggests that the fifth generation of this family are currently residing in this house, leading to the conclusion that it was built around 150 years ago. The building is one of a group of dwellings built during 19th century. The family was rich and benefited from a high social status, and most of the children were educated. The family also owned a kulla in Gelanca, which was destroyed six years ago.

Prona e Familjes Mullafazliu

Familja Mullafazliu e kishte pronën në Saraçhane, ku gjendeshin: shtëpia e vjetër dy katesh, oborri i madh i shtruar me kall-drëm, përmes të cilit kalonte përroi me ujë të pastër, dhoma verore, mut-faku, hambarët, koshi, hani i nallbanëve, hani, abdes'hane – nyja sanitare dhe shitorja. Hani i nallbanëve, hani dhe shitorja gjendeshin afër rrugës. Hyrja në shtëpi bëhej kah dyert e hanit. Më pas vazhdonte oborri i madh i shtruar me kalldrëm, në të cilin ishin të vendosura objektet përcjellëse të lartpërmendura.

Një pjesë e pronës së familjes Mullafazliu është marrë me rastin e ndërtimit të Shtëpisë së Kulturës, kurse një pjesë është në pronësi të Bashkësisë Islame. Ndërtimi i objektit privat, në vendin ku ka qenë Hani i Nallbanëve, ka shkaktuar dëmtime të rënda në Han, një pjesë e të cilit është rrrënuar, kurse pjesa tjetër është në gjendje të rëndë fizike. Në vitin 1945 është bërë shpronësimi i Shitores së Nallbanëve.

Nga kompleksi i objekteve që kanë qenë në pronë të familjes, sot kanë mbetur: hani, oborri, një mur i cili e ndan oborrin, prej nga bëhet hyrja në shtëpi, oborri i shtëpisë, ku më vonë janë ndërtuar mutfaku dhe nyja sanitare dhe shtëpia, e cila përpos disa intervenimeve të vogla në enterier, e ruan gjendjen e saj fillestare.

Property of the Mullafazliu Family

The family property in Saraçhane consists of an old two-storey house, a large yard paved with cobble stones through which a stream passed, a summer room, a summer kitchen (mutfak), a granary, an inn, a stable for animals, toilets and a shop. The inn, stables and the shop fronted the road. The entrance to the house was through the inn doors, beyond which lay the cobbled yard, where the remaining buildings were located.

Part of the family's property was requisitioned when the Cultural Centre was built, while another area was given to the Muslim community. The construction of a private building in place of the stables caused serious damage to the inn structure; part of it was ruined, while the remaining section is in very poor condition. In 1945 the shop was expropriated by the state.

What remains today of the family's complex of buildings is the inn, yard, a wall which divides the large and small yards, the house's yard, the area where the summer kitchen was later built, a WC and the house. Besides some minor interventions in the interior, the house is original.



SHTËPIA MULLFAZLIU
MULLFAZLIU HOUSE

Hani

Hani është ndërtuar në kohën kur është ndërtuar shtëpia. Ky han ka qenë ndër hanet e para që janë ndërtuar në qytet dhe deri para 30 vitesh ka kryer funksionin shërbyes hotelierik. Sot, objekti gjendet në gjendje të rëndë, hyrja nëpër hapësirat e brendshme të saj është e pamundur. Matjet janë bërë vetëm në pjesën hyrëse, që shërben si nënkallim dhe hyrje në shtëpi dhe në fasadën kah rruga.

Funksionin dhe hapësirat e brendshme të hanit, do t'i përshkruajmë duke u bazuar në përshkrimet e Elvane Imamit.


Në përdhese gjendej hyrja përmes dyerve të mëdha nga druri. Në të djathtë të hyrjes gjendej peshqyn-i , dhomë e fjetjes për mysafirë më të varfër, e shtruar me dërrasa dhe kashtë.

Në katin e parë të hanit gjendeshin tre dhoma të fjetjes, që shërbenin për mysafirët e shtresave më të larta. Njëra dhomë kishte tre krevate, tjetra, katër krevate dhe, e treta, kishte shtatë krevate. Krahas dhomave të fjetjes në kat, ishte edhe zaire-ja, vendi ku lihej sana dhe shitej ushqimi për kafshë. Hani kishte edhe një sanitare për mysafirë, si dhe dhomën e fjetjes për punëtorë. Pas hanit gjendej edhe shtalla, ku vendoseshin kuajt. Konstruksioni i hanit nga dukja e jashtme, është nga qerpiçi, me dy kulme dy ujore të vendosura njëra pas tjetrës, me konstruksion të drurit dhe mbulesë tjegulla me lujje.

Në han punonin dy punëtorë, një në administratë dhe një si shërbyes.



FASADA BALLORE
FRONT FACADE



KONSTRUKSIONI
CONSTRUCTION



SHKALLËT NGA GURI
STONE STAIRS

Inn

The inn was built at the same time as the house. It is among one of the first inns built in Prizren, and served as such until 30 years ago. The building is currently in very poor condition, and it is impossible to enter the rooms. Measurements have been taken only of the entrance part, which is the primary access to the house from the main road, and on the south facade.

Elvane Imami has provided a description of the inn's spatial arrangement and patterns of inhabitation.

The main ground floor entrance was through big wooden doors. To the right of this was the peshqyn, a bedroom for poor guests, with wooden floorboards and straw. Three bedrooms on the first floor were used by wealthy guests. There were three beds in one room, four in another and seven beds in the third bedroom. Besides the bedrooms, a zaire was also located on this floor, where straw was stored for the animals. There was also a toilet for guests and a bedroom for the inn's workers, one of whom worked in the house's administration and the other as a servant. A stable for horses was situated behind it.

Viewed from the exterior, the main construction material of the inn is of clay with two attached, pitched timber roofs covered with clay tiles.

Shtëpia e Familjes Mullafazliu

Shtëpia në fjalë gjendet në fund të oborrit të pronës së familjes, është e ndarë me oborrin e hanit përmes një muri.

Objekti është i vendosur në terren të pjerrët, me ç'rast konfiguracioni i terrenit ka ndikuar edhe në zgjidhjen funksionale dhe konstruktive të objektit.

Në oborr të shtëpisë gjendet kanali ku ka kaluar uji i lumit, mutfaku dhe nyja sanitare që janë ndërtuar më vonë.

Funksioni – Shtëpia është e koncipuar në dy etazha. Përdhesa është e ngritur nga niveli i oborrit për 1.3 m. Hyrja në përdhese bëhet përmes hajatit të mbuluar, dhe shkallëve të gurit. Në hajat përpos shkallëve të vjetra të gurit, gjendet edhe flaniku – depo që shërbente për vendosjen e gjërave ushqimore.

Në përdhese gjendet holli, dhoma e ndejës me pamje kah oborri i përparmë, hamamxhiku- nyja sanitare, kuzhina me pamje kah oborri i pasmë, shkallët një drejtimesh që të shpien në kat, dhe çardaku në anën e djathtë të derës hyrëse. Çardaku është i ngritur nga niveli i përdheses për tre shkallë. Ky denivelim i dyshemesë është mundësuar falë konfiguracionit të pjerrët të terrenit. Po ashtu, edhe në kat organizimi i dhomave është pothuajse i njëjtë: çardaku – që është i mbyllur me dritare, afër tij dhoma e ndejës, nyja sanitare dhe një dhomë e fjetjes.

The House of the Mullafazliu Family

The house is situated within the family's yard, divided from the inn's yard by a wall. It lies on sloping ground, and these ground contours have had an impact on the functional and constructional shaping of the building. The house's yard contained a water channel, and the summer kitchen and WC which were added later.

Function – The house is comprised of two storeys. The ground floor is raised 1.3m above the level of the yard and its entrance is via a covered porch (hajat) containing some stone stairs and the flanik, a food storage space. It leads to a hall, a living room with a view of the front yard, bathroom (hamamxhik), kitchen looking onto the back yard, and stairs to the first floor. A porch to the right of the entrance door is raised above ground floor level by three steps, a result of the sloping ground conditions.

The arrangement of rooms is the same as on the first floor: a gallery (which was later closed by windows), beside which there is a living room, bathroom and a bedroom with a view over the back yard.

Konstruksioni – Në bazë të analogjisë me objektet e banimit që janë ndërtuar në këtë kohë, mund të themi se themelet e kësaj shtëpie janë nga guri, me ç’rast cokulla ngrihet deri në 50 cm nga guri. Muret perimetrike janë nga tulla të qerpiçit, me trashësi 80 cm, kurse në kat muret janë më të holla të ndërtuara me sistem bondruk – hatulla të drurit të mbushura me tulla nga qerpiçi.

Konstruksioni mes katesh është nga druri, në formë të trarëve që shtrihen në dy drejtime.

Shkallët e hyrjes janë nga guri i gdhendur, ku shkalla e fundit ka një përpunim të veçantë. Shkallët e brendshme janë nga druri. Dyshemetë nëpër dhoma në përdhese dhe kat janë nga dërrasat, kurse nëpër nje sanitare janë shtruar me beton.

Konstruksioni i kulmit është dy uJOR, nga druri, i mbuluar me tjegulla të lugëta.

Construction – Based on comparisons with dwellings built during the same period, we can conclude that the foundations of the house are made of stone, with a 50cm high plinth around the building’s perimeter. The external walls are 80cm thick and are made of clay brick, while the walls of the first floor are thinner and constructed from the bondruk system of timber infilled with clay brick. The entrance stairs are of carved stone, and the last step has a noteworthy linear cornice. The internal stairs are constructed in wood. The internal floor construction is also of timber, with a double layer of beams laid in two directions and finished with wooden floorboards, while the bathroom floors are paved with cement. The double-pitched timber roof is covered with clay tiles.



ROZETA
WOODEN CEILING

Arkitektura – Në eksterier shtëpia e ka të trajtuar fasadën ballore, ku mund të theksojmë traun në formë harkore që gjendet mbi çardak, në dy katet, shkallët e vjetra nga guri dhe streha e kulmit që krijon efekte të dritë-hijes.

Në aspektin e formësimit arkitektonik, enterieri i shtëpisë është më i pasur, ku mund të vërejmë elementet origjinale të trajtuara me një kujdes të veçantë.

Në dhomat e ndejës në përdhesë dhe kat, gjendet një element specifik për këtë shtëpi qymlekllek – një formë e kaminit të mbyllur që ka shërbyer për ngrohjen e ujit dhe të dhomave (sistem primitiv i ngrohjes qendrore). Uji i ngrohur në qymlekllek ka shërbyer për pastrim në hamamxhik – nyjet sanitare që gjendeshin përbri dhomave të ndejës. Sot qymleklleku ka funksion dekorativ. Tavanet janë nga druri, me një rozetë të dekoruar në mes. Dyert janë po ashtu nga druri të lyera me ngjyrë të bardhë, me dorëzat në formë rrethore nga metali. Kapakët e dollapëve në mur janë të nga druri të dekoruar. Dritaret kanë skelet nga druri.

Në kuzhinën që gjendet në përdhesë, kalon traui i cili ka një dekorim në formë harkore, si dhe shquhet edhe hapja e derës ku më parë ka qenë hamamxhiku, që sot shërben si kuzhinë.

Architecture – The front facade of the house is highly ornate, especially the arched beam that is located in the galleries, the old stone stairs and overhanging roof eaves which provides shade. This rich decoration continues into the interior, where the original elements have been well-preserved. A characteristic element of the living rooms on the ground and first floors is the qymlekllek – a type of closed fireplace which heated the rooms, like an early system of central heating, and provided heated water for the neighbouring bathrooms. Nowadays the qymlekllek plays more of a decorative than a practical role. The walls and ceilings are lined with wood and decoratively carved, and there is an ornate rozeta (ceiling rose) in the middle of the soffit. The windows and doors are timber-framed, but the latter are stained white, with round metal knobs. A beam with arc-shaped decoration is found in the ground floor kitchen, where there is also a door to the hamagjik.

Transformimet – ashtu si cekëm edhe më lart, shtëpia në përgjithësi ka ruajtur origjinalitetin e saj, përpos disa intervenimeve të vogla që janë bërë. Çardaku në përdhesë dhe kat, sot shërben për vendosjen e gjërave. Hamamxhiku në kuzhinë, në përdhesë është shndërruar në kuzhinë, ku janë vendosur elementet. Dhoma e pasme në kat, ka pësuar disa intervenime dhe shërben si dhomë e fjetjes.




QYMLEKLËK
TRADITIONAL HEATING SYSTEM

Transformations and alterations – Apart from a few interventions in the interior, the house retains its original features. The porches and galleries on the ground and first floor are currently used as storage spaces. The hamamgjik, leading off the ground floor kitchen, has been transformed into a kitchen with cupboards and a sink. The back room of the first floor has also been altered and is now used as a bedroom.



JYKLYK
JYKLYK



DERË E BRENDSHME
INTERNAL DOOR



DORËZ E VIETËR
OLD KNOB



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS



DETAJ I DOLLAPIT
BOARD DETAIL





MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS




MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS




SITE PLAN 1:750









SECTION A-A







EAST FAÇADE





SOUTH FACADE





NORTH FACADE





SECTION



FRONT VIEW



DETAIL B



PLAN

Ekipi punues

Mbikëqyrës: BA. Nora Arapi - CHwB

Matjet:

- Sami Bytyqi Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III
- Ferat Zekaj Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III
- Driton Osdautaj Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III
- Artë Dobra Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III

Përgatitja grafike

- Artë Dobra Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III
- Sami Bytyqi Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III
- Kujtesa Godeni Mimar Sinan Universiteti i Arteve të Bukura – Fakulteti i Arkitekturës, Istanbul, Turqi; Viti IV

Working Team

Supervisor: BA. Nora Arapi - CHwB

Field Measurements:

- Artë Dobra University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III
- Sami Bytyqi University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III
- Ferat Zekaj University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III
- Driton Osdautaj University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III

Graphic presentation:

- Artë Dobra University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III
- Sami Bytyqi University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III
- Kujtesa Godeni Mimar Sinan University of Fine Arts – Faculty of Architecture; Istanbul, Turkey; Year IV

Shtëpitë e rilevuara: Mullafazliu dhe Rekathati

The Documented Houses: Mullafazliu and Rekathati

Shtëpia e Familjes Rekathati / The House of Rekathati Family

Lokacioni

Shtëpia e Familjes Rekathati gjendet në lagjen Bazhdarhana, në rrugën Ali Pashë Elbasani. Kjo shtëpi gjendet në zonën e parë të mbrojtjes, sipas planit zhvillimor urban të Prizrenit dhe në listën e objekteve të evidentuara të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Prizren.

Në bazë të intervistës që kemi bërë me njërin prej banorëve të shtëpisë, Ahmet Rekathati, shtëpia është ndërtuar në vitin 1886.

Kjo është ndarë në dy pjesë simetrike ndaj boshtit gjatësor dhe shfrytëzohet nga dy familje.

Objekti është i rrethuar në të katër anë me objekte tjera të banimit. Njëren fasadë e ka të ngjitur me një objekt tjetër banimi. Qasja në shtëpi bëhet përmes nënkalimit të një objekti të ri të ndërtuar më vonë. Ndërmjet shtëpisë së vjetër dhe asaj të re, gjendet oborri i brendshëm i shtuar me kalldrëm, ku gjendet kanali ku kalonte uji që shfrytëzohej për nevoja të shtëpisë. Kjo shtëpi ka qenë ndër shtëpitë e para që kanë pasur instalime elektrike.

Location

The Rekathati Family house is situated in the neighbourhood of Bazhdarhana, in Ali Pashë Elbasani Street. It is in the Heritage Protection Zone 1 as set out in the Urban Development Plan of Prizren, and is on the IPM-Pz's inventory of heritage buildings.

According to an interview with Ahmet Rekathati, the house's owner, the building was constructed in 1886. It is divided into two symmetrical parts along its vertical axis, and is inhabited by two families. The four sides are surrounded by other residential buildings and its street facade is shared with another, newer house, through which access to the Rekathati House is obtained via a passageway. An inner yard lies between the older and newer house, paved with kalldërm cobble stones. River water, used in the house, flowed through a channel in this yard. This house was one of the first with electrical fixtures.

Funksioni – Objekti që nga koha e ndërtimit ka pasur destinim të banimit dhe vazhdon të ketë destinim të njëjtë edhe sot.

Shtëpia e ka bodrumin dhe dy kate. Hajati që gjendet në përdhesë të objektit, sot është ndarë në dy pjesë përmes një muri. Në përdhesë kah fasada ballore gjendet dhoma e ndejës me hamamxhik, i cili edhe sot përdoret si nyje sanitare. Pas dhomës së ndejës, me pamje kah oborri i pasmë gjendet kuzhina. Në katin e parë gjenden dy dhoma të fjetjes, me nyjet sanitare, holli dhe hapësira e çardakut, që sot përdoret si depo.

Konstruksioni – Muret e bodrumit janë nga guri, me ç'rast supozojmë se edhe themelet janë nga guri.

Përdhesa është e ngritur nga oborri për tre shkallë. Fasadat e objektit janë të suvatuara, prandaj materiali i mureve mund të supozohet varësisht nga trashësia e tyre. Muret në përdhesë më trashësi rreth 60 cm, supozohet që janë nga guri, kurse ato në kat nga qerpiçi. Konstruksioni mes-katesh është nga druri.

Dyshemeja e objektit në përdhesë dhe në kat është nga druri. Dyshemeja në hajat në të dy anët e shtëpisë është shtruar me çimento.

Shkallët e brendshme të shtëpisë janë gjithashtu nga druri.

Kulmi është dy uJOR me konstruksion të drurit. Mbulesa e kulmit në njërin anë është ajo origjinale, nga tjegullat e argjilës, kurse në anën tjetër është ndërruar më vonë është nga Salloniti- azbest.



SHTËPIA P
REKATHA



BEKATHATI
TI HOUSE

Function – Since its construction the building has been continually used as a residence, comprised of **a basement**, ground and first floor. The *hajati*, situated on the ground floor, is divided into two parts. Facing the main yard is the living room and *hamagjik*, which is still used as a bathroom. Behind the living room is a kitchen and dining room which opens onto the back yard. There are two bedrooms on the first floor, with bathrooms, a hall and a closed gallery space which is currently used for storage.

Construction – The basement walls are made of stone, suggesting that the foundations are also of stone. The ground floor is raised above the level of the yard by three steps. The facades of the building are plastered and so the wall construction remains an assumption. The ground floor walls are 60 cm thick and, using comparisons with other similar buildings in the locality, presumably stone while the walls on the first floor are made of clay brick. The internal floor construction is of timber, but the floor in the *hajati* on two sides of the house is finished with cement, a later alteration. The internal stairs are also of timber. The timber framed roof is double-pitched; the left side is covered with clay tiles, while those on the right side have been replaced with Sallonit-asbestos tiles.

Arkitektura – Eksterieri: Fasada ballore e shtëpisë ka elemente specifike të trajtimit të dekorimeve në dritare dhe fasadë. Karakteristike është edhe trau i hajatit, që ka formë lakore.

Dera e hyrjes në oborr, është nga druri dhe është në gjendjen fillestare. Karakterizohet me elemente specifike, si është dorëza.

Enterieri: Në anën e majtë të shtëpisë ka pasur intervenime, me ç'rast është bërë adaptimi për nevoja të sotme të jetesës. Tavanet, dollapët janë nga druri, por janë të reja. Hamamxhiku është shtruar me pllaka qeramike dhe pajisur me elemente të reja. Ndërsa në anën e djathtë të shtëpisë, mund të vërejmë elementet origjinale, siç janë: kapakët e dollapëve, tavani i dekoruar me rozetë etj.

Transformimet


1886 – Është ndërtuar shtëpia.

1896 – Është lyer fasada ballore e shtëpisë.

2002 – Ana e majtë e shtëpisë është renovuar, me ç'rast janë ndërruar tavani, kapakët e dollapëve. Në anën e djathtë të shtëpisë, është ndërruar mbulesa e kulmit, me ç'rast tjegullat e argjilës janë zëvendësuar me mbulesë Sallonit.



SHTËPIA REKATHATI
REKATHATI HOUSE



KALLDËRM
COBBLE STONE



DERA HYRËSE
ENTRANCE DOOR

Architecture – The exterior of the house contains unique decoration on the windows and entire front facade, and the curved beam of the ha-jat is a notable characteristic. The entrance door to the yard is made of wood, retains its metal knob, and is an original feature.

Internally, the left side of the house has seen some major interventions where it has been adapted to meet the occupants' current needs. The old wooden ceilings and cupboards have been replaced by new wood. The hamamgjik is lined with ceramic tiles and equipped with modern fittings. The right side of the house, however, remains authentic, with its original cupboards and decorative wooden ceiling with rozeta (ceiling rose).


Transformations and alterations Chronology:

1886 – Construction of house

1896 – Front facade of the house plastered

2002 – Left side of the house renovated; ceilings and cupboards replaced.

Roofing on right side of the house was replaced substituting clay tiles for Sallonit – asbestos tiles.



TAVAN NGA DRURI
WOODEN CEILING



DETAJ I DOLLAPIT
BOARD DETAIL



TRAU I DEKORUAR
DECORATED BEAM




MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS




KONSTRUKSIONI I KULMIT
ROOF CONSTRUCTION



SITE PLAN
0 1 2 3 4 5

→ B




505

605


→ B

BASEMENT PLAN





GROUND FLOOR




FIRST FLOOR




SECTION A-A





SECTION B-B






SOUTH FACADE





ENTRANCE DOOR

DETAIL 1







GATE FRONT VIEW



GATE BACK VIEW





Ekipi punues

Mbikëqyrës: BA. Besart Dajçi - CHwB

- Lum Kastrati Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III
- Ardian Uruqi Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III
- Zaim Bajra Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III

Working Team

Supervisor: BA. Architecture Besart Dajçi – CHwB

- Lum Kastrati University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III
- Ardian Uruqi University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III
- Zaim Bajra University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III

Faza II

Faza e dytë e projektit është zhvilluar në kuadër të planprogramit të Universitetit Ndërkombëtar Veror të Prishtinës. CHWB ka organizuar kursin nr. 17 "Arkitektura Tradicionale dhe Metodat e Dokumentimit". Bashkëpunimi i CHWB-së me Universitetin e Prishtinës, gjegjësisht me Universitetin Ndërkombëtar Veror të Prishtinës është përcaktuar përmes Memorandumit të Bashkëpunimit, që është nënshkruar si aneks për Memorandumin paraprak. Gjithashtu, në këtë Memorandum janë përcaktuar përgjegjësit dhe kontributi i partnerëve në implementimin e projektit.

Kursi nr. 17 Arkitektura Tradicionale dhe Metodat e Dokumentimit, është zhvilluar prej 12 deri më 23 Korrik 2010. Në këtë kurs morën pjesë 20 studentë të arkitekturës, të historisë së artit, nga vende të ndryshme të regjionit, si: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Turqia dhe Serbia. Kursi përbëhej prej pjesës teorike dhe asaj praktike. Pjesa teorike është zhvilluar në Prishtinë, ku ligjërues kanë qenë profesori Emin Riza nga Shqipëria dhe MA. Teuta Jashari Kajtazi, nga Kosova. Pjesa praktike u zhvillua në Prizren. Studentët u ndanë në pesë grupe, dhe secili grup studioi një shtëpi tradicionale të Prizrenit. Java e parë kaloi me matjet, hulumtimet, rilevimet në terren, kurse java e dytë ishte e dedikuar për përpunimin grafik të punimeve.

Pesë shtëpi tradicionale, që janë rilevuar janë përzgjedhur fillimisht nga Instituti për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren. Për efikasitetin dhe kontrollimin e kualiteti të punës, grupet e studentëve janë mbikëqyrur nga profesionistët e Institutit për Mbrojtje të Monumenteve dhe CHWB.

Phase II

The second phase of the project was organised within the curriculum of Prishtina International Summer University. CHwB ran course number 17, in “Traditional Architecture and Documentation Methodologies”. The collaboration between CHwB, the University of Prishtina and Prishtina International Summer University was determined through the Memorandum of Understanding, which was signed as an annex to the prior Memorandum. The responsibilities and obligations of the respective partners in the project implementation were set out in this annex.

The course took place from 12 - 23 July 2010, during which twenty students of architecture and history of art participated from various countries in this region: Kosovo, Albania, Macedonia, Turkey and Serbia. It consisted of two parts: theory and practice. The former was held in Prishtina, with lectures by Professor Emin Riza from Albania and MA. Teuta Jashari Kajtazi from Kosovo. The practical part was undertaken in Prizren, where students surveyed a traditional house in the town in one of five groups. During the first week, students worked on site, taking measurements, conducting research and collating the documentation, whilst the second week was dedicated to the graphic design of the projects. The focus of documentation consisted of five traditional houses, proposed by Institute for Protecting Monuments in Prizren. To ensure the efficiency and accuracy of the student investigations, each group was supervised by professionals from IPMPz and CHwB.

Ligjëratat

Lecture series

Nga / By: Emin Riza¹

¹Të gjitha burimet e cituara në tre leksione i atribuohen referencave origjinale të Prof Emin Rizës, por nuk janë cekur këtu.

¹All sources cited in the three lectures are attributable to Prof. Emin Riza's original references but are omitted here.

Arkitektura Tradicionale në Rajon

Traditional Architecture in the Balkan Region

Bullgaria

Banesa popullore bullgare, gjurmë të së cilës ende ruhen, ashtu si dhe përgjithësisht në vende të tjera ballkanike, i përkasin periudhës së shekujve XVIII-XIX.

Është rasti për të theksuar se Bullgaria qëndron në radhë të parë vendeve ballkanik për kujdesin e treguar në ruajtjen e banesës tradicionale. Mjaft të përmendim se 8000 banesa janë klasifikuar si monumente, krahas 19 lokaliteteve të ruajtura në vlerat urbanistike-arkitekturore. Edhe ndërhyrjet restauruese kanë qenë të gjëra, megjithëse nga sa njohim prej botimeve të artikujve dhe monografive për vlerat e kësaj trashëgimie, këto ndërhyrje ka raste që kanë e cenuar autenticitetin e vlerave historiko-kulturore të monumenteve. Botimet në fushën kërkimore janë të njohura, gjithnjë duke pasur mendime të ndryshme kryesisht për sa i përket origjinës së kësaj arkitekture, tematikë, e cila sipas nesh ka problem të karakterit metodik, probleme të cilat i ndeshim pothuajse në të gjitha studimet e derisotme ballkanike të kësaj fushe.

Banesa tradicionale bullgare në paraqitjen e saj, nuk është klasifikuar në banesë fshatare dhe qytetare, ashtu si pothuaj në mbarë paraqitjet e vendeve të tjera, përveç Shqipërisë, për të cilën kjo ndarje është tepër e qartë dhe e theksuar. Sipas nesh, kjo paraqitje, megjithëse disa arritje të banesës fshatare paraqiten shkarazi, shfaq një mungesë të rëndësishme, ndoshta e shtyrë prej idesë së gabuar se vetëm banesat me vlera


Bullgaria

As in many Balkan countries, Bulgarian vernacular dwellings that have been preserved date from the 18th and 19th centuries, and Bulgaria is ranked first in heritage conservation of this building type. Over 8000 dwellings are classified as monuments, alongside nineteen urban-architectural sites. Restoration interventions have been extensive, although published articles and monographs on heritage values suggest that there have been cases where the authenticity of the monument has been infringed. There has been much published debate concerning the origin of this architecture, but wide-ranging opinions characterise most studies in this field in the Balkans.

The Bulgarian traditional dwelling is not divided into separate rural and urban typologies, as is characteristic across the Balkans except in Albania where there is a pronounced difference. A lack of focus on the domestic vernacular, perhaps arising from the unequal focus on buildings of exceptional architectural merit, has resulted in scant documentation linking the development of traditional architecture with social and cultural trends. The classification of Bulgarian dwellings is grouped regionally, emphasising specific developments in each. From a careful survey of the documentary, photographic and graphic material presented, it is observed that urban dwellings in Bulgarian cities have undergone significant changes throughout history, increasing in size, height and

arkitekturne meritojnë të vlerësohen, duke cenuar madje rëndë vlerën dokumentare të këtyre ndërtimeve të lidhura ngushtë me mënyrën e jetesës. Klasifikimi tipologjik i banesës bullgare është kthyer sipas grupimeve rajonale, duke potencuar zhvillimet më të arritura në secilin rajon. Prej një vrojtimi të kujdesshëm të materialit të paraqitur, natyrshëm shoqëruar me atë dokumentar, grafik dhe fotografik, vërejmë se, veçanërisht në gjysmën e dytë të shek. XIX, në qytete bullgare, në saje të zhvillimit ekonomik, banesa qytetare pëson një zhvillim të ndjeshëm, duke u rritur në madhësi, trajtim arkitekturor madje edhe në lartësi. Banesat e zhvilluara në qytetin e Plovdivit, të emërtuara simetrike, të cilat dallohen për rolin parësor të sallës qendrore ndërlidhëse dhe njëherit reprezentative, tregojnë se në gjysmën e parë të shek. XIX, në Bullgari, si në mbarë Ballkanin, kishte filluar përhapja e tipologjisë, e cila lidhej me fuqizimin e shtresave tregtare dhe pronarëve të ndryshëm të kohës.

Në tipologjinë e banesës bullgare ndeshim rëndom banesa me hajat dhe çardak, madje rrallë dhe ndërtime të tipit kullë në fshatrat çifligje. Për sa i përket interiorit, në banesat e zhvilluara ndeshim rëndom formulimin arkitekturor karakteristikë kjo e brendësive, do të thoshim panballkanik, me kompleksin fundor të musandrave, dritaret e shumta të balleve me teknikën e skeletit të drurit, shpesh të dalë në formë erkeri, piktura murale në brendësi dhe më rrallë në faqet e jashtme etj. Banesat, përgjithësisht dalin në rrugë me pamjen kryesore, duke gjallëruar ndjeshëm atë.



BANESË SIMETRIKE ME TRE KATE, PLOVDIV - BULLGARI
SYMMETRIC DWELLING WITH THREE STORIES, PLOVDIV - BULGARIA



BANESË ME ÇARDAK, TRIVANA - BULLGARI
DWELLING WITH GARRET, TRIVANA - BULGARIA

architectural treatment, particularly in the first half of the 19th century thanks to rapid economic development. In this respect 'symmetrical dwellings' in the city of Plovdiv bear witness to the role of the central hall in spatial and functional arrangement, but also demonstrate alterations as a result of this economic growth by successive owners. This is the case with many buildings in Bulgaria and throughout the Balkans during the early 19th century.

Bulgarian dwellings usually feature a gallery and porch, with some kulla-type buildings (fortified stone towers) present in rural villages. Internally, pan-Balkan architectural characteristics are observed, such as in-built cupboards, multiple timber-framed windows often protruding as erkere (oriels), and murals (rarely external). The dwellings have prominent facades to the street, resulting in a lively urban articulation.

Greqia

Banesa popullore greke zë vend me rëndësi në arkitekturën popullore ballkanike. Sa i përket studimit të kësaj trashëgimie, ende nuk dallojmë punime të cilat të marrin përsipër klasifikimin tipologjik, eventualisht vendosjen në kohë të saj dhe bashkë-marrëdhëniet ndërmjet tipologjisë, të themi antike dhe asaj të shekujve, kur Greqia u përfshi forcërisht në suazën e Perandorisë turke. Autori i njohur N.Mutsopullos, në botimin për banesën popullore greke, nuk ndan banesën fshatare prej asaj qytetare, duke pamundësuar karakterizimet e veçanta në rrafshet tipologjike dhe ato arkitekturore-dekorative, dhe më tej, bashkë-marrëdhëniet e tyre në hapësirë dhe kohë. Drejtpërdrejt apo tërthorazi, ai potencon disi skajshëm lidhjen ndërmjet arritjeve të banesës antike greke me atë të shekujve në shqyrtim. Është bindëse mbijetesa e tipologjisë së banesës me hajat apo megaron, madje në mbarë hapësirën ballkanike, do të thoshim dhe e banesës së variantit të thjeshtë me çardak. Banesat e mbyllura me kat apo gjysmë kat, veçanërisht të ngritur në fshatrat me troje të pjerrët, janë mjaftë të përhapura në Greqi. Banesat qytetare të shtresave të pasura dallohen për ornamentikën e pasur me motive kryesisht orientale, si dhe motive të lashta që i kanë qëndruar kohës. Këto ndeshen si gdhendje me dru në orendimin arkitekturor dhe elemente funksionale, si: tavane, dyer, oxhakë, dritare, etj. Një vend me rëndësi në banesën tradicionale greke zënë hapësirat e ishujve të shumtë grekë, banesë e cila ende nuk i ka tërhequr vëmendjen e duhur prej studiuesve.

Greece

Greek vernacular dwellings hold a significant place in the history of Balkan architecture, but there have been no studies enabling a classification of these buildings except as a correlation between antique typologies and the arrival of the Ottoman influence. In his analysis of vernacular Greek dwellings, N.Mutsopullos does not separate urban from rural structures, making it impossible to specify in great detail the typological, architectural and decorative characteristics, and spatial and functional changes, over time. Directly or indirectly, he emphasizes a somewhat extreme link between the conception of the ancient Greek dwelling and buildings of subsequent eras. The survival of dwellings with megaron (porch) is persuasive as an early version of the galleried dwellings, and known to have been an ancient building type within the Balkans. Closed split-level dwellings are quite common in Greece, observed particularly in villages on steep ground. The urban dwellings of wealthy families are distinguished by their rich ornamentation using oriental and ancient motifs, and which have persisted over time in many architectural features such as openings, ceilings and chimneys. The traditional dwelling plays a particularly important role in the Greek islands, but which has not yet attracted sufficient attention from researchers. Mutsopullos' monograph reveals an interest in the evolution of several dwelling typologies but the examples he cites are not sufficient for drawing firm conclusions regarding their origins. The author also mentions stone towers, similar to the

Interes paraqesin në monografinë sintetike të prof. Mutsopullos skemat e evolucionit tipologjik të disa tipave banesash, pa qenë ato argument i vetëmjaftueshëm për origjinalitet të padyshimtë. Autori përmend edhe shembuj kullash, kryesisht pa funksione banimi. Mosnjohja për mungesë dokumentesh, apo dëshmish materiale, qoftë



BANESË ME GIYMËKAT NË ARKADI-PELEPONEZ - GREQI
DWELLING WITH HALF-STORY IN ARKADI – PELOPONNESE - GREECE

kulla, used mostly for non-residential functions. A lack of documentation and material evidence on the development of housing during the time of the Eastern Roman Empire in the Balkans makes it difficult to trace the changes in different dwelling typologies, and architectural and decorative elements. The theory of importation often emerges in recent reviews of architectural histories, where the importance of socio-economic conditions is not considered a generative factor in the creation of architectural prototypes, instead



BANESË ME ÇARDAK NË JANINË - GREQI
DWELLING WITH GARRET IN JANINA - GREECE

në gjendje rrënojash, të arritjeve në fushën e banesës në periudhën e përfshirjes së Ballkanit në Perandorinë romake të Lindjes, vështirësojnë tezat mbi shfaqjen e dukurive të ndryshme në tipologji, elemente arkitekturore dhe dekoracion të banesave. Është rasti për të përmendur se në paraqitjen në shqyrtim shpesh drejtpërdrejt shfaqen pikëpamje të teorisë së importimit, duke mos qenë krijuar të disa tipave kushtet ekonomiko-shoqërore, por aftësitë e etnive, si asaj greke në rastin në shqyrtim. Konsiderimi i studiuve ekstremisht hipotetik G.Mega na duket i pambështetur, sepse mbivlerësues i kategorisë hapësirë gjeografike-kulturore pa qëndruar në thelbin përcaktues të kategorisë banesë, atë të kushteve ekonomike-shoqërore. Banesa shqiptare me hajat dhe ajo me çardak ka paralele të qarta me të njëjtin tip të banesës greke. Me interes është konsiderimi i varianteve të zhvilluar të banesës me çardak në Janinë, banuar prej shumicës shqiptare deri rreth fundit të shekullit XIX, të cilat kanë paralele të qarta me banesat e të njëjtit variant në Berat e Shkodër. Edhe banesat e mbyllura prej guri në fshatrat e Epirit dhe Peloponezit, kanë paralele me banesën fshatare shqiptare të zonave kodrinore e malore, në të cilat ushtrohej kryesisht ekonomia blegtorale.

favouring the cultural influence of different ethnic groups, in this case the Greeks. However, G.Mega's hypotheses are implausible in overestimating the geographical-cultural influence without considering the socio-economic one as a crucial determining factor in the development of housing. Clear parallels can be drawn between Albanian dwellings with galleries, overhangs and porches, and similar Greek houses. It is interesting to compare the development of gallery dwellings in Janina, inhabited by a majority of the Albanian population until the end of 19th century, with dwellings of the same variant in Berat and Shkodra. Enclosed stone farmhouses in the villages in Epirus and the Peloponnese also show similarities with rural Albanian dwellings in mountainous areas.

Rumania

Me termin arkitektura popullore rumune, autorja Georgeta Stoika, siç pohon në hyrje të trajtimit të saj, kupton së pari dhe thujtëse përgjithësisht arkitekturën e banesës fshatare, në dallim prej vendeve të tjerë ballkanik, të cilët kryesisht konsiderojnë arkitekturën popullore qytetare, apo në rastin shqiptar të dy shfaqet si barazisht me vlera ndërtime-historike. E pohojmë që në krye, se material i paraqitur prej studiueses rumune shpreh të vërtetën së arkitektura popullore rumune dallohet prej asaj të vendeve tjera ballkanike, me gjasë si pasojë e shtrirjes gjeografike të këtij vendi, i cili implikon kushtet ekonomik-shoqërore dhe më gjerë, në mënyrën e jetesës disi të shkëputur prej bashkësisë ballkanike. Banesa popullore rumune, përsërisim, kryesisht fshatare, është e ndarë apo e klasifikuar sipas kriterit të zonave etnografike, gjithmonë duke shfaqur njësi në tiparet themelore dhe ndryshueshmëri në dytësoret, pa përjashtuar tipa me përhapje zonale. Ashtu si në kategorinë arkitekturore popullore në përgjithësi, faktorë si karakteri i ekonomisë, marrëdhëniet shoqërore, materiale vendore dhe llojit të truallit, paraqesin shkaqet thelbësore në përcaktimin e mbisundimit të një tipologjie të caktuar, në një zonë të caktuar. Në përgjithësi, në arkitekturën popullore rumune mbisundojnë banesat familjare me përmasa të vogla përdhese dhe me kat, të mbyllura apo me hajate, çardaqe si dhe qoshqe të gjerë, shpesh të hapur vetëm në volumnin në kat. Edhe ndërtimet mbrojtëse të tipit kullë, me tipare të formulimit volumor dhe atij të jashtëm, disi të

Romania

In the introduction of her review, the Romanian author, Georgeta Stoika, recognises Romanian vernacular architecture as that of rural dwellings, in contrast to other Balkan regions that are defined by an urban vernacular or, in the case of Albania, both urban and rural demonstrating historical prominence. The material submitted by the Romanian researchers reveals a folk architecture that differs from that of other Balkan countries, probably resulting from the country's geography, and which implies that the social and economic conditions and traditional lifestyle were somewhat detached from the rest of the Balkan community. Romanian popular dwellings, mostly rural, are classified according to ethnographic areas, each demonstrating the same primary features but with which secondary features of local and regional variables interact. Factors such as the nature of the economy, social relations, local materials and soil type are fundamental in influencing the typology of a given area. In general, Romanian residential architecture consists of small, two-storey family dwellings, wholly enclosed or sometimes with a porch, with open and closed galleries (qoshk), and often of an open floor plan. Defensive kulla-type structures, with unique spatial arrangements and external articulation, can also be found, with the upper floor functioning as the gallery (çardak), and expressed by an arched arcade. The construction of wooden and half-timbered houses is also notable, with early examples being constructed using the common technique of overlapping

veçantë në bashkësinë e gjerë të ndërtimeve kullë, ndeshen në Rumani, duke pasur parasysh katin e sipërm, shpesh një lloj çardaku me ballë kolonash të lidhura me hark. Për t'u shënuar janë edhe ndërtimet e gjëra të banesave prej druri apo pjesërisht prej druri. Të parat janë ndërtuar me teknikën e njohur të mbivendosjes së shtyllave prej druri. Edhe mbulesat prej pllakash druri krahas atyre me kashtë, shkallëve të jashtme prej druri, që të çojnë në çardak i japin shtëpisë tradicionale rumune karakteristika të dallueshme, duke e shkëputur, do të thoshim ndjeshëm prej banesës ballkanike në jug. Enterierët e thjeshtë të banesës rumune ndër të cilët dallohet oda e zjarrit dhe ajo e qëndrimit, shquhen për oxhaqe të bashkëlidhur me njësi më vete me furrë dhe elemente të tjerë me funksione ngrohëse. Në banesën rumune nuk ndeshen elementet e njohur të orndimit arkitekturor, as dekorit i pasur me temat dhe teknikat e njohura, siç janë përhapur në hapësirën jugore të Rumanisë, tregues ky i cili krahas përmendjeve të tjera, e vë këtë banesë në një pozicion disi të veçantë në bashkësinë ballkanike gjatë shekujve XV-XIX.

wooden vertical members. Other distinct features of the traditional Romanian house are the use of timber tiles and straw roofing and the external wooden stairs to the upper floor, which sets it apart from vernacular dwellings of the southern Balkans. The interiors are simple and generally comprise a 'hearth room' and living room. The chimneys are characteristic and attached to a separate unit containing the oven and other heating elements. Their unusual architectural expression and rich ornamentation are unique in the Balkans, allowing the Romanian vernacular dwelling to occupy a position of note in architectural histories of the 15th and 16th centuries.



BANESË PREJ DRURI NË KARBUNESHTI - RUMANI
WOODEN DWELLING IN KARBUNESHTI - ROMANIA



OXHAK NË ODËN E NIË BANESE NË TRAISTENI - RUMANI
VIEW OF A STOVE IN A DWELLING IN TRAISTENI - ROMANIA

Turqia

Banesa popullore turke, zë vend me rëndësi në arkitekturën e banesës ballkanike të shekujve XV-XIX. Arsyet janë të shumta, së pari duhet të mbajmë parasysh së gjatë periudhës në shqyrtim bashkë-sia shumëtnike ballkanike ishte përfshirë në sistemin politik të Perandorisë turke. Më tej, për arsye të kuptueshme shtresat e drejtuesve shtetëror dhe në përgjithësi shtresa e pasur e hapësirës së këtij entiteti politiko-administrativ shumëkombësh, i përkiste etnisë turke, e cila natyrshëm, veçanërisht rreth fundit të shekullit XVIII dhe kryesisht në shekullin XIX, ndërton banesa me vlera të rëndësishme arkitekture të cilat në kompozim, dhe veçanërisht në trajtimin arkitekturor dhe dekorativ patën ndikim për shtresat paralele të etnive të tjera, pjesë e Perandorisë. Banesa turke, që para Luftës së Dytë Botërore, është bërë objekt studimi prej kërkuesit të njohur Sedat Eldem.

Autori i monografisë së botimit në shqyrtim, Haluk Sezgin, dhe bashkëkohësi i tij Reha Gunai, kanë dhënë ndihmesë të prekshme për karakterizimin e banesës turke dhe më tej vendin e saj në bashkëmarrëdhënie me popujt ballkanikë. Pohojmë që në krye se si studiuesit grekë të kësaj fushe, ashtu dhe ata turq, drejtpërdrejt apo disi tërthorazi, mbështesin teorinë e importimit të arritjeve, të themi prej popujsh krijues në përvetësues. Besojmë se është me rëndësi të theksojmë se, vepra e Eldemit është me vlera të spikatura për sensibilizimin, krahasimisht të hershëm, për

Turkey

The Turkish vernacular also occupies an important place in the history of Balkan domestic architecture of the 15th and 16th centuries. It must be remembered that the multiethnic community that comprises the Balkans was tied into the political system of the Ottoman Empire, centred in Turkey, at this time. The social and political elite of the Ottoman administration were ethnically Turkish, and brought with them architectural styles, values and methods of construction which began to influence residential buildings at the end of the 18th and during the whole of the 19th centuries, especially in spatial composition and decoration.

Turkish dwellings have been the subject of study by the renowned Eldem Sedat since the beginning of World War II, to which have added the research of Haluk Sezgin (the author of the monograph being reviewed here) and Reha Gunai. Together they have provided a noteworthy contribution to the classification of Turkish dwellings, and located its role in relation to architectural development in the Balkan countries. Both Greek and Turkish researchers support the theory of the importation of artistic, architectural and constructional technologies, perceiving it as a creative percolation from imperial nations into conquered ones, and Sedat argues in favour of the idea that an Ottoman architecture was dispersed throughout the Empire. It is important to emphasize that his studies are highly valued for their sensitivity in the field of the domestic

krijimtarinë në fushën e banesës. Ai është marrë thuajse përjashtimisht me tipat apo variantet e zhvilluar të tyre, duke mos trajtuar apo mos gjurmuar banesën fshatare dhe në përgjithësi tipat e thjeshtë të banesave. Ai shfaqet si përkrahës i idesë së përhapjes së banesës turke në mbarë hapësirën e Perandorisë. Përpara së të qëndrojmë te vepra e Sezginit, theksojmë nivelin profesional të studiuësit Gunai, i cili shquhet për prirjen analitike, bazë e çdo kërkimi. Sipas nesh, ai me shumë të drejtë pohon se me banesë turke kuptojmë banesën në të cilën banonin turqit, duke qenë thuajse i të njëjtit mendim të shprehur, prej nesh "me banesë shqiptare kuptojmë banesën e ndërtuar përgjithësisht prej shqiptarëve për shqiptarët". Është rasti për të rikujtuar pohimin e një studiuesi francez, i cili pohon: "të flasësh për banesë turke është po aq spekulative sa të flasësh për banesë romake". Është fjala për t'iu kundërvënë idesë tejet diletanteske se etnosi mbajtës i pushtetit politik është njëherazi dhe cilësuesi i krijimtarisë ndërtimore edhe të etnive tjera të bashkëpërfshira në të njëjtën njësi politike.

Le të ndjekim tani paraqitjen sintetike të Sezginit, i cili gjithnjë duke theksuar me të drejtë kulturën e përbashkët të popujve ballkanikë, pa cilësuar burime të themi udhëheqëse, me banesë turke trajton thuajse vetëm arkitekturën e banesës qytetare, ne do të thoshim për mungesë gjurmimesh në vendbanimet fshatare. Ai hedh tezën se banesa megaron, apo me hajat për të cilën ai përkrah mendimin se ajo nuk njihet që

vernacular, but although the breadth of his research covers most domestic typologies and their respective developments, it has not tracked basic and rural dwellings. The work of Gunai is also well-respected as a basis for objective research since he emphasises the importance of unique local influences that have shaped domestic vernaculars, admitting that Turkish dwellings must be understood as representative of and befitting a resident Turkish population rather than characteristic of the local Balkan community under the Ottoman Empire. It mirrors an understanding of the Albanian vernacular as "...dwellings constructed by Albanians for Albanians" It counters the idea that the nation in political and administrative power is also the source of creative, social and cultural identity of those under its control.

Sezgin considers only urban Turkish dwellings and lacks investigations into rural settlements. He emphasises the common culture of Balkans and his thesis supports the opinion of the megaron as prototype for Turkish vernacular architecture, but dates its emergence not from the Hellenistic period but from 2000 B.C. As previously mentioned, the gallery-and-porch typology has a long history across a large area in the Balkans, and its composition is still characteristic in the Mediterranean today. However, Sezgin appears to greatly overestimate the importance of this early house type. Social and economic conditions in the region have varied greatly over this immense period of time, and would have affected

prej periudhës helenistike, por njëzet shekujt para erës sonë, është në bazën e banesave popullore turke. Siç kemi përmendur, banesa me hatat është një tip sa i lashtë dhe i thjeshtë aq edhe i përhapur në hapësirë dhe në kohë, madje në thelbin e tij kompozicional edhe sot e kësaj dite, përgjithësisht në banesën mesdhetare. Vënia në bazën e banesës turke të kësaj banese na duket e tejvlerësuar dhe e papranueshme si metodikisht ashtu edhe faktikisht. Metodikisht, sepse kushtet ekonomiko-shoqërore nuk mund të jenë të njëjta për 22 shekuj, për të ruajtur të njëjtën banesë dhe faktikisht, sepse banesa turke ka arritje, do të thoshim madhore, kur kemi parasysh variantet e zhvilluara të saj, siç i ndeshim në tipologjinë e Eldemit, sipas nesh të tejkaluar me njohjet e reja.

Gjithashtu, lidhur me njësinë odë, një prej përbërësve sa të njësuar rreth shekujve XVIII-XIX në banesat me arritje të themi të mesme dhe madhore në rrafshet kompozicionale dhe të trajtimit arkitekturor dhe dekorativ të tipologjive të ndryshme, thuajse në mbarë Ballkanin, ne kemi hipotezën tonë. Përkrahja e tezës së oda, si kompozim, e paska origjinën prej tendës turke na duket thjesht hamendje. Pa qenë të bindur në sa më poshtë për mungesë dëshmish të kategorive të ndryshme, ne i mbahemi idesë se në prag të pushtimit osman të kryeqytetit të Perandorisë Romake Lindore, më 1453, në hapësirat e kësaj njësie të lashtë dhe me arritje të përfillshme në rrafshet kulturore e jetësore edhe banesa ka pasur arritje, njëra prej të cilave besojmë të jetë ajo e unifikimit të kompozimit të njësisë odë. Trajtimi i ornamentikës së saj në shekujt XVIII-XIX me dukuri të qarta të

the use and composition of the dwelling. It has also been widely noted that the Turkish house has undergone numerous developments and variations, and as demonstrated by Sedat's taxonomy.

A classic architectural characteristic of domestic architecture across the Balkans during 18th and 19th centuries has been the oda, present in the homes of important and wealthy families, and unique in spatial arrangement, architectural expression and decorative treatment. It has been argued that the origin of the oda lies in the Turkish tent, but this has been dismissed as conjecture. By the time the Ottomans arrived in Constantinople in 1453 the oda had already been established as an intrinsic part of the dwelling and accompanied by significant achievements in housing and cultural life. Irrespective of religious background, ornamental decoration from the 18th and 19th centuries, with obvious oriental motifs, had been spread throughout the Balkans by the shifting populations and in-migration of Turkish settlers, but is not considered as Turkish in origin. The replacement of moveable furniture with architectural elements can be explained in terms of a modesty of lifestyle and is likely to be a concept introduced by the Arabs and the conversion to Islam.

kulturës orientale, bartur dhe përhapur prej turqve në popullsitë e Ballkanit, pavarësisht prej besimit, nuk ka se si të konsiderohet krijesë turke. Mungesa e mobileve dhe zëvendësimi i tyre me mobilimin arkitekturor, ka shpjegim në kushtet modeste të jetesës dhe me gjasë mund të jetë një koncept i ardhur prej arabëve tek, të cilët lindi islamizmi, i cili ende parapëlqen qëndrimin të themi të improvizuar mbi thujtje çfarëdo rrafshesh.



INTERIER I NJË DHOME TË NJË BANESE NË SEMAKI - TURQI
INTERIOR OF A ROOM IN A DWELLING IN SEMAK - TURKEY

Ish-Jugosllavia

Së fundi, shtjellojmë banesën popullore të hapësirës politike Jugosllavi, krijesë artificial prej kancelarive me peshë evropiane pas Luftës së Dytë Botërore, e cila tashmë është copëzuar. Ne do të mbështetemi në këtë paraqitje, gjithë duke pasur parasysh realitetin e deformuar politik, i cili thujse sot ka marrë rrugën e zgjidhjes përmes kriterëve të pranuar ndërkombëtarisht. Për arsyet e përmendura më sipër, atë të studimeve të pa shtrira barazisht dhe në thellësinë e duhur në hapësirë dhe kohë paraqitja në shqyrtim, shfaqet së pakti problematike. Në klasifikimin tipologjik, nuk ndeshen as dallimet banesë fshatare-banesë qytetare. Prej kësaj paraqitje vërejmë ndërtimin e banesave prej guri me gjysmëkat dhe kat prej guri, veçanërisht bregdetin dalmatin, krahas banesave me hajat dhe çardak. Për t'u shënuar janë banesat e Bosnjë-Hercegovinës, në të cilat ndeshen rëndom trajtesat e njohura të odës të shekujve XVIII-XIX, përhapur përveç Rumanisë, Sllovenisë etj. edhe në mbarë Ballkanin.

Tashmë thujse është pranuar prej mbarë studiuesve të arkitekturës popullore ballkanike, kryesisht në planin etnik, krahas përpjekjeve të para për të vështruar këtë krijimtari në hapësira më të gjëra se ajo, për disa arsye është një krijimtari me paralele të dalluara. Është fjala për një krijimtari kryesisht në shekujt XVIII-XIX, për të cilën ruhen ende dëshmi të prekshme në këmbë apo në formë rrënojash, krahas shembujve më të hershëm, përgjithësisht të dalë në dritë prej gërmimeve arkeologjike

Former Yugoslavia

The final part of this analysis examines the residential dwellings of the Former Yugoslavia after World War II. The proximity of this period to now will arguably result in bias, and previously distorted political realities have resulted in problematic, shallow and unequal research that has been open to much interpretation, but which is now being modified through the lens of accepted international criteria. Geographically and historically, there has been less focus on smaller local derivations and more on comparisons between regions of Former Yugoslavia, without distinguishing particularly between urban and rural differences.

Besides the gallery-and-porch style dwelling, there is evidence of the construction of stone dwellings with split level floors, especially on the Dalmatian coast. The residential vernacular of Bosnia-Herzegovina is also noteworthy, and the oda arrangement typical of the 17th - 19th centuries can be seen across the Balkans from Slovenia to Romania.

Along with the initial efforts to analyse the architectural influences and constructional creativity in a much broader sense, scholars agree that the Balkans offers fascinating studies on domestic vernacular architecture that is particularly rich in the diversity of its ethnic origins and development. There still remains some tangible evidence of this which dates from the 18th and 19th centuries, although it is generally in poor repair

apo tipave ose varianteve të lashtë të ndërtuar gjatë shekujve të përmendur prej shtresave të skamura të popullsisë fshatare dhe qytetare. Njësia është e hetueshme përgjithësisht, në tiparin thelbësor të banesës, kompozimin e saj, krahas materialeve, teknikës së ndërtimit dhe më qartazi në dekoracionin e elementeve dhe mobilimit arkitekturor. Njësia dhe dallimet qëndrojnë në bashkëmarrëdhënie të dendësive të ndryshme prej konsiderimit të hetimit të tyre. Sa më gjerë të rrokët kjo krijimtari, aq më shumë hollësitë mbeten në plan të dytë, duke u bërë objekt trajtimi dhe krahasimi tiparet më të dalluara. Përkundrazi, sa më afër të shihen dukuritë, pra në hapësira më të vogla të themi etnike, aq më shumë gjejmë motive për ndarje të mëtejshme të dukurisë.

Prof. Dr. Emin Riza

Anëtarë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

or in ruins. Recent archaeological excavations are revealing earlier settlements and architectures, in both urban and rural settings.



ODË E NJË BANESË NË MOSTAR – BOSNIË&HERZEGOVINË
A ROOM IN A DWELLING IN MOSTAR – BOSNIA&HERZEGOVINA

Prof. Dr. Emin Riza

Member of the Academy of Sciences of Albania

Banesa qytetare kosovare e shekujve XVIII-XIX dhe klasifikimi i saj²

Kosovar Urban Dwellings of 18th -19th centuries and their classification²

Banesa qytetare kosovare e shekujve XVIII-XIX, në kontekstin e kësaj monografie, është tërësia e banesave të ngritura në mbarë qytetet e hapësirës së Kosovës, në periudhën kohore të përmendur, pavarësisht prej përkatësisë së porositësit dhe ndërtuesve, tipit dhe vlerave arkitektonike- teknike.

Emërtimi banesë lidhet me kuptimin parësor të kësaj kategorie ndërtimore, të krijuar që në muzgun e jetës njerëzore. Cilësori i dytë kosovare, lidhet me përfshirjen e këtyre qyteteve në hapësirën qartësisht të përcaktuar të Kosovës. Kufizimi i kohështirjes së kësaj dukurie, kushtëzohet prej së vërtetës se ndjekja e saj është e mundshme gjatë këtyre dy shekujve dhe kryesisht atij të XIX, nëpërmjet shembujsh që ruhen ende në këmbë, apo prej atyre të dokumentuar. Pa kaluar në hipoteza pa vlerë, këta shembuj lejojnë të pohojmë se variante të thjeshta të tipologjive të ndryshme duhet të jenë njohur në hapësirën e Kosovës edhe përgjatë shekullit XVII.

Cilësori kosovare, duhet konsideruar në kontekstin historik dhe atë bashkëkohor, si përcaktues krahorin i shtrirjes së etnisë ilire-arbërore-shqiptare. Si shprehës i kësaj të vërtete kjo krijimtari do të cilësohej saktësisht banesa qytetare shqiptare e Kosovës gjatë shekujve XVIII-XIX, por në parapëlqejmë variantin e shkurtuar, siç praktikohet kudo në raste paralele.

Houses and settlements have been the predominant form of construction since the dawn of civilisation. In this, we must first identify the nature of what it is to be a 'citizen', and secondly to describe the development of the 'Kosovar' dwelling, all within the defined territory of current-day Kosovo.

Urban dwellings in Kosovo from the 18th and 19th centuries, in the context of this monograph, includes the whole scope of constructed urban dwellings, regardless of client, investor, builder, architectural fashion and technical developments. This research is limited to extant examples and already documented buildings, dating from the 19th century, but allows us to hypothesise on earlier variants from which the differing typologies may have arisen dating from as early as the 17th century.

In the historical and contemporary context the definition Kosovar is considered as local derivation of the Illyrian-Arb-Albanian ethnic expansion. Kosovar urban dwellings can be read synonymous with Albanian urban dwellings during 18th and 19th centuries. The differences between urban buildings and those in rural villages are consistent throughout both Kosovar and Albanian territories, and relate to fundamental changes in their functional character which reflected changing social and economic circumstances and lifestyles. It must be noted, too, that this separation of the urban-rural relationship is dynamic and interactive, shifting in focal point and density over time. The sensitivity to vernacular architecture in

²Riza, E. & Haliti, N. Banesa qytetare kosovare e shek XVIII - XIX, 2006

Diferencimi i banesës qytetare prej asaj fshatare në hapësirën e Kosovës, si dhe në atë mbarëshqiptare, lidhet me ndryshime thelbësore në karakterizimin e këtyre dy kategorive të njëjta ndërtimore për sa i përket funksionit. Këto ndryshime janë pasqyruese të kushteve të ndryshme jetësore, pra të rrethanave të ndryshme ekonomiko-shoqërore. Pa u ndalur në këtë temë të gjerë, do të pohojmë se kjo ndarje nuk përjashton marrëdhëniet banesë qytetare-banesë fshatare, por i konsideron ato si bashkëvepruese, me kahje dhe dendësi të ndryshme në hapësirë dhe kohë.

Siç dihet, ndjeshmëria mbi vlerat e arkitekturës popullore edhe në vende me tradita të hershme kulturore në Evropë, është krahasimisht e vonë dhe i përket gjysmës së dytë të shekullit XX. Kështu edhe në hapësirën e Kosovës, ashtu si edhe në mbarë vendet ballkanike, interesimi për vlerat e arkitekturës popullore, të lidhur thuajse tërësisht me kategorinë e banesës, i përket periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Për arsyet e njohura, hapësira e Kosovës u përfshi që në fillim të shekullit XX në suazën e Serbisë, kështu që krijimtaria shqiptare në përgjithësi dhe ajo e arkitekturës popullore kosovare në veçanti, iu nënshtrua trajtesave, në thelb jashtëshkencore, në shërbim të idesë absurde të Serbisë historike, alias ekspansionit më të gjerë, por kohëshkurtër të Stefan Dushanit. Kështu, krijimtaria shqiptare, e kryer prej shqiptarësh për shqiptarë në trojet e Kosovës, në fushën e arkitekturës popullore, u shkëput sa

the Balkans has developed comparatively late even in countries proud of their ancient cultural traditions, a theme which only belongs to the latter half of the 20th century. In Kosovo, as in much of the Balkans, popular architecture taste favoured buildings constructed after World War II. As Kosovo came under Serbian administrative territory at this time, the Kosovar vernacular that had developed over history was never researched and documented objectively, instead falling under the general umbrella of Serbian architecture. Indeed, a specific Kosovar architecture was actively disassociated from its historical roots, being distorted and misrepresented for wider political purposes. The rich legacy of the Albanian vernacular was ignored and left open to subjective interpretation, in violation of its historical, cultural and scientific value.

This monograph is based on extensive material relating to Kosovo's traditional dwellings of the 18th and 19th centuries, and is linked to a number of buildings placed under protection for their historical architectural value. Although few buildings are classified as monuments, those that have been exhibit high architectural value or demonstrate a major achievement in the development of a specific typology, and is thus representative of the creative achievement of a period.

Technical documentation and studies on a number of these dwellings were published by researchers, mainly of Serb nationality, providing an

artificialisht aq edhe prerë prej trungut të saj të natyrshëm. Në këtë kontekst, kishin humbur, për të mos thënë qenë dhunuar kushtet për studimin e kësaj krijimtari, e cila për thujse gjysmë shekulli u bë objekt shtrembërimesh dhe pseudotrajtimesh në kundërshtim të hapur me funksionin e saj parësor si dëshmi historiko-kulturore e porositësve dhe shfrytëzuesve të saj. Është pikërisht kjo rrethanë, që njëra prej trashëgimive më të pasura të fushës së arkitekturës popullore qytetare, në plan shqiptar dhe ballkanik e më gjerë, të shpërfilllet, të lihet thujse pa mbrojtje dhe jashtë interesimeve njerëzore për vlerat e vërteta shkencore të saj.

Monografia është hartuar mbi bazën e materialeve të gjëra, që lidhen me banesat tradicionale kosovare të shekujve XVIII-XIX. Ato së pari kanë lidhje me një numër banesash të vëna në mbrojtje për vlerat e tyre arkitekturore. Këto të pakta në numër, dhe të përcaktuara si monumente kryesisht për shkak të vlerës arkitekturore, si arritje madhore e një tipologjie të caktuar, kanë përbërë një mbështetje të prekshme për tiparet dhe karakterin e kësaj krijimtari.

Më tej, studimet mbi një numër banesash qytetare kosovare të shekujve XVIII-XIX janë botuar prej studiuesve, kryesisht të kombësisë serbe, së bashku me dokumentacionin teknik, i cili lejon të njihet, madje saktë, kompozimi vëllimor, përbërësi themelor i banesës. Krahas atyre që u përmendën më lart, vend të rëndësishëm në monografi kanë zënë mjaft



SHITËPITË E SARAJIT
SARAJ HOUSES



PAMJE NGA ENTERIERI I SHITËPISË ADEM AGA GJONI
VIEW OF INTERIOR IN ADEM AGA GJON HOUSE

accurate record of building volume and arrangement as a basic component of the dwelling. In addition to those already mentioned, there have been many surveys conducted in Gjakova, with fewer in Prishtina, Peja, Gjilan and Janjevo. The documentation obtained in 1955-56 has priority since they record buildings in good condition and which had not been subject to profound changes.

Writing the date on houses during construction or reconstruction in this period is a rare occurrence in Kosovo and the Balkans but, where present, can be considered a decorative architectural treatment. However, analysing function, material and construction is another method, albeit providing a less precise estimate regarding date.

The endurance of these various dwelling typologies as a sustainable and relevant mode of living means that Kosovo does not lack examples for study, due the relative stability of socio-economic conditions in the 18th and 19th centuries in comparison to preceding epochs. Dating Kosovar houses by its ornament, as is an accurate method with many centres of the Ottoman Empire, is also appropriate here although care must be taken to recognise the effect of stylistic influence or borrowing in peripheral urban centres. The nature of hypothesis, even if based upon seemingly reliable data, must also fit with other conclusions drawn from the analysis and synthesis of primary documentary sources.

rilevime banesash tradicionale kosovare të shekujve XVIII-XIX, kryesisht të Gjakovës dhe më pak të Prishtinës, Pejës, Gjilanit, Janjevës, etj. Këto dokumentime të kryera gjatë viteve 1955-56, kanë përparësinë, sepse në ato vite këto banesa ruheshin në gjendje të mirë teknike dhe nuk iu kanë nënshtruar ndryshimeve të thella tjetërsuese.

Datimi i banesave me mbishkrime, gjatë ndërtimit apo rindërtimit, është një shfaqje tepër e rrallë në hapësirën e Kosovës, ashtu si thuhet në mbarë Ballkanin në shekujt XVIII-XIX. Si element datues, vijnë në konsiderim trajtimi arkitektonik-dekorativ i elementeve të ndryshme funksionale të banesave, materialet dhe teknika e ndërtimit. Duke qenë se treguesit e mësipërm nuk janë trajtuar sistematikisht në rrafshet tipologjike dhe kronologjike, fusha e datimeve, padyshim e rëndësishme, mbetet në përcaktime të përafërta.

Mungesa e shembujve të mjaftueshëm për një tipologji të caktuar, në mbarë shtrirjen hapësinore të dukurisë, në rastin e dhënë në mbarë qytetet kosovare, nuk shfaqet problematike për shkak të qëndrueshmërisë relative të tipologjisë së banesës. Kjo qëndrueshmëri është pasqyruese e qëndrueshmërisë relative të kushteve ekonomiko-shoqërore të kohës, me ecje krahasimisht të ngadalshme gjatë shekujve në shqyrtim. Kështu edhe prania e një numri të vogël shembujsh, madje edhe e një të vetmi në një qendër, mundëson kundrimin e dukurisë.

For a long time, the Albanian-inhabited territory of Kosovo was, as with much of the Balkans, included within the political frame of great powers such as the Eastern Roman, Byzantine and Ottoman Empires. The indigenous people of Kosovo were naturally involved in the cultural life of these imperial dynasties, but retained their ethnic individuality by continuing to construct the dwelling as a utilitarian space that was open to rational, practical changes. Thus, the Albanian urban dwellings in Kosovo cannot be read purely as an original typology, since its realisation and expression depended on the ethnicity of its builders and users, and open to outside influences and migrating populations.

In this context, many parallels can be drawn between Balkan dwellings of the 18th and 19th centuries, but these similarities do not necessarily arise from a correlation in way of living. This contradiction has arisen from the varied geography and alternative histories of the Balkans, and is often subject to political, national or personal interpretations.

In varying degrees, the factors affecting the features of traditional housing were social and economic conditions, materials and construction techniques, craftsmen, land plots and climate. The socio-economic influence – that of social development and economic success, and a population's commitment to, and differentiation of, its wealth, trade and cultural relations from its neighbours - appears to be the determining factor

Vendosja kohore e banesave qytetare kosovare sipas elementeve të ornamentikës, të datuara deri diku saktë në qendra të zhvilluara të Perandorisë Turke, duhet kryer me kujdes, për shkak të shfaqjes së vonshme të dukurisë prej metropoleve në qendra qytetare, thuajse periferike, kur është fjala për ndikime apo huazime. Me gjithë konsideratat e mësipërme, për të qartësuar vërtetësinë e trajtimit të temës, përfundimisht mund të pohojmë se kjo përpjekje mbështetet mbi të dhëna të mjaftueshme dhe të besueshme, të cilat do të mbështesin çdo pohim dhe aq më tepër përpjekjet përgjithësuese në rrafsh të ndryshme. Do të pohojmë se hipotezat, gjithnjë duke qenë pjesë e kërkimit shkencor, do të jenë të pakta, duke parapëlqyer përfundimet që rrjedhin natyrshëm prej analizës dhe sintezës së materialeve dokumentare.

Trojet shqiptare të Kosovës, ashtu si përgjithësisht ato ballkanike, u përfshinë gjatë në suaza politike perandorish të mëdha, romako-lindore apo bizantine dhe turke. Banorët autoktonë të Kosovës apo krahinarisht kosovarët, gjithnjë duke ruajtur individualitetin etnik, u përfshinë natyrshëm në klimën kulturore të këtyre hapësirave perandorake, duke e shikuar banesën si objekt të mirëfilltë utilitar dhe si të tillë të hapur për përvetësim të rejash dhe arritjesh racionale, në përgjithësi. Kështu, banesa shqiptare e Kosovës dhe posaçërisht ajo qytetare, nuk është krejtësisht origjinale, sepse nuk mund të ishte e tillë, gjithnjë duke u lidhur me etninë e ndërtuesve dhe shfrytëzuesve të saj.

in the architectural expression and character of a building, particularly in the domestic sphere. Kosovo's civic life of this period differed markedly from its current character, being rather a centre for artisan production and trade, closely linked to its surrounding agricultural activities. The 19th century Kosovar family was almost totally self-sufficient in food production, involved in animal husbandry, the cultivation of fruits and vegetables, and the preservation, storage and upkeep of these resources during the cold months. The women of a community were engaged collectively in processing agricultural products and knitting textiles for clothing. This necessary multi-functionalism of the dwelling generated appropriate spatial compositions, from which evolved a traditional house typology.

The Kosovar dwelling has even inspired ethno-psychological interpretations. The culture of hospitality (as expressed in Article 96/602 in the Code of Lek Dukagjini: "The Albanian house is the house of God and friend") plays a prominent role in the spatial arrangement and inhabitation of the house. The guests' room (oda) is a common central element of the self-contained house; richer families were able to construct separate buildings especially to house their guests, which developed into important arenas for local political activity and decision-making and which left a mark on the administration of the country as a whole. The development of a separate oda building to house guests cannot be attributed solely to the Turkish influence, but must also belong to this core of Albanian

Në këtë kontekst, në banesën e popujve ballkanik të shekujve XVIII-XIX ka afërsi dhe deri në paralele, të cilat do të pësonin interpretimin më pak të saktë, nëpërmjet pikëpamjeve të importimit mekanik të dukurive të lidhura ngushtas me mënyrën e jetesës si banesa. Kontradiktat e mësipërme kanë gjetur përhapje të gjerë në fushën e banesës popullore ballkanike, duke konsideruar qendra të supozuara rrezatuese arritjesh, në hapësirë dhe kohë dhe, më keqas, duke bërë bartës arritjesh paraprijëse etni pjellore, përgjithësisht ato që kanë pasur peshë kryesore politike në hapësirat shumëkombëshe perandorake.

Ndër faktorët që përcaktojnë, në shkallë të ndryshme, tiparet e banesës tradicionale, përmendim kushtet ekonomiko-shoqërore, materialet dhe teknikën e ndërtimit, mjeshtrit e ndërtimit, truallin, klimën etj. Kushtet ekonomiko-shoqërore, ashtu si thuajse në mbarë veprimtarinë ndërtimore dhe posaçërisht në banesë, shfaqen si faktori themelor përcaktues i tipareve dhe karakterit të kësaj kategorie ndërtimore. Me kushte ekonomiko-shoqërore kuptojmë shkallën e zhvillimit të shoqërisë, në arealin në shqyrtim, në sferën e zhvillimit ekonomik, angazhimet jetësore të popullsisë, diferencimin pasuror të saj, marrëdhëniet tregtare dhe kulturore në hapësirat rrethuese të saj. Banesa e qyteteve të Kosovës në shekujt XVIII-XIX, i përgjigjet një shoqërie qytetare të ndryshme në kuptimin bashkëkohor të termit, për shkak të karakterit të qytetit të kohës. Ai, siç kemi përmendur në periudhën në shqyrtim, ishte qendër e prodhimit

tradition with respect to hospitality. In the case of Muslim communities, religious influence within the dwelling is demonstrated by the presence of a bathroom in each bedroom for couples. This solution appeared as a result of the high level of hygiene demanded by religion but expressed as a profane, practical necessity.

This ethno-psychological reading has a real place in an understanding of the Albanian dwelling, and consequently of Kosovo's urban dwellings of the 18th and 19th centuries. As a vital source of life and continuity, the Albanian relationship to land is powerful - worth defending to the death - and is still present in the contemporary conception of house and territory as witnessed by the current emphasis on construction, even if it is beyond a family's economic ability. Through its dimensions, arrangement and other expressive elements, the dwelling is seen to describe the family within it; the use of expressions such as "great family", "strong family", "strong door", "precious family", "well-known family" and "noble family" are significant in this respect. Clearly, social and economic conditions also determine the type of dwelling – its volume, composition, the number of spaces and their treatment, the surrounding landscape – while additional factors such as material and construction techniques affected the appearance, endurance and expression of the building. Materials and construction techniques are the most constant factors of buildings, and are less open to the stylistic changes of, for example, architectural decoration.



SHTËPIA E ADEM AGA GJONIT
ADEM AGA GJON HOUSE

zejtar dhe këmbimit, pa u shkëputur prej veprimtarisë bujqësore. Familja ishte thuajse e vetëmjaftueshme në sigurimin e ushqimit dhe përpunimit të tij. Ajo kishte kafshët e ngarkesës dhe shpesh bagëti, kultivonte zarzavate dhe fruta në oborret e gjëra dhe siguronte rezerva ushqimore për stinët e ftohta për pjesëtarët e familjes dhe kafshët. Gratë e familjes përpunonin produkte të ndryshme bujqësore dhe endnin shtresa dhe pëlhura për veshje. Ky multifunksionalizëm i banesës tradicionale kërkonte zgjidhje kompozicionale të përshtatshme dhe hapësira në kategorinë banesë.

Momenti etno-psikologjik është po ashtu i pranishëm në konceptimin e banesës, kështu kulti i mikpritjes i shprehur ngjeshur në nyun 96\602, të Kanunit të Lek Dukagjinit “Shpija e shqyptarit asht e Zotit e mikut”, gjen shfaqje të prekshme në odën e miqve, me paraqitësen e mbarë banesës. Në shtresat e pasura, ndërtohet një ngrehinë e posaçme “shtëpia e miqve” për miqtë jashtë rrethit familjar. Institucionet e pakta publike dhe në përgjithësi jeta e varfër shoqërore e kohës, i kthente shtëpitë e shtresave të pasura, shpesh të bashkëpërfshirë në rrjedhat problemore të vendit, në qendra të vërteta ku kryheshin veprimtari me përmbajtje të qartë politike. Pa anashkaluar ndikimin turk në këtë dukuri, nuk e shohim atë si të vetmen arsye për dukurinë e ndërtimit të një ngrehine të veçantë për miqtë në bashkësinë banesë. Si element të ndikimit fetar në banesë, në rastin e dhënë të myslimanizmit, do të konsideronim praninë e banjës në hapësirat e çdo dhome gjumi për çifte. Ashtu si shumë veprime të

of societal development at that time, readily available and local constructional materials such as stone, wood, soil and sand, and other untreated natural materials were widely used, as were traditionally processed lime, clay and tiles, used in finishing a building. The type of constructional material employed did not affect the spatial composition of the house. Stone masonry had been used for centuries prior to the comparatively recent arrival of clay brick-filled timber framing, or lath. The latter techniques had the advantage of permitting large, easily constructed buildings and the enlarging of windows, and even their disposition consecutively across a facade.

These dwellings have arisen from the interrelation of material and construction techniques in the hands of the local craftsmen (mjeshtri popullor), and developed over centuries of experience with limited opportunities for innovation. The building concepts and techniques (such as masonry, timber reinforcement, architrave, arch and vault) had been employed effectively since antiquity, and remain relevant even today. The craftsmen of the 18th and 19th century were designers and builders, essentially being the architects of the Kosovo dwelling. For generations they organised themselves into guild-type groups, passing on and inheriting the profession of masonry, or carpentry and joinery, and in Kosovo mostly originated from Dibra.

The role of the craftsman or master-craftsman (the latter also engaged

detyrueshme të veshura me karakter fetar, për të qenë të zbatueshme pa mëdyshje, kjo zgjidhje shfaqet si një tregues i nivelit vërtet të lartë të higjienës.

Momenti etno- psikologjik është pjesë e kushteve shqiptare, që përcaktojnë karakterin e banesës shqiptare dhe rrjedhimisht dhe asaj qytetare kosovare të shekujve XVIII-XIX. Shqiptari është i lidhur me truallin e tij, burim i gjithçkaje jetësore, dhe për këtë atë e ka mbrojtur me jetë gjatë shekujve. Edhe kulti i banesës, do të thoshim pa mëdyshje, i lidhur me atë të truallit, është faktor i pranishëm në konceptin e saj. Përgjithësisht, shqiptari e ka ngritur banesën përtej mundësive të tij ekonomike. Ajo ka qenë shprehja e prekshme e vitalitetit të tij, cilësi inhereente, përherë vepruese. Banesa me përmasat, formulimin dhe tregues të tjerë, shprehte prektas përkatësinë e familjes, e cila banonte në të. Cilësimet: "shpi e madhe", "shpi e fortë", "derë e fortë", "shpi e zonja", "shpi në zâ", "shpi bujare" janë domethënëse.

Ndërsa, kushtet ekonomiko-shoqërore janë përcaktuese në tipin e banesës, pra në kompozimin vëllimor të saj, numrin dhe trajtimin e ndërtimeve ndihmuese dhe mjedisëve, faktorët e tjerë kanë përgjithësisht ndikime të pjesshme në kategorinë banesë. Materialet dhe teknika e ndërtimit, të cilat lidhen drejtpërdrejt me realizimin e veprës, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe në pamjen e veprës, madje në disa raste ndikojnë edhe në formulimin e elementeve të ndryshëm funksional.

in administrative and economic activities within the town) was in fact often restricted when it came to the spatial and technical architectural solutions demanded of a building project. Architectural features could be requested and incorporated by the client, rather than arising from the demands of common practice, purpose or tradition, and as an employee the craftsman had to match them.

Climate is another factor that has determined the traditional Kosovar dwelling. The country experiences severely cold winters, which has resulted in the tradition of low ceilings that keep heat close to the inhabitants' bodies. This in turn has allowed the building of mafl above the in-built cupboards, as observed in dwellings in Albanian cities of the same period. The cold has also given rise to closed eaves, and the covered galleries and shutters which enclose the staircase leading from the porch into the house.

The scale, character and setting of the dwelling have developed in harmony with the factors that stimulated and supported its inception. The socio-economic element predominantly determines the basic dwelling features while other factors, although secondary, become generative under certain circumstances. Research which takes into consideration the interaction of these factors provides explanations for the variations in housetype. However, these factors are also subject to change over time, especially the socio-economic context. Thus, Kosovar vernacular

Për shkak të shkallës së zhvillimit të shoqërisë së kohës, materialet natyrore të papërpunuara, guri, druri, dhe dhe rëra, kanë pasur përdorim të gjerë. Krahas tyre, qëndrojnë materialet me përpunim tradicional si gëlqerja, qerpiçi dhe tjegullat. Kështu, të gjitha materialet ndërtimore ishin pranë objektit për t'u ndërtuar. Lloji i materialit nuk ndikonte në kompozimin e banesës. Teknikat e ndërtimit, sidomos ato të muraturës vinin prej thellësive të shekujve, krahas teknikave krahasimisht të reja, si ajo me skelet druri, mbushur me qerpiç, apo veshur me listela. Kjo teknikë pati përparësinë e ndërtimit të strukturave të lehta dhe mundësisë së ndërtimit të hapësirave të mëdha të dritareve, madje të ndërtuara edhe në varg. Materialet dhe teknikat e ndërtimit janë faktorët më konservatorë në bashkësinë, kompozim, material, teknikë ndërtimi dhe formulim arkitektonik-dekorativ.

Mbi bazën e të dy faktorëve bashkëplotësues material dhe teknikë ndërtimi, mjeshtri popullor realizon banesën. Kjo kategori ndërtimesh u realizua me përvojë shumëshekullore, por me hapësira të kufizuara mundësisht për risi, sepse ato themeloret si mënyrat e ndërtimit të muraturës, me përf forcime brezash druri, arkitrau, harku dhe qemeri, daljet në formë erkeri, sistemi i shkallëve, dyerve dhe dritareve etj., ishin zgjidhur si koncept dhe konstruktivisht që në antikitet. Edhe në hapësirën e Kosovës, gjatë shekujve XVIII-XIX, mjeshtrit popullorë ishin njëherazi projektues, konstruktorë dhe zbatues të veprës arkitekturore, pra të banesës në

dwelling of the 17th and 18th centuries, built at a time of stable, feudal society throughout the Balkans, evolved and altered slowly until the mid-19th century whereupon the development of capitalism provided a new impetus for changes in the house model and expression. The paradigmatic housetype, therefore, also demonstrates a multitude of differences that do not allow easy classification. The volumetric composition remains an essential value in the differentiation and hence the classification of Kosovar and Albanian dwellings from the 18th and 19th centuries, and can be grouped into four house typologies. Other secondary features (such as the number of storeys and construction techniques) will be mentioned where relevant and where their impact on the overall characteristics of the dwelling is of interest.

rastin tonë. Ata ishin të organizuar në grupe, duke trashëguar brez pas brezi profesionin e muratorit, i cili kryente ngritjen e muraturës, hedhjen e trarëve të dyshemesë dhe ngritjen e strukturës së çatisë, ndërsa mjeshtrit e drurit merreshin me shtrimin e dyshemesë, ndërtime dhe tavaneve, eventualisht shkallëve të drurit, dyerve, dritareve dhe mbarë musandrave, dollapëve të murit, sergjeneve, etj. Në hapësirën e Kosovës, përgjithësisht, kanë punuar mjeshtrit dibranë.

Kur flasim për rolin e mjeshtërve si projektues, apo më saktë të kryemjeshtrit, i cili kryesonte grupin dhe kryente marrëdhëniet me porositësin, duhet të kemi parasysh se hapësirat e kryemjeshtrit për zgjidhjet kompozicionale dhe ato tekniko-arkitekturore ishin të kufizuara. Së pari, ky kufizim rridhte prej së vërtetës se tipologjia dhe trajtimi i elementëve arkitekturorë ishin tepër të tipizuar, ndërsa teknika e ndërtimit e zgjidhur prej shekujsh. Së dyti, porositësi, pra pronari i ardhshëm i banesës, natyrisht i parashtronte kërkesat kryemjeshtrit, i cili i përputhte ato me hapësirat profesionale të zbatimit.

Klima, është një faktor që ka një farë ndikimi në banesën tradicionale. Në rastin e Kosovës, e cila ka klimë të ashpër gjatë stinëve të ftohta, mendojmë se ky faktor ka ndikuar në lartësinë, krahasimisht të vogël të katit, i cili ka mundësuar ndërtimin e mafilit mbi kompleksin e musandrave, siç i ndeshim rëndom në banesat e shekujve XVIII-XIX, në qytetet e Shqipërisë.



SHTËPIA MUSTAFA – POMAKU
MUSTAFA – POMAKU HOUSE



PAMJE NGA ENTERIERI I SHTËPISË MUSTAFA- POMAKU
VIEW OF INTERIOR IN MUSTAFA - POMAKU HOUSE

Gjithashtu, edhe përdorimi i gjerë i sistemit të ngrohjes të ngritur së bashku me ndërtimin e banesës, lidhet me klimën e ashpër të Kosovës. Strehët e mbyllura, gjithashtu shpjegohen me të njëjtën arsye, ashtu si dhe çardakët dhe qoshqet e mbyllura, si dhe qepenin, i cili mbyll rampën e shkallëve që prej hajatit të çon në çardak.

Faktorët e natyrave të ndryshme, të cilët ndikojnë në shkallë dhe rrethana të ndryshme në karakterin dhe tiparet e banesës, nuk veprojnë ndaras, por në bashkësi. Faktori i kushteve ekonomiko-shoqërore është faktori kryesor, që përcakton tiparet thelbësore të banesës, ndërsa faktorët e tjerë, megjithëse dytësorë, në rrethana të caktuara marrin vlera të rëndësishme. Hetimi i tyre dhe konsiderimi në bashkëveprim e bën me të drejtë shpjegimin e arsyeve që çojnë në zgjidhje të ndryshme. Sa i përket qëndrueshmërisë në kohë të këtyre faktorëve, ai është i ndryshëm. Më të ndryshueshëm në kohë paraqiten faktorët ekonomiko-shoqërorë. Ata brenda një formacioni shoqëror ndryshojnë me shkallë të ndryshme shpejtësie. Kështu, në rastin në shqyrtim, lidhur me banesën qytetare kosovare të shekujve XVIII-XIX, të ndërtuar kryesisht në periudhën e feudalizmit të vonë në hapësirat shqiptare dhe mbarë ballkanike, deri rreth mesit të shekullit XIX, ndeshemi me një qëndrueshmëri relative të kushteve ekonomiko-shoqërore. Kjo pasqyrohet me tipologji të kristalizuar me ecuri, krahasimisht të ngadalshme. Ndërsa, fillimi i zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste rreth mesit të shekullit XIX krijoi rrethana të



SHTËPI ME HAJAT - E GANI DUKAGJINIT
HOUSE WITH PORCH – GANI DUKAGJINI'S



SISTEMI KONSTRUKTIV – ERKERET DHE HATULLAT
CONSTRUCTION SYSTEM – ERKERE AND HATULLA

tjera, të cilat gradualisht filluan të ndikojnë në karakterin e banesës që prej rikonstruksioneve të pjeshme të saj deri te lindja e tipave të rinj, apo trajtimeve të reja.

Tipi si kategori e abstraktuar shfaqet në një mori zgjidhjesh, të cilat gjithnjë duke përmbushur karakteristikat thelbësore të kësaj njësie tipologjike, bartin veçanti, të cilat nuk mund të grupohen qartazi ose disi qartë në variante të ndryshme. Këto zgjidhje sa më të shumta të jenë, aq më bindshëm tregojnë se tipi është i përvetësuar, apo me saktë i njohur gjerë në hapësirën në të cilën ai ndërtohet.

Klasifikimi, në rastin e dhënë, si shpërndarja e banesave në kategori të ndryshme mbi bazën e një kriteri, vjen si përpjekje për të paraqitur llojshmërinë e dukurisë në zhvillimin e saj në hapësirë dhe kohë. Kriteri mbi bazën e të cilit do të kryhet klasifikimi i banesës qytetare kosovare të shekujve XVIII-XIX, ashtu si dhe për banesën shqiptare, është ai i kompozimit vëllimor, si cilësorit më thelbësor. Tiparet e tjera dytësore, si numri i kateve, eventualisht teknikat e ndërtimit etj., do të përmenden sipas rëndësisë dhe ndikimit të këtyre zgjidhjeve në karakteristikat e banesës dhe veçanërisht në kompozimin e saj.


Duke u mbështetur në kompozimin vëllimor të banesave qytetare kosovare të shekujve XVIII-XIX, ato mund të grupohen në katër tipa, duke iu



SHTËPIA E VAHIT KABASHIT
VAHIT KABASHI'S HOUSE

bashkëpërfshirë këtyre tipave edhe grupin i zgjidhjeve të veçanta kompozicionale. Gjithnjë duke iu përmbajtur karakteristikave thelbësore kompozicionale si përcaktuese të tipologjisë, emërtimet e tipave të veçantë, përgjithësisht do të lidhen me elemente të spikatura kompozicionale.

Klasifikimi tipologjik i banesës qytetare Kosovare të shekujve XVIII-XIX



KLASIFIKIMI TIPOLOGJIK I BANESË TRADICIONALE QYTETARE
 TYPOLOGY CLASSIFICATION OF URBAN TRADITIONAL DWELLINGS



KALLDËRMI
 COBBLE STONE

Sikur se përmendëm, banesa qytetare kosovare, mbështetur në tiparet e kompozimit vëllimor, sipas nesh, ndahet në katër tipa: banesa me hajat, banesa me çardak, banesa me qoshk dhe kulla qytetare. Këtyre tipave iu shtohet edhe grupi i banesave, të cilat përbëjnë zgjidhje të veçanta. Të tre tipat e para shfaqen me disa variante, brenda të cilave ndeshim nënvariate. Lidhur me numrin e kateve, banesa me hajat është gjithmonë përdhese, duke pasur në disa shembuj një mjedis ndihmës, të ndërtuar në pjesën më të madhe të volumit nën tokë. Banesa me çardak është gjithmonë dykatëshe, ndërsa rrallë nën katin përdhese ndërtohet një mjedis ndihmës. Banesa me qoshk, ndërtohet si përdhese ashtu edhe në kat, duke pasur në disa shembuj mjedisin ndihmës nën katin përdhese. Kulla qytetare ndërtohet në tri kate

Prof. Dr. Emin Riza

Anëtarë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

In summary, the four types of Kosovar urban dwelling are based on the volume of compositional features: dwellings with a porch, dwellings with an open gallery, dwellings with slightly cantilevered upper storey and the urban kulla. The first three housetypes appear as different typologies and sub-typologies. The dwellings with a porch have only a ground floor, with some examples of auxiliary spaces, but retaining a volume underground. The galleried dwelling is always composed of two floors, with rarely any auxiliary spaces built underground. The dwelling with a covered gallery is built as a ground floor or two storey houses, with some auxiliary spaces built underground. The “kulla” is built as three storey structure.

Prof. Dr. Emin Riza

Member of the Academy of Sciences of Albania

Dokumentimi i Monumenteve³

The Documenting of Monuments³

Vërja në mbrojtje shtetërore e një ndërtimi me cilësinë “monument kulture”, lidhet me një dokumentacion të gjerë të gjendjes së monumentit, i cili është i llojeve dhe thellësive të ndryshme, në varësi nga rëndësia, gjendja dhe të dhënat mbi të. Studimi për restaurimin e një monumenti kërkon patjetër pasjen në dorë të këtij dokumentacioni shkencor bazë, i cili eventualisht zgjerohet dhe plotësohet.

Dokumentacioni shkencor i monumentit është pasqyrimi i gjendjes së monumentit dhe të dhënave mbi të, në mënyra të ndryshme për të pasur njohuri sa më të plotë mbi aspektet arkitektonike, teknike dhe historikun e tij. Dokumentacioni shkencor i monumentit është një punë e kualifikuar, e cila nënkupton njohjen e mirë të monumentit që dokumentohet, madje dhe të klasës së cilës ai i përket. Dokumentacioni i monumentit, si pasqyrim i gjendjes së tij dhe jo vetëm kaq, por edhe si pasqyrim i shtrësive të mëvonshme, të cilat bëhen të qarta nëpërmjet trajtimeve të ndryshme, sajimeve të sforcuara, që cenojnë zgjidhjet tipike etj. bën të domosdoshëm që hartimi i tij të udhëhiqet drejtpërdrejt nga kuadri i lartë. Kjo siguron pasqyrimin e drejtë dhe në masën e duhur të gjendjes dhe të dhënave që hedhin dritë mbi zhvillimin në kohë të monumentit. Kuadri i lartë, që udhëheq dokumentacionin shkencor, jo vetëm që përkujdeset për saktësinë e punës së kryer, por ajo që është më kryesorja, përcakton shkallën e thellësisë në kryerjen e tij. Dokumentacioni i monumentit

Putting a building under national protection as a “cultural monument” depends on the extent and thoroughness of its documentation, and is affected by its importance as a building, its condition and the data available on it as well as a complete understanding of its technical architectural aspects and its history. Studies on the restoration of monuments obviously require basic scientific documentation, which eventually can be expanded and supplemented. It is a skilled job which necessitates professional direction, since it relies on good analysis and categorisation of a building’s historical layers, which become evident through treatments and engineering solutions that deviate from the norm. This represents an accurate record of the condition of the building and its history. These professionals leading a monument’s scientific documentation not only ensure the accuracy of the work undertaken, but importantly determine the depth of study. Documentation of the monument is not a finite event, but has to be expanded and supplemented constantly, reflecting new situations and changing circumstances.

Three types of scientific documentation are required to describe the condition of a monument: graphic, photographic and descriptive. One of the most valuable components of a monument’s documentation is through graphical drawings. It establishes the compositional structure, external articulation and various architectural and constructive elements,

³Kjo ligjeratë është pregaditur nga Prof. Emin Riza dhe është prezentuar gjatë Kursit veror të UNVP “Arkitektura Tradicionale dhe Metodatat e Dokumentimit”

³This lecture was written by prof. Emin Riza, and was presented to students during PISU course “Traditional Architecture and Documentation Methodologies”

nuk kryhet një herë e përgjithmonë, por ai vazhdimisht pasurohet dhe thellohet. Pasurohet duke pasqyruar gjendjet e reja të monumentit dhe thellohet, duke pasqyruar më në thellësi atë.

Dokumentacioni shkencor i gjendjes së monumentit, është tre llojesh: grafik, fotografik dhe përshkrimor.

Dokumentacioni grafik i gjendjes së monumentit, është një nga përbërësit më me vlerë të dokumentacionit. Ai fikson në mënyrë grafike strukturën kompozicionale, pamjet si dhe elementë të ndryshëm arkitektonik dhe konstruktiv. Dokumentacioni grafik apo rilevimi i monumentit përmbledh gen-planin, planimetrinë e çdo kati, prerje gjatësore e tërthore, pamje, hapje, hollësi arkitektonike e konstruktive etj. Sipas kategorisë së monumentit, si edhe shkallës së vlerave të tij, varet edhe pasqyrimi i tij në të gjithë përbërësit e rilevimit grafik, apo një pjese të tyre, si dhe shkalla e thellimit të këtyre përbërësve.

Në rilevimin e monumentit të arkitekturës një rëndësi të dorës së parë luan matja si dhe shkalla, në të cilën do të kryhet rilevimi, prandaj paraprakisht po ndalemi në këto elemente.

and includes: site plans, floor plans, longitudinal and transversal sections, elevations (facades), openings, and architectural and constructive details. The categorisation and value of a monument define the detail with which it is graphically recorded. Survey measurements and the drawing scales at which the graphic documentation of architectural components is presented play a very important role in the final dossier, and are covered in detail below.

Metoda dhe teknika e matjeve

Matja është një nga veprimet më me përgjegjësi gjatë rilevimit të monumentit, e cila duhet kryer me kujdesin dhe seriozitetin e duhur, sepse përndryshe shkakton vështirësi të mëdha dhe përsëritje të punës së kryer. Në përputhje me saktësinë e kërkuar, karakteristikat e monumentit dhe numrin e rilevuesve përdoren metoda të ndryshme matjesh. Mënyra më e përhapur është ajo e matjeve të pjesshme, e cila konsiston në matjen e çdo përmase, që përcakton dy kufijtë fundor të një gjatësie, e cila lidhet me ambiente apo elemente të veçantë të një monumenti. Është e domosdoshme që përmasat e pjesshme të një gjatësie, që përmban disa elemente, të mbulohen nga një përmasë e përgjithshme. Kjo mënyrë ka lehtësi në hedhjen në shkallë, por matjet e shumta shtojnë mundësinë e rritjes së gabimit.

Një metodë tjetër është ajo e matjeve të njëpasnjëshme. Sipas kësaj mënyre, për të matur një gjatësi me shumë elemente vendoset metri në pikën fillestare dhe pa u lëvizur lexohen përmasat e njëpasnjëshme në çdo pikë që shënon fillësën, apo mbaresën e një elementi. Kjo mënyrë është më e saktë por kërkon veprime zbritjeje gjatë hedhjes në shkallë të skicës.

Në mjaftë raste, planimetria e banesës, gen-plani apo përbërës tjerë të dokumentacionit kanë forma tepër të parregullta gjeometrike, kështu që matja me metodat e mësipërme, nuk siguron saktësi. Prandaj, në këto

Methods and measurement techniques

Survey measurement is crucial responsibility in the graphic documentation of the monument and should be conducted with great care and precision, as otherwise it might lead to later problems and require repetition. Different measurement methods can be employed, depending on the required accuracy, the characteristics of the monument and the number of surveyors. The most common is partial measurement, which consists of the measurement of any dimension determining the two limits of a finite length, and which relates to the environment or particular elements of a monument. It is essential that partial dimensions consisting of a number of consecutive elements over a finite length are checked against and add up to an overall dimension. Although easy in practice, multiple measurements increase the probability of error.

Another method is using successive measurements. Placing a measuring line along the length of an element with many features, measurements are taken and the beginning and end of each feature along that primary line without moving it. This approach is more accurate but requires deduction while sketching to scale.

In most cases, floor plans and site plans are highly irregular geometric shapes, so the above measurement methods do not ensure accuracy. It is therefore recommended to use the triangulation measurement method

raste përdoret metoda e matjes me trekëndësha. Sipas kësaj mënyre nisemi nga një bazë e zgjedhur dhe prej saj, me atë të dy matjeve nga të dyja skajet e bazës, për një pikë të vetme karakteristike të sipërfaqes për t'u matur, përcaktojmë pozicionin e kësaj të fundit. Kështu, radhazi përcaktojmë pozicionin e çdo pike karakteristike të sipërfaqes për t'u rilevuar.

Një metodë tjetër është ajo ortogonale. Sipas saj, nga një bazë e njohur, në distancë të barabarta bëhen matje vertikale normal në të, duke përcaktuar kështu pozicionin e zhvillimit të një konture të caktuar. Një metodë tjetër, e cila në parim është e njëjtë me atë të trekëndëshave, është metoda bipolare. Sipas kësaj metode, nga të dy skajet e një baze të njohur bëhen matje të dyfishta për çdo pikë interesi për rilevimet.

Të gjitha këto metoda përdoren barazisht si për matjet e planimetrive, ashtu edhe për matjet e pamjeve të ndryshme të monumentit.

Numri i rilevuesve duhet të jetë të paktën dy. Ata duhet të jenë të pajisur me metër shirit 10, 20 apo 50m si dhe me metër të zakonshëm druri apo metalike. Duhet pasur kujdes në vendosjen e zeros në vendin e duhur si dhe tërheqjen normale dhe të barabartë të metrit për çdo matje.

Përmasat shënohen në centimetra.

in these cases. Diagonal measurements are taken across the whole plan, and cross-referenced. Features within the plan can also be measured in this way, often using double measurements along the same line to ensure accuracy (the 'bipolar method'). Thus, we successively determine the position of each characteristic point of the surface

Another method is through orthogonal measurement. Starting from one side of a plan (a base line), perpendicular measurements are taken at equal distances along this base line, to determine the location of features within the space.

All these methods are used for surveying floor plans and elevations. There should be at least two surveyors, and they should be equipped with a measuring tape of 10, 20 or 50 meters in length, as well as ordinary wooden or metal meter rulers. Care should be taken in setting the base point ('zero') in the right place as well as during the movement of the meter ruler for each measurement.

Dimensions should be recorded in centimetres.

An important issue a survey leader should consider is in defining the priority and scale that the survey is to be conducted at, which is conditioned by the importance and the density of architectural elements.

Një çështje me rëndësi ku duhet të ndalet me kujdes udhëheqësi i rilevimit është ajo e përcaktimit të shkallës së rilevimit. Kjo kushtëzohet nga thellësia e rilevimit dhe dendësia e elementeve arkitektural. Zakonisht, shkallët më të përdorshme janë 1:200 për gen-planin, 1:50 apo 1:100 për planimetritë, pamjet dhe prerjet; 1:50, 1:25 apo 1:10 për hapjet, ndër-sa 1:20, 1:10, 1:5 deri 1:1 për hollësitë arkitektonike.

Rilevimi grafik, siç përmendëm, është një nga më të rëndësishmit e dokumentacionit të gjendjes së monumentit. Ai përmbledh dy lloje dokumentesh: skicat e marra drejtpërdrejt nga monumenti dhe vizatimet e hedhura në bazë të këtyre skicave në një shkallë të caktuar.

Skicat e marra nga monumenti

Skicat përbëjnë dokumentin themelor mbi të cilin mbështeten vizatimet në shkallë që rrjedhin prej tij. Si të tilla, skicat me dorë të lirë duhen punuar me kujdes të veçantë, në letër të qëndrueshme vizatimi, me laps vizatimi "F", "H", "HB". Letra e vizatimit shfrytëzohet vetëm nga një anë, dhe në të njëjtin format nuk përfshihen dy objekte.

Përpara fillimit të punimit të skicës, në krye të fletës shënohet emri i objektit (Syrja Haznedari), adresa (Lagjja: "1 Maj", Rruga "G.Karakashi", nr.15, Berat), muaji dhe viti i kryerjes së skicës (Shtator 1973). Skica shoqërohet me emërtimin e saj (planimetri e katit të parë, prerja A-A...). Në fund të saj shënohet emri dhe mbiemri i rilevuesit.

Usually, the most useful scale for site plans is 1:200; for floor plans, elevations and cross-sections 1:50 or 1:100; for openings 1:50, 1:25 or 1:10; and 1:20, 1:10, 1:5 to 1:1 for architectural details.

Graphical documentation in this way is one of the most important documents of the condition of the monument. It consists of two types of documents: drawings taken directly at the monument site and later scaled drawings derived from these sketches.

Sketches drawn at the monument site

These represent the basic information from which later scaled drawings are derived. As such, free hand sketches have to be drawn with special care, on durable paper, with "F", "H", and "HB" type pencils. Drawing paper should be used on one side only, and should contain information about only one element under study.

Before starting the sketches, the name of the study element should be written at the top of the sheet (e.g. Syrja Haznedari), its location (e.g. neighbourhood: 1 May Street, G Karakashi, No. 15, South), and the month and year (e.g. September 1973). The sketch is labelled according to projection (e.g. First Floor Plan, Section AA). The bottom of the sheet should contain the name and surname of the surveyor.

Rilevuesi, pasi ka shënuar treguesit, që të identifikojnë monumentin vrojton me kujdes atë, për të krijuar një ide sa më të plotë mbi formën dhe madhësinë e pjesës së monumentit që do të përbëjë objektin e skicës. Pas kësaj fillon skicimi, duke u përpjekur sa më shumë që të ruhen përpjesëtimet ndërmjet pjesëve dhe elementeve në veçanti. Pas përfundimit të skicës kalohet në vendosjen e përmasave, të cilat duhet shënuar qartë, duke shoqëruar me vijën e dimensioneve. Nuk lejohet në asnjë rast, që në zyrë skica të plotësohet me përmasa të reja, të dala nga mbledhja apo zbritja e atyre të shënuara në objekt.

Gen-Plani

Me këtë dokument pajisen të gjitha monumentet e kategorisë së parë dhe të dytë. Në gen-plan shënohen: muret rrethues, portat e hyrjes, kontrafortet, kamaret në muret rrethues, frëngjitë, ambientet ndihmëse, pusët, ambientet sanitare dhe drurët. Gjithashtu, shënohen llojet e ndryshme të shtresave, muret e teracimit, shkallët, etj. Për vetë format përgjithësisht të çrregullta të oborreve, në matje duhet zbatuar gjerësisht metoda e trekëndëshave. Kujdes i duhet kushtuar hedhjes së saktë të planimetrisë së çatisë. Kur tereni është i pjerrët detyrimisht duhen shënuar disa kuota bazë me instrument apo thjeshtë me nivel uji, duke u nisur nga një pikë me kuota relative 0.00 (zakonisht pragu i portës së banesës). Gen-plani duhet lidhur detyrimisht me rrjetin rrugor. Në të shënohet drejtimi i veriut.

After marking the indicators, the surveyor has to look at the monument carefully in order to identify it and create a more complete vision about the shape and size of that portion of the monument that will form the subject of the sketch. Whilst sketching, effort must be made to keep the correct proportions between overall size and its specific elements. After completion, the surveyor should add dimensions to the sketch. Additional dimensions arising from deduction should not be included when later working off-site.

Site-Plan

This document is compulsory for all Category 1 and 2 monuments. A site-plan contains: perimeter walls, entry gates, niches on perimeter walls, frëngjitë (openings, arrow slits or 'embrasures'), auxiliary spaces, wells, sanitary features and trees. Different types of ground strata, terrace walls, stairs and other features should also be noted. Due to the generally irregular shape of yards, the triangulation method of measurement is usually employed. Attention should be paid to the precise documentation of a roof plan. In case of steep terrain, basic contours relating to an instrument or water level should be shown, starting from a base point of 0.00, from which every other measurement is related. This is commonly the gate threshold of the plot. The site plan must connect with the urban road network. The direction of North must be indicated.

Po japim tashti në mënyrë të përmbledhur se çfarë duhet mbajtur parasysh në matjet e elementeve të veçantë, përbërës të banesës.

Dyert – shënohet drejtimi i hapjes së flegës, patura, pragu dhe lloji i kasës. Dimensioni i derës është ai i hapësirës së dritës.

Dritaret – sipas llojit të dritares shënohet hapësira e dritës, patura dhe drejtimi i hapjes. Në shumë raste dritaret kanë elemente të tjera përveç telajove me xhama, si kafaze hekuri apo druri, kapakë druri me lëvizje rreth një aksi vertikal, apo me rrëshqitje në planin vertikal ose horizontal, si dhe persiane. Të gjithë këto elemente duhen shënuar për atë që lejon shkalla në të cilën pasqyrohet objekti. Në rastet kur ndeshemi me dritare dyfishe në lartësi, dritaret e sipërme jepen veçmas, ndërsa kur kemi dritare pragu i të cilave zgjerohet poshtë, duhet bërë një prerje vertikale, për të dhënë ndryshimet e seksionit të saj. Kur mbi hapësirën e derës apo dritares bie një frëngji apo ndonjë element tjetër, ai duhet shënuar me vija të ndërprera në planimetri, mbi vizatimin e elementit nën të.

Dollapët e murit – shënohet hapësira e dritës, drejtimi i hapjes së kanateve dhe thellësia e tij. Për kamaret shënohet hapësira e dritës dhe thellësia, nëse mbulesa është me qemer shënohet shenja përkatëse.

Floor Plan

This one of the main drawings involved in the graphic documentation of a monument. It marks the location of everything contained within the monument (such as walls, stairs, doors, windows, chimney, wall cupboards, 'mafilet'(loggia), covered galleries, niches, sink, 'frengjitë', 'ottoman', etc.). It is important to pay particular attention to documenting the transformed parts and material alterations and differences, noting their existence and determining their location relative to the whole.

These elements are listed in the floor plan in its current state, while the traces of damaged parts should be marked to clarify the variations. Changes in level across the floor plan should be highlighted, especially in cases where the construction is set on sloping ground. In many dwellings functional elements are located at half-height, such as 'mafilet' (loggia) or windows. In these cases, the floor-plan should indicate this or a second row of windows, above or below as appropriate.

Two or more diagonal measurements should be taken in any space (since they are frequently irregular), and are taken at 1m height from floor level.

It is important to bear the following in mind when measuring architectural elements:

Shtresat – për çdo ambient shënohen të dhëna mbi llojin e shtresave. Kur shtresa është me dysheme dërrasash, shënohet distanca e vendosjes së trarëve si dhe përmasat të gjerësisë së dërrasave dhe mënyrës së lidhjes së tyre. Kur ka mindere me dërrasa, ata gjithashtu pasqyrohen në planimetri. Nëse ambienti është përdhesë, i shtruar me pllakë guri, kalldrëm, harrasan apo ndonjë material tjetër, shënohet shenja treguese përkatëse.

Shkallët – për çdo të tillë shënohen të dhënat sipas kësaj radhe: numri i tyre, lartësia dhe përmasa e shkëljes (13 x 12 x 26). Çdo shkallë pajiset detyrimisht me drejtimin e ngritjes.

Planimetria e katit përdhe, detyrimisht plotësohet me përmasat e përgjithshme të faqeve të jashtme të monumentit, duke bërë kështu të mundshme kontrollin e saktësisë së punës së kryer. Një kujdes i veçantë i duhet kushtuar matjes së trashësisë së mureve. Këto matje duhet të jenë të shpeshta dhe nuk duhet të dalin nga zbritja e përmasave të marra për qëllime të tjera. Kur ambienti mbulohet me qemer apo pjesë të veçanta konstruktive të tij, mbulohen me hark, shënohet shenja përkatëse në skicë.

Një element mjaft i rëndësishëm konstruktiv i banesës është struktura konstruktive e çatisë. Çdo monument i kategorisë I-rë (përfshihen raset kur çatia origjinale, për arsye të ndryshme është krejtësisht e transformuar) apo dhe i kategorisë II-të, që ruan tërësisht apo pjesërisht konstruksionin origjinal të çatisë, duhet të plotësohet me dokumentacionin e

Doors – Mark the opening door swing of a door panel, threshold and door frame. The door dimension refers to the clear space between edges of the door frame.

Windows – Mark the opening swing of the window, sill and opening size. In many cases, windows have elements other than the glazing, such as iron or wooden frames, pivoting, vertical or horizontal sliding shutters and Persian blinds. All these elements must be drawn depending on the presentation scale of the final drawing.

The upper glazing of double height windows are drawn separately. When the window's threshold extends to floor level, a vertical section of window has to be drawn in order to document those changes. A dashed line drawn over the window indicates a frengji (opening), or another element, located above the plane at which the drawing is being made.

Wall Cupboard – The clear opening (between frames), the direction of door folding and their depth should be marked.

The niche
Record the clear opening and its depth. If vaulted, indicate this appropriately.

kësaj strukture, që përmbledhë planimetrinë e saj, prerjet dhe hollësitë e nevojshme. Në banesat simetrike mund të merret vetëm gjysma e strukturës së çatisë.

Hapjet – me hapje kuptohet pasqyrimi në vizatim i faqeve të brendshme të një ambienti. Hapje përgjithësisht iu bëhet të gjithë ambienteve në monumentet e kategorisë I (me përjashtim të ambienteve të transformuar rrënjësisht). Zakonisht monumenteve të kategorisë II, nuk iu dokumentohet brendësia, por kur ato ruajnë një apo disa ambiente me vlera, atëherë këto dokumentohen me anë të hapjes, njëlloj si ambientet në monumentet e kategorisë së parë. Në hapje shënohet gjithçka që ruan brendësia, në të gjitha sipërfaqet anësore të saj. Sipas vlerave bëhen dhe rilevimet e tavanëve, të cilat plotësojnë tërësisht dokumentacionin e brendësive të ambienteve. Për të bërë të mundur identifikimin e lehtë të hapjes, ajo shoqërohet me një skicë skematike që tregon katin, ambientin dhe faqen. Kati shënohet me shifër romake, ambienti më një numër arab, ndërsa faqja me shkronjat e mëdha të alfabetit (II/1/A). Shpesh hapjet shoqërohen me prerje të oxhakëve apo elementeve të tjera, forma e të cilave nuk del e qartë vetëm nga planimetria dhe hapja.

Pamjet – me këtë dokumentacion pajisen të gjitha monumentet e kategorisë I dhe II. Me pamje dokumentohen grafikisht të gjitha faqet e jashtme të banesës dhe ambienteve ndihmëse. Një rëndësi të

Levels – A record should be made of the changes in ground conditions, landscaping and flooring across the site.

Floor boards: Note the distance between beams, widths of the boards and the method of their connection.

Ottomans (traditional sofa) should be located in the plan.

Ground floor: Draw flooring materials (flagstones, cobblestones etc.) differently.

Stairs – For each staircase, annotate as follows: number of the stairs, depth/height of stair riser and stair tread (e.g. 13 x 12 x 26). Mark the direction of the stair's rise with an arrow.

The ground floor plan should be annotated with the overall dimensions of the monument's external walls, against which smaller measurements of details can be checked. Special attention should be paid to the measurement of wall thickness. These measurements should be taken at regular intervals and should not be obtained by deduction using dimensions taken for other purposes. When the space is vaulted or contains arches, they should be marked appropriately.

The roof structure is a crucial element of the dwelling's fabric. Every monument in Category 1 (except for cases where the roof has been entirely transformed) or Category 2, which preserves the original roof structure

posaçme i duhet kushtuar në këto skica vizatimit të elementeve të ndryshëm arkitektonik, si: dyerve, dritareve, kornizave, strehëve, çardakut, shkallëve, frëngjive, sqollave, oxhakëve, etj. Gjithashtu rëndësi i duhet kushtuar paraqitjes së teknikës së muraturës, e cila kur është me breza druri duhet pasqyruar imtësisht.

Shpesh banesat janë ngritur mbi terrene të pjerrëta, kështu që lartësia e faqeve dhe pjesëve të ndryshme nga tereni paraqet vështirësi në matje. Për këtë arsye, në këto raste duhet të nisemi nga një nivel horizontal dhe prej atij me sistem orthogonal, apo në atë të trekëndëshave mund të përcaktojmë pozicionin e pikave karakteristike konturuese të elementeve të ndryshme arkitektonik të pamjeve. Për faqe të ndryshme mund të zgjidhen nivele të ndryshme riferimesh, por gjithmonë këto nivele duhen lidhur me njëri tjetrin, duke matur disnivelin ndërmjet tyre.

Kujdesimadhduhetkushtuarkonfiguracionittëçatisë,llojittëstrehëvesidhe formës dhe lartësisë së tymarëve. Terreni përreth pamjeve duhet pasqyruar deri në një far largësie, sipas lidhjes me banesën dhe karakterit të tij.

Prerjet – përbëjnë një nga pjesët më të rëndësishme të dokumentacionit grafik, të cilat tregojnë shumë për kompozimin volumor të banesës dhe strukturës së saj në lartësi. Me këtë dokumentacion grafik pajisen të dy kategoritë e monumenteve. Numri i prerjeve si dhe plani, sipas të cilit zhvillohen ato përcaktohet konkretisht nga udhëheqësi i rievimit, duke pasur parasysh si parim drejtues paraqitjen e pjesëve më me interes, të

partially or completely, should be included in the documentation summarizing floor plans, sections and necessary details. Only half the roof structure need be shown in symmetrical dwellings.

Openings – The documentation of openings should include the interior wall build up. Generally, openings are documented for all monuments in Category 1 (except for buildings which have been radically transformed). Openings in Category 2 monuments are not usually documented, except where they retain one or several noteworthy features. Everything around the openings, and adjoining internal and external surfaces, is documented. To enable easy identification of the opening, the drawing is accompanied with a schematic sketch identifying the floor location, facility and page. The floor is identified by Roman numerals, the facility with Arab numerals while the page with uppercase alphabetical letters (e.g. II/1/A). Chimneys and other recessed elements are also included treated as openings on the floor plan

Ceilings – This is done according to the structure, architectural features and ornamentation.

Elevations – Elevations are drawn for all Category 1 and 2 monuments. These include the graphical documentation of all the facades and ancillary facilities. A special importance should be paid to the drawings of various architectural elements such as doors, windows, frames, roof, galleries, stairs, openings, gutters, chimneys, etc. It is also important to

cilët nuk dalin qartë në llojet tjera të paraqitjeve grafike. Shpesh përdoret prerja në plane të zhvendosura, për të ndjekur pjesët më interesante të banesës. Në disa raste prerja mund të vazhdojë dhe në oborin e banesës, e madje të lidhet me rrugën, sidomos kur tereni është me konfiguracion të aksidentuar.

Hollësitë – me hollësi plotësohet veçanërisht dokumentacioni grafik i monumenteve të kategorisë I, por në mjaft raste me hollësi plotësohen edhe monumentet e kategorisë II. Elementi që do të paraqitet si hollësi, si dhe shkalla e paraqitjes, përcaktohen nga udhëheqësi i riveimit. Në hollësi mund të vizatohen element të ndryshëm arkitektonik, si: dyer, dritare, shkallë, oxhakë, musandra, dollapë druri, qoshqe, pjesë tavanesh, strehë, konstruksione muresh, çatish, etj. Çdo hollësi pajiset me treguesit përkatës të cilët e lidhin atë me vendin ku ajo ndodhet në monument.

Hedhja e skicave sipas shkallës në vizatim

Ky veprim kërkon njohjen e mirë të skicës dhe një kujdes të madh për të ruajtur shkallën e nevojshme të saktësisë. Për të mënjanuar gabimet e mundshme dhe për të shpejtuar ritmin e punës, rekomandohet që hedhjen e vizatimeve në shkallë ta bëjnë ata punonjës që e kanë kryer riveimin e monumentit. Vizatimi punohet sipas rastit, me lapsa vizatimi, me fortësi mesatare, apo me tush. Përmasat shënohen jashtë sipas rregullave të njohura, por kur ato nuk përmbliken dot, shënohen edhe brenda planimetrisë. Kujdes duhet treguar në kompozimin e fletës

document the masonry construction technique, especially in the case of timber framing; in this case all details, joints and ornaments should be noted. Dwellings are often built on sloping ground, presenting difficulties in measuring the elevations and other parts of the monument. It is therefore necessary to start from a horizontal level and survey using the orthogonal system or by the triangulation method, in order to determine the position of characteristic architectural elements on the elevations. Different elevations can use different reference levels, although they must always be connected with each other by measuring the difference. Great attention should be paid to the roof configuration, type of eaves and the height of the chimneys. The terrain around the monument should be presented in relation to the dwelling and its characteristic points on the site.

Sections – Sections are one of the most important orthographic projections in monument Category 1 and 2 documentation. They reveal much about the volume composition of the dwelling, the relationship of its parts, its structure and height - often what does not emerge from other technical drawings. The documentation coordinator determines number of sections taken through each plan, and should focus on the most interesting and important features of the dwelling for which a segmented section (dogleg section) can be used. In some cases it may be necessary to continue the section to include the external areas of the site (courtyard, road), especially on steep ground.

për shfrytëzimin racional të saj dhe mirëparaqitjen.

Nëse gjatë hedhjes së skicave në vizatim, me shkallën e caktuar hasen vështirësi që rrjedhin nga mosmarrja e përmasave të nevojshme, apo ku vërehet se janë marrë masa të gabuara, duhet ndërprerë hedhja e vizatimit dhe duhen marrë në monument të dhëna plotësuese.

Për të vetëkontrolluar saktësinë e punës së kryer duhet të vrojtohet. Nëse konturat e jashtme të planimetrive të të gjitha kateve përputhen me njëri tjetrin, muret mbajtëse a bien mbi njëri- tjetrin, prerjet dhe pamjet a përputhen me planimetritë respektive, etj. Pas përfundimit të hedhjes në vizatim me shkallë të skicës, udhëheqësi i rilevimit kontrollon punën dhe vërteton kryerjen e saktë të saj. Pas kësaj, skicat dhe vizatimet dorëzohen në arkivin e dokumentacionit, për t'u ruajtur dhe përdorur sipas nevojës.

Prof. Dr. Emin Riza

Anëtarë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Prof. Dr. Emin Riza

Member of the Academy of Sciences of Albania

Details – Category 1 monument documentation always includes constructional details, and in many cases for Category 2 monuments as well. The documentation coordinator determines what is to be drawn in detail and to what scale. Detailed drawings include: doors, windows, stairs, chimneys, wooden cupboards, closed galleries, parts of the ceilings, eaves, wall and roof constructions. Every part of the detail is annotated, also indicating the location of the element in the wider context of the building.

Scale Drawing – (Drawing sketches at a particular scale)

This requires an aptitude for drawing and paying close attention to ensure accuracy. To avoid error while increasing the efficiency of the documentation process, it is recommended that scale drawings are completed by the survey leader. Hard pencils or pen and ink are used. Dimensions are marked outside the drawing frame using appropriate conventions, but can be placed within it when more detail is to be included. Attention should be paid to the good presentation and compositional arrangement of the sheet. If dimensions are wrong or omitted, the scale drawing should be halted until further information and measurements are made. To ensure accuracy, care must be taken that the external edges of the floor plans align, and that sections and elevations correspond to their respective floor plans. A final check and overall approval is obtained from the survey leader. The sketches are then submitted to the archive of documents to be stored and accessed as needed.

Ligjëratat

Lecture series

Nga / By: Teuta Jashari

Metodologjia e Dokumentimit dhe Eksperiencat Kosovare

Documentation Methodologies and Experiences from Kosovo

Ka disa mënyra për të treguar eksperiencën kosovare duke shfrytëzuar metodologji të ndryshme, të cilat do të përmenden në vazhdim. Sidoqoftë, nga këndvështrimi im, mënyra më e mirë do të ishte përmes punës së studentëve në këtë temë, e cila paraqet saktësisht atë që pritet si rezultat/përfundim i punës dyjavore të angazhimit të studentëve gjatë Universitetit Veror.

Para se të vazhdoj më tej me dhënien e shembujve, do të ishte me rëndësi së pari të definojmë Metodologjitë e Dokumentimit që studentët i kanë përdorë gjatë punës së tyre. Këto metodologji janë:

1. Skicat me dimensione / rilevimi metrik,
2. Rilevimi fotografik,
3. Mbledhja e të dhënave përmes bashkëbisedimit me shfrytëzuesit apo burime të tjera të mundshme të shkruara,
4. Dokumentimi i vizatimeve nga matjet në përpjesë, të vizatuara me dorë (zgjedhje e studentëve).

There are a number of locations in Kosovo that have employed these documentation methodologies for monuments. However, the two week 2010 Prishtina Summer University course in these techniques have provided the best examples for the results and outcomes expected in this field of work.

These students used the following methodologies:

1. Sketches with measurements/metric surveying techniques,
2. Photographic surveys,
3. Obtaining and accumulation of information through conversations with users and written sources,
4. Final production of scaled, measured drawings/hand drawings (students' choice).

Skicat me dimensione/ rilevimi metrik:

Matjet zakonisht shoqërohen me skica të pjesëve më kryesore të ndërtesës/strukturës, të cilat merren si shembuj për dokumentim. Përveç planimetrive, prerjeve dhe dukjeve, kuptohet që duhet të merren parasysh detaje të ndryshme interesante të dritareve, dyerve, pajisjeve të brendshme, etj.

Rilevimi Fotografik:

Përveç faktit që shërben si dokumentim, rilevimi fotografik shoqëron skicat e prerjeve, detajeve të rëndësishme, etj.

Mbledhja e të dhënave përmes bisedave me shfrytëzuesit apo burime tjera të shkruara të mundshme:


Kjo informatë është shumë e rëndësishme për faktin që ndihmon në identifikimin e ndryshimeve të mundshme nëpër të cilat ka kaluar ndërtesa/struktura që prej ndërtimit dhe shfrytëzimit të saj. Ajo, po ashtu jep më shumë detaje rreth materialeve ndërtimore të shfrytëzuara (që në disa raste është e pamundur të identifikohen).



PRESENTIMI I MULLIRIT NË VRANOC
PRESENTATION OF MILL IN VRANOC



PRESENTIMI I SITUACIONIT
SITE PLAN PRESENTATION



PREZENTIMI I PLANIT
PLAN PRESENTATION

Sketches with measurements/metric surveys:

Measurements are usually associated with sketches of the most important parts of a building/structure which is being documented. In addition to the general arrangements of plan, sections and elevations, various interesting details of windows, doors, internal fittings, etc. are taken into consideration.

Photographic survey:

Providing additional information to supplement the survey drawings.

Collection of information through conversations with users or other possible written sources:

Information obtained in this way is very important because it identifies possible changes that the building/structure has undergone since it was first constructed. It also provides more detail on the construction materials used (where, in some cases, it is impossible to identify).

Dokumentimi i vizatimeve nga matjet në shkallë, të mbështetura nga CAD programet apo të vizatuara me dorë:

Ky fakt flet vetë. Pasi të bëhen të gjitha matjet merren fotografitë dhe detajet, me ç'rast realizohen vizatimet në shkallë të caktuar në funksion të përmbylljes së procesit të dokumentimit.


Është me rëndësi të thuhet që procesi i cekur më lartë, kërkohet dhe në disa raste është i domosdoshëm, me qëllim të realizimit të të dhënave permanente apo hulumtimeve akademike. Në rastin që po përcjellim, kombinimi i të dy qëllimeve mund të konsiderohet i vlefshëm.

Strukturat e zgjedhura / puna e studentëve:

Matjet dhe regjistrimet janë kryer nga studentët e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës. Si shembuj janë marrë tri ndërtesa nga pjesë të ndryshme të Kosovës, si në vijim:

- Objekti i Banimit në Vushtri
- Objekti i Mullirit në Vranoc
- Objekti i Banimit në Pejë/ Adem Muhaxheri.


Në të gjitha këto raste janë përdorur metodat e përmendura më lartë, përderisa pamja e plotë do të mundësohet pasi të kombinohen shpjegimet teorike të mësipërme dhe prezantimi i tyre.



PREZENTIMI I PRERJES
SECTION PRESENTATION



PREZENTIMI I FASADËS
FAÇADE PRESENTATION



PREZENTIMI I DETAJIT
DETAIL PRESENTATION

Production of scaled/measured drawings, in CAD or by hand:

After all measurements, photographs and details have been taken, final scaled drawings have to be produced to complete the process of documentation.

It is important to note that this process is required, or in some cases compulsory, for the creation of permanent archival records and academic research

Chosen structures/ student works:

Measurements and records were completed by students of the Faculty of Civil Engineering and Architecture at the University of Prishtina. Three buildings from different parts of Kosovo were used as case studies:

- A residential building in Vushtrri
- A watermill in Vranoc
- A residential building in Peja: Adem Muhaxheri



PREZENTIMI PËRMES FOTOGRAFISË
PHOTO PRESENTATION

In all cases, the methodologies above were employed and, by combining these with the historical and theoretical analyses, a fuller picture of each building can be obtained.

Studentët pjesëmarrës në Universitetin Veror Ndërkombëtar të Prishtinës 2010

Vlerësimi

Si rezultat i vlerësimit të punës intensive dyjavore të studentëve në Prizren, gjatë Universitetit Veror të këtij viti:

- Duke krahasuar punën e studentëve të këtij viti me studentët tjerë për nga koha që kanë pasur në dispozicion për të përmbushur detyrat e tyre, rezultati është mjaft i kënaqshëm për faktin që shpejt kanë arritur të kuptojnë çka kursi kërkon prej tyre dhe e cili është rezultati që duhet të arrihet.
- Të gjitha grupet kanë arritur të japin një prezantim të qartë të punës së tyre, duke shfrytëzuar metodologjitë e prezantuar të dokumentimit.
- Marrëdhëniet që studentët krijuan mes veti përgjatë kësaj kohe, gjithmonë duke pasur parasysh faktin që ata vijnë prej shteteve të ndryshme, është një element i rëndësishëm i cili përmbush tërë procesin.

Për fund, jam shumë e kënaqur me performancën e tyre dhe gatishmërinë për t'iu qasur temës së studimit.

Evaluation

The two weeks' intensive work students undertook in Prizren as part of the Summer University 2010 was a highly successful event.

- In comparison with the work of other students and precedent summer courses of this nature, the students in Prizren grasped the concepts and techniques introduced in the course quickly and effectively, and reached highly satisfactory outcomes.
- Each group made clear presentations of their work and results, demonstrating the appropriate use of documentation methodology
- An important and highly successful aspect of this process was the commitment to teamwork, communication and building relationships between themselves as participants, especially given that the students came from many different countries.

The students' readiness to learn and develop their training was much appreciated, and they should be congratulated for their performance during this course.

Konkludim

Vlerësimi i rilevimit/vlerësimit të monumentit mund të merr forma të ndryshme dhe është pjesë thelbësore e kuptimit të konstrukcionit dhe strukturës.

Si rezultat, analiza merr formën e një regjistrimi interpretues me vizatime të interpretuara qartë.

MA. Teuta Jashari-Kajtazi, GEA

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.

Conclusion

The site survey and assessment can take many forms and is an essential part of understanding the construction and meaning of a structure.

As a result, the analysis is an interpretative record with clearly annotated drawings.

MA. Teuta Jashari-Kajtazi, GEA

University of Prishtina, Faculty of Civil Engineering and Architecture

Shtëpitë e rilevuara

The Documented Houses

Bajmaku, Bërlajolli, Kirajtani, Mashkulli, Qyse

3. Banesë qytetare BAJMAKU Citizen Urban House BAJMAJK

Vendi – Në qytetin e Prizrenit në Kompleksin e Marashit janë ekzistuese pos tjerash edhe dy banesa qytetare.

Periudha – Ndërtimet i takojnë kapërcyellit të shek. XIX.

Tipologjia – Banesat i takojnë tipit ballkanik me elemente vendore.

Mjeshtrit: – U realizua nga mjeshtër popullor me përvojë.

Teknika e ndërtimit – Në realizimin e banesave është përdorur materiali i përzier guri qerpiçi dhe druri, të lidhura me llaç baltoje. Si element konstruktiv përforsues, në përdhese janë përdorur hatullat (brezat horizontal të drurit), ndërsa në etazhë është përdorur sistemi konstruktiv bondruk. Hapjet janë të mbuluara me arkitra.

Dyert sigurohen me rreze metalike, ndërsa dritaret e përdheses me parmak metalik të vendosura në mënyrë vertikale. Meskatet janë të ndara me konstruktion- dysHEME druri. Komunikimi bëhet me ndihmën e shkallëve po ashtu nga druri.

Objektet kanë çati druri të mbuluara me qeramidhe, fasadat janë të suvatuara me llaç balte.

Etazhiteti dhe funksioni: Banesat qytetare janë të përbëra prej përdheses dhe katit me funksione të ndryshme. Funksioni primar ishte dhe është banimi. Dhomat veçohen me tavane të punuara dhe të dekoruara nga materialet e drurit dhe dollapë me kapakë druri të përpunuara nga mjeshtri popullor.

Location – Marash Complex in the city of Prizren

Period – Buildings date from the 19th century.

Typology – Buildings are mixture of Balkan style with local elements.

Construction craftsmen – Local, experienced craftsmen.

Construction technique – Different types of materials, such as stone, clay and a combination of timber frame and mud brick, were used in the construction of these buildings. Hatullat (horizontal wooden beams) were used as a structural support on the ground floor, while the first floor used a constructive system called bondruk.

The door knobs are metal, while the windows have vertical metal grilles on their inner side.

The floor construction is timber, and access between levels is achieved via wooden stairs.

The roof construction is also timber framed and covered with clay tiles.

Facades are plastered with mud.

Spaces and function – These buildings comprise a ground floor and first floor of various functions. They also have a garden. The primary function was, and continues to be, domestic inhabitation. The rooms are characterized by decorative timber-lined ceilings and by wooden cupboards crafted by local artisans.

Konfiguracioni i terrenit dhe planimetria – Konfiguracioni i terrenit ndikoi në planimetrinë e këtij objekti. Banesat e vjetra qytetare u realizuan në pjesën e poshtme të kalasë së vjetër të qytetit të Prizrenit në rrjedhën e majtë të lumit Lumbardh, përballë kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Statusi dhe gjendja – Banesat e vjetra janë në gjendje jo të volitshme dhe është çështje kohe ekzistenca e tyre, edhe pse kanë statusin e monumentit në kuadër të Kompleksit të Marashit.



SHTËPIA BAJMAKU
BAJMAKU HOUSE



KONZOLLA
CANTILEVER



DUKJA E SHTËPISË
VIEW OF THE HOUSE



DERA HYRËSE
ENTRANCE DOOR

Setting and site plan – The location and setting of the building had an impact on its plan. Old city houses were built on the left stream of river Lumbardhi, in front of the Albanian League of Prizren complex.


Status and condition – These old buildings are in very poor condition and at risk even though they have monument status as part of the Marash Complex.



DUKJA E KULMIT
VIEW OF THE ROOF



JYKLYKU
JYKLYK




ROZETA
WOODEN CEILING




DERA E TAVANIT
DOOR TO CEILING




DËMTIMET NË SHITËPI
DAMAGES




FIRST FLOOR





SECTION A-A






SECTION B-B






DUKJA



PLANI


100



PRERJA

105

DETAIL "B"





Plan

Situacioni

Evidentimi i akseve kryesore dhe
fashave të gjelbëruara.

Plani i përgjithshëm në të cilin
tregohet objekti.

Site plan

Presentation of main axes and
green lines.

Location of the building in
general site plan.

Site Plan





North Facade





West Facade



South Facade



Problematikat

Ky objekt përbëhet ka dy hyrje t cilat bashkohen nën një kulm. Sht pia është n ëgjendje të rënd fizike. Hyrja e dytë është jasht funksionit dhe paraqet rrezik për personat qëtentojn të hynë brenda shtëpisë . Kulmi është amortizuar totalisht dhe nuk e mbron shtëpinë nga të reshurat.

Problems

This building consists of two parts, which are covered with one single roof. Building is in very poor condition. Second entrance is out of use and presents danger for those who try to enter inside the house. The roof is completely amortized and does not protect the house from rains.





Skicat / Sketches

Ekipi punues

Mbikëqyrës: i.d.a. Fikret Tikvesh – IMM Pz

- Tomorr Menzelxhiu Universiteti POLIS – Fakulteti i Arkitekturës, Tiranë, Shqipëri; Viti III
- Ardit Muka Universiteti POLIS - Fakulteti i Arkitekturës, Tiranë, Shqipëri; Viti III
- Armend Shaqiri Universiteti i Tetovës – Fakulteti i Arkitekturës, Tetovë, Maqedoni; Viti III
- Orges Drançolli Universiteti i Prishtinës – Fakulteti Filozofik, Dega e Historisë, Prishtinë, Kosovë; Viti III



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS

Working Team

Supervisor: i.d.a Fikret Tikvesh – IPM Pz

- Tomorr Menzelxhiu University POLIS – Faculty of Architecture, Tirana, Albania; Year III
- Ardit Muka University POLIS – Faculty of Architecture, Tirana, Albania; Year III
- Armend Shaqiri University of Tetova – Faculty of Architecture, Tetova, Macedonia; Year III
- Orges Drançolli University of Prishtina – Faculty of Philosophy, Section History, Prishtina, Kosovo; Year III



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS

4. Shtëpia e Familjes BËRLAJOLLI House of the Family BËRLAJOLLI

Lokacioni – Shtëpia e Familjes Bërlajolli, gjendet në pjesën jugore të Prizrenit, në lagjen “Sezair Surroi”.

Supozohet të jetë ndërtuar gjatë shekullit XIX. Informata të sakta në lidhje me kohën e ndërtimit nuk kemi gjetur. Në këtë shtëpi banon Familja Bërlajolli.

Shtëpia është vendosur kah rruga, me oborr të brendshëm, ku gjendet edhe mutfaku. Në murin jugor, rrethues të oborrit kemi hasur në gjurmët e një kapigjiku (deriçkë), e cila është mbyllur në një kohë të panjohur. Kjo deriçkë ka shërbyer për lidhjen e oborrit të shtëpisë me oborrin e fqinjit.

Funksioni – Shtëpia është e formësuar në dy etazha: Përdhesa e kati dhe bodrumi i cili mbulon vetëm një pjesë të gabaritit të përgjithshëm të objektit.

Përdhesa: Në përdhes gjendet hajati, që shpien në oborrin e brendshëm – i shtruar me kalldrëm, në fund të së cilës gjendet kuzhina verore – mutfaku.

Në të majtë të hajatit, gjendet dhoma e ndejës, dyshemeja e së cilës është e ngritur për dy shkallë.

Përballë derës së hyrjes, gjenden shkallët e drurit që shpien në katin e parë.

Në katin e parë, gjenden tri dhoma të fjetjes, korridori dhe një nyje sanitare, e cila është shtuar më vonë.



SHTËPIA BËRLAJOLLI
BËRLAJOLLI HOUSE



FASADA LINDORE
EAST FACADE



MURI I OBORRIT
CONSTRUCTION OF YARD'S WALL



DUKJA E MUTFAKUT
VIEW OF THE SUMMER KITCHEN

Location – The house of the Bërlajolli Family is situated in the south part of Prizren, in the neighbourhood of Sezair Surroi.

It is estimated that the house was built during the 19th century, although exact information on its date of construction could not be found. The Bërlajolli family continue to live in this house. It is located next to a road, and has an internal yard where the mutfak (summer kitchen) is situated. On the south-facing wall which surrounds the yard, there is evidence of a small door (kapigjik) which was closed off at some time in the past. This door connected the Bërlajolli house yard with the neighbour's yard.

Function – The house is formed of two levels: the ground floor and the first floor, and a basement present only in half the house.

Ground floor: A hajat (porch) leads to the internal yard paved with cobble stones, where the mutfak is located.

To the left of the hajat is situated the living room, which is raised from the hajat's level by two steps.

Wooden stairs opposite the main door lead us to the first floor.

There are three bedrooms on the first floor, and a hall and a toilet, which was added later as an annex.

Construction – The basement walls indicated that the foundations are made of stone.

The surrounding northern and southern walls are made of stone up to a height 1.2 m, with a thickness of 50-60 cm.

Konstruksioni – Nga muret e bodrumit shihet se themelet janë nga guri. Muri perimetrik verior dhe jugor në përdheshë është nga gurët deri në lartësinë 1.2 m, me trashësi rreth 50- 60 cm.

Muret e brendshme në përdheshë dhe në kate, janë nga qerpiçi, të ndërtuara me sistemin bondruk.

Dyshemeja në hajat, është nga betoni. Dhoma e ndejës, si dhe dhomat në kat kanë dyshemenë nga druri.

Shkallët e brendshme të shtëpisë janë gjithashtu nga druri dhe janë në gjendjen origjinale.

Konstruksioni i kulmit është ai fillestar nga druri. Kulmi është dy uJOR, me mbulesë me tjegulla të argjilës.

Arkitektura – Eksterieri: Fasada kryesore kah rruga, ka elemente dekorative në dritaret e katit të parë.

Dera e hyrjes është punuar me një kujdes të veçantë nga druri, ku shquhet dorëza.

Entrieri: Dhoma e ndejës në përdheshë ka ruajtur origjinalitetin ku mund të vërehen elementet karakteristike: hamamgjiku – që sot nuk e kryen funksionin fillestar, jyklykët – dollapë të vendosur në brendi të mureve, dyert janë nga druri, me dorëza karakteristike të asaj periudhe, dritaret janë dyfishe, me skelet nga druri. Në fasadën lindore, dritaret ekzistuese kanë pasur edhe nga një ndarje të sipërme, që janë mbyllur më vonë.

The internal walls on the ground and first floor are constructed of clay, using the bondruk system.

The floor in the hajat is concrete, while the living room and bedrooms have wooden floors.

The internal stairs of the house are also made of wood and are in an original condition.

The roof construction is original, without any interventions until now. The construction is a double-pitched timber frame, covered with clay tiles.

Architecture:

Exterior: The main façade lines the main road, and has decorative elements on the windows of the first floor. The entrance door is made of wood and, with its decorative knob, merits attention for its craftsmanship.

Interior: The living room on the ground floor has kept its original condition, with notable elements: the hamamgjiku (bathroom), today used as storage; the jyklyk cupboards lining the walls; the musandra, where copper dishes used to be kept, now replaced with ceramic dishes; wooden doors with knobs characteristic of the period; double windows, with wooden frames. On the east façade, the existing windows used to have an additional upper part, but these were closed off.

There are three bedrooms on the first floor. Two of them have views of the main road and the other looks over the internal yard. The last room on the floor was linked directly to the bigger room by a door which was



DHOMA E NDEJES
LIVING ROOM



HAJATI
PORCH



GUR I VIETËR NGA NYJA SANITARE
OLD STONE FROM TOILET



DETAJ I DORËZËS SË DERËS
KNOB DETAIL

Në kat, gjenden tri dhoma të fjetjes. Dy dhoma gjenden kah pjesa ballore, dhe njëra ka pamjen kah oborri i brendshëm, i cili kishte lidhje direkte me dhomën fqinje përmes derës e cila më vonë është mbyllur. Në dhomën e madhe, me pamje kah rruga gjenden jyklykët dhe oxhaku i hamamgjikut. Dhomat me pamje ballore kanë oxhaqet e tyre që kanë shërbyer për ngrohjen e dhomave. Tavanet janë të punuar nga druri, por nuk kanë ndonjë dekorim të veçantë. Dyert e brendshme janë identike. Dritaret në korridor dallohen nga ato në përdheshë.

Transformimet :

1968 – Dyshemeja e hajatit, ka qenë fillimisht nga dheu i shtypur. Në vitin 1968 kjo dysheme është zëvendësuar me çimento.

1983 – Hajati kah ana lindore ka qenë i hapur, me ç’rast lidhte rrugën me oborrin e brendshëm dhe mutfakun. Në vitin 1983, hajati është mbyllur me derë kah oborri i brendshëm.

2004 – Pas shpërthimit të kanalizimit, hajati është gropuar, me ç’rast është gjetur edhe një gur parahistorik, dhe dyshemeja është shtuar përsëri me beton.

Aneksi i shtuar në murin lindor, ku gjenden dy nyje sanitare, në përdheshë dhe kat është shtuar gjatë viteve ‘80.

later closed. There are three jyklyk and the chimney of the hamamgjik in the bigger room. The rooms at the front of the house have chimneys which served for heating. The ceilings are made of wood, but do not have any rich decoration. The internal doors are identical. The windows which face the yard differ from the other windows.

Transformations:

1968 – The floor of the hayat was initially made from compressed soil. In 1968 this floor was replaced with cement.

1983 – The hayat was opened to the internal yard. It connected the main road with the internal yard and mutfak. In 1983 the hayat was closed with a door on its east side.

2004 – Due to problems with the water pipes, the hayat was excavated, during which a prehistoric stone was found. The floor was replaced with concrete.


The annex in the east wall, where two toilets on the ground and first floor are located, was added during the 1980s.




JYKLYKU
JYKLYK




DERA HYRËSE
ENTRANCE DOOR




JULY 2010




BASEMENT PLAN




JULY 2010




GROUND FLOOR PLAN






JULY 2010




FIRST FLOOR PLAN




JULY 2010





ROOF PLAN






SECTION 1-1








EAST FACADE




JULY 2010




WEST FACADE







section




plan

STAIR DETAIL
Detail 2

JULY 2010





ENTRANCE DOOR DETAIL

Detail 1

JULY 2010

Ekipi punues

Mbikëqyrës: BA. Nora Arapi - CHwB

- Kujtesa Godeni Mimar Sinan Universiteti i Arteve të Bukura – Fakulteti i Arkitekturës, Istanbul, Turqi; Viti IV
- Lutviye Muci Mimar Sinan Universiteti i Arteve të Bukura – Fakulteti i Arkitekturës, Istanbul, Turqi: Arkitekte e diplomuar
- Selen Suphiye Kandemir Mimar Sinan Universiteti i Arteve të Bukura – Fakulteti i Arkitekturës, Istanbul, Turqi; Viti III
- Taulant Abazi Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Filologjik – Drejtimi Gjuhë Angleze, Prishtinë, Kosovë; Viti III

Working Team

Supervisor: BA. Architecture Nora Arapi – CHwB

- Kujtesa Godeni Mimar Sinan University of Fine Arts – Faculty of Architecture; Istanbul, Turkey; Year IV
- Lutviye Muci Mimar Sinan University of Fine Arts – Faculty of Architecture; Istanbul, Turkey; Graduate Architect
- Selen Suphiye Kandemir Mimar Sinan University of Fine Arts – Faculty of Architecture; Istanbul, Turkey; Year III
- Taulant Abazi University of Prishtina – Faculty of Philology, Section English language, Prishtina, Kosovo; Year III



DUKJE E DRITARES
WINDOW VIEW



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS

5. Shtëpia e Familjes KIRAJTANI House of the KIRAJTANI Family

Emërtimi / statusi i objektit – Shtëpia e Shemsedin Kirajtanit gjendet në listën e objekteve të evidentuara të Institutit për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren.

Lokacioni – Shtrihet në qendrën e qytetit të Prizrenit, e rrethuar nga objekte të tjera të banimit. Adresa: Rruga "Shuaip Pashë Spahiu", no.15.

Koha e ndërtimiti – Në bazë të bisedës së bërë me pronarë të shtëpisë, ky objekt është ndërtuar në fillim të shekullit XIX. Në vitin 1970 është ndërtuar një aneks në anën veri-perëndimore të objektit.

Dispozita Urbanistike – Objekti gjendet në zonën e parë të mbrojtur të Prizrenit, gjegjësisht në nënzonën e parë të zonës historike të Prizrenit.

Tipologjia / etazhiteti – Është shtëpi qytetare me karakteristika vendore, e formësuar në dy kate dhe bodrum. E projektuar si shtëpi me dy etazha, kati i parë i së cilës do të shtrihej në tërë sipërfaqen e përdheses, objekti nuk është përfunduar për arsye ekonomike, duke e lënë në gjysmë katin e parë dhe duke gjetur një zgjidhje, e cila mbulon dy anët e mbetura të përdheses, me kulm dy uJOR.

Destinimi fillestar dhe i tanishëm – shtëpi banimi.

Pronësia / shfrytëzuesit – private / Arlind Kirajtani dhe familja e tij. Gjendja aktuale teknike e objektit – Objekti është në gjendje jo të mirë, pasi ka çarje në katin e parë dhe në bodrum. Gjendja aktuale e shtëpisë



SHTËPIA KIRAJTANI
KIRAJTANI HOUSE



DEKORIM NË FASADË
FACADE DECORATION



HAJATI
PORCH



HARKU DHE TAVANI
BEAM AND CEILING

Designation / status of the building – The house of Shemsedin Kirajtani is on the list of evidenced buildings for the Institute for the Protection of Monuments in Prizren.

Location – The house is situated in the city centre of Prizren, surrounded by other residential buildings, at 15 Shuaip Pashë Spahiu Street.

Building period – According interviews with the house owners, the building was constructed at the beginning of the 19th century. In 1970 an annex was built on the north-west side of the house.

Urban location – The building is situated in Protection Zone 1 in Prizren, and respectively in Sub-Zone 1 of the Historic Zone of Prizren.

Typology/Levels – This house is an example of a urban citizen house, characterised by local features, and built over two storeys with a basement. Designed as a two-storey house, the first floor would have sat directly above the ground floor but the building remained unfinished because of economic conditions. Therefore only only a part of the first storey was completed, and a solution was found to cover two sides of the first storey with a double pitched roof.

Original and present use – Residential house.

Ownership/residents – Private ownership by Arlin Kirajtani and his family.

nuk është e favorshme, edhe pse është e banueshme. Në objekt është e nevojshme të bëhen intervenime për rehabilitimin e konstruksionit mbajtës, në mënyrë që të shtohet jetëgjatësia e objektit.

Dokumentacioni teknik ekzistues rreth objektit – objekti nuk është rilevuar deri më tani.

Materialet dhe teknika e ndërtimit – Themelet dhe cokla (muret 1 metër mbi dhe), janë nga guri dhe llaçi, kurse pjesa tjetër e përdhesis është ndërtuar me qerpiç të lidhur me llaç.

Tipi i kulmit dhe mbulesa – Nën kulmi është ndërtuar me stilin bondruk, kulmi ka konstruksion nga druri i mbuluar me tjegulla në formë lugjesh.

Fazat e ndërtimit – Në lidhje me fazat e hershme të ndërtimit nuk kemi informata të sakta, përpos kohës kur supozohet kur është ndërtuar objekti. Në vitin 1970 është shtuar aneksi në anën veri-perëndimore të objektit.

Elementet karakteristike të fasadës – Fasada është simetrike, me elemente karakteristike të ndërtimeve tjera në Prizren, por me një veçanti në dukje e cila vjen si pasojë e mospërfundimit të objektit. Dhomat në katin e parë, japin pamjen e një baxhoje të madhe në kulm.

Elementet karakteristike të enterierit – Dritaret, tavanet, dollapët, janë nga druri të përpunuara me shumë mjeshtri. Dyshemetë janë të shtruar me material druri, përpos pjesës së bodrumit që nuk është i shtruar,

Current technical condition of the building – The building is in poor condition, with cracks in the walls of the first floor and in the basement. The current building is habitable but not ideal, so it is necessary to rehabilitate the main construction of the building in order to increase the lifespan of the building.

Technical documentation – The house has not previously been surveyed.

Materials and construction methods – The foundations and the plinth (perimeter walls at 1 meter above ground level) are made of stone and mortar, while the walls on the ground floor are made of clay with mud joints.

Roof type and coverage – The roof construction is of the bondruk system, a timber structure covered with concave clay tiles.

Construction phases – There is no exact information relating to prior construction phases, except for the period when the building was erected. An annex was added to the north-west side of the house in 1970.

Specific elements in the facade – The facade of the building is symmetrical, with characteristic features found on old traditional houses in Prizren, although unique in possessing an unfinished first floor. Rooms on the first floor give the appearance of a large dormer in the roof.



DERA HYRËSE
ENTRANCE DOOR



DUKJE E DRITARES
WINDOW VIEW

është nga dheu. Dhomat në përdhesë janë të lidhura përmes korridorit i cili është nën nivelin e dhomave për 60 cm. Hyrja nëpër dhoma bëhet përmes shkallëve individuale për secilën dhomë. Lidhja e kateve bëhet përmes shkallëve të brendshme, në formë L. Bie në sy përpunimi i tavanëve prej druri me dekorime mjaft të bukura. Si elemente të rëndësishme kulturore janë pasqyrat e dekoruara që janë sjellë nga Turqia nga gjyshi i pronarit Qamil Kirajtani, i cili me profesion ka qenë berber.

Rrethina (Objektet, oborri, muret, infrastruktura, rrugët, gjelbërimi) – Hyrja në shtëpi bëhet nga dera kryesore, përmes oborrit të përparmë që është shtruar më kalldrëm. Në oborr gjendet ahri, i cili po ashtu është i vjetër sa shtëpia. Oborri është i gjelbëruar më një kopsht të këndshëm dhe të kultivuar me kujdes. Lisi i manit dhe i hurmës së egër i bëjnë fllad shtëpisë gjatë kohërave të nxehta. Në oborr shihet kanali, ku kalonte uji i lumit që përdorej për nevoja të shtëpisë, dhe vazhdonte në oborret fqinje. Instalimet në shtëpi janë: ujësjellësi, kanalizimi, rryma elektrike, telefoni dhe interneti. Këto janë shtuar me kalimin e kohës, për adaptimin e nevojave jetësore.

Konkluzioni – Është më se e nevojshme që të ruhet kjo shtëpi, të mirëmbahet dhe të prezantohet si trashëgimi e veçantë arkitektonike e qytetit të lashtë të Prizrenit.

Specific elements in the interior – Windows, ceilings, and lining boards are made of wood and skilfully crafted. Floorboards are laid throughout the house, except in the basement which is unpaved and made of compressed earth. Rooms on the ground floor are connected by a hall which is 60 cm below their floor level and each is entered up separate steps off this hall. A dogleg (L-shaped) staircase connects the two storeys. The highly decorated wooden ceilings are noteworthy. As important cultural elements, the original decorated mirrors, brought from Turkey by the house owner's barber grandfather, Qamil Kirajtani, remain a feature of the house.

Surrounding buildings and setting – The house is entered through the front yard (paved with kalldrëm cobble stones), arriving at the main wooden door. The ahri (stable), which is as old as the house, is located in this front yard. The yard itself is a lovely, carefully tended garden, with a mulberry tree and wild date-palm creating breezes during hot summer days. A channel, carrying water from the river for the house's needs, remains visible and extends into neighbouring yards. Services installed in the house include a mains water supply and canalisation, electricity, telephone and internet, and were installed later to meet the residents' needs.

Conclusion – This house should be preserved, maintained and presented as an example of architectonic heritage of high value in the ancient city of Prizren.




DETAJ I DERËS
DOOR DETAIL




JYKLYKU
JYKLYK














SECTION A-A





SECTION B-B






DETAIL 4



DETAIL 1



Assessment-existing conditions of buildings	
The Name of the House: Family KRAJAKI	
Location: Etno Turka	
Address: Shkup, Pasha Spahiu No. 11	
The Frontage:	
Date: 1.10	
Evaluators:	
Eronda Elehani Jata Nalban	
Bujen Koci Denis Kraja	
Scale: 1:100 (KRAJAKI)	




DETAIL 2




Assesment-existing conditions of buildings
<i>The name of the house</i> Family KRAJIANI
<i>Name of the owner</i> Enes Toke
<i>Address</i> Shqip Pasha Spatku Nr.15
<i>The Perspective</i>
<i>Created by</i> Erolta Elezani Jeta Nelbeni
<i>Supervisor</i> Ripien Koci Denis Kraja
<i>Date</i> 2019-09-20-2020




DETAIL 3



DETAIL 4



Assesment-existing conditions of buildings	
The name of the house	Family KIRAJIANG
Designer	Enes Toeka
Subject	Shuulp Paaha Spatau Nr. 15
The Perspective and details	
Drawing	
Erwinfa Elshant Jato Nulbani	
Bojken Kooi Dente Kraja	
Date: 2010 FEBRUARY	



DETAIL 5

Ekipi punues

Mbikëqyrës: arch. Enes Toska – CHwB dhe i.d.a. Nol Binakaj - CHwB

- Jeta Nallbani Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës- drejtimi Arkitekturë, Gjakovë, Kosovë, Viti IV
- Erodita Elshani Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Prishtinë, Kosovë, Absolvente
- Boiken Koçi Universiteti U.F.O, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, dega Arkitekturë, Tiranë, Shqipëri, Viti III
- Denis Kraja Universiteti U.F.O, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, dega Arkitekturë, Tiranë, Shqipëri, Viti II

Working Team

Supervisor: arch. Enes Toska and i.d.a. Nol Binakaj – CHwB

- Jeta Nallbani University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Gjakova, Kosovo; Year IV
- Erodita Elshani University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Final year student
- Boiken Koçi U.F.O University, Faculty of Applied Sciences, Section Architecture, Tirana, Albania, Year III
- Denis Kraja U.F.O University, Faculty of Applied Sciences, Section Architecture, Tirana, Albania, Year II



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS

6. Shtëpia e familjes MASHKULLI The House of the MASHKULLI Family

Kursi i shkollës verore me temën Arkitektura tradicionale dhe metodat e dokumentimit, për detyrë ka caktuar dokumentimin e banesës qytetare shqiptare të shekullit të XVIII dhe XIX. Shtëpia që është dokumentuar nga grupi C është shtëpia e familjes me mbiemër Mashkulli.

Vendi – Gjatë asaj kohe, qendër e qytetit të Prizrenit ishte pjesa me ndërtimin e Xhamisë Bajrakli dhe Medresesë që tani njihet si vendi ku mbajti Lidhja e Prizrenit. Në këtë zonë familja Mashkulli kishin ndërtuar shtëpinë e tyre në afërsi të këtyre përmbajtjeve.

Periudha – Mendohet se koha e ndërtimit të shtëpisë së Meshkujve ishte rreth dyqind vite më parë atëherë rreth vitit 1800, para ndërtimit të Lidhjes së Prizrenit.

Tipologjia – Oborri i shtëpisë së Meshkujve ishte i pasuruar me disa përmbajtje, selamllëkun, haremin dhe çardakun. Selamllëku apo shtëpia mikpritëse ishte shkatërruar rreth viteve 1980. Familja Mashkulli në atë kohë merrej me tregti dhe për këtë arsye çardaku i shtëpisë ishte i zgjatur deri te lumi, i cili çardak shfrytëzohej për tregti dhe për dyqane të ndryshme si p.sh. këpucëtar. Çardaku është shkatërruar me ndërtimin e objektit të Kuvendit Komunal rreth vitit 1954. Shtëpia që është rilevuar, në atë kohë është quajtur harem, apo shtëpia kryesore duket të ketë tipologji të banesës qytetare shqiptare me ndikim të kulturës islame dhe turke.

Ndërtuesit – Sipas informatave që janë marrë, ndërtuesit e shtëpisë mendohet të kenë qenë nga Tetova, pasi që edhe Ilaçi që është përdorur



SHTËPIA MASHKULLI
MASHKULLI HOUSE



SHTËPIA MASHKULLI
MASHKULLI HOUSE



FASADA BALLORE
FRONT FACADE



TJEGULLAT E ARGJILËS
CLAY TILES

Location – During the 19th century the centre of Prizren was located near the Bajrakli Mosques and Medrese, nowadays known as the League of Prizren, and was where the Mashkulli family built their residential house.

Period – Based on an interview with family members, it is assumed that the Mashkulli Family house was built two hundred years ago, sometime during the 1800s, before the League of Prizren was held.

Typology – Other buildings in the house's yard were the selamllëk, the harem and the çardak. The selamllëk (house for guests) was destroyed during 1980s. The Mashkulli family were traders in the past and the çardaku (closed gallery) was extended to the riverside, being converted into a number of shops, such as for a shoe maker. The gallery was destroyed in 1954 when the Municipal Assembly building was built. The building, which had previously been documented, was the harem (main house) and represents a typology of Albanian citizen house showing the influence of Muslim and Ottoman culture.

Construction craftsmen – According to the information obtained and analysis of the mortar used in construction, it appears that the craftsmen who built the house came from Tetova. Although it is not known exactly who drafted the house plan, it is supposed that the plan was borrowed from another house which belongs to Mashkulli Family, 300 metres from the house under investigation. This house is over 300 years old.

në ndërtimin e shtëpisë është bartur nga Tetova. Plani i shtëpisë nuk dihet saktësisht nga është marrë, por është bërë e ditur se ekziston edhe një shtëpi e të njëjtës familje 300 m larg shtëpisë së rilevuar në lagjen Ralin me të njëjtin plan. Mendohet të jetë kopje e huazuar e asaj shtëpie me vjetërsi mbi 300 vjet.

Teknika e ndërtimit – Në katin e përdheses, themelet në disa pjesë arrijnë deri në plafon. Ato janë të krijuara nga guri. Lidhja e gurit në mes vete është bërë me materialin e kombinuar nga llaçi, qereçi, zalli, vezët dhe dhjami. Kjo gjë ka ndikuar në lidhjen më të fortë të gurëve dhe, po ashtu mbrojtjen nga lagështia.

Konstruksioni i shtëpisë ka qenë nga skeleti i drurit i quajtur 'hatull'i cili ishte i mbushur me qerpiç. Nëpër mure ishin të vendosur gypat që përçonin ngrohjen për objektin. Qymleklëku apo stufa e ngrohjes ishte e vendosur në dhomë, nga qymleklëku përcillej nxemja, e cila bëhej me anë të djegies së drunjve. Ngrohja e ujit me anë të këtyre gypave është bërë në hamamgjik. Muret janë mbajtëse, të punuara me qerpiç. Kulmi ka konstruksion druri dhe është i mbuluar me qeremide, të cilat flenë mbi shindra.

Etazhiteti dhe funksioni – Etazhiteti i shtëpisë së Meshkujve ka qenë që nga fillimi P + 2. Funksioni i shtëpisë është prezantuar në vizatimet e projektit. Konfiguracioni i terrenit dhe planimetria – Terreni ka qenë i pjerrët dhe në oborr haremi ka qenë në nivel më të ulët se Selam llëku.

Construction techniques – In some parts of the ground floor, the foundation walls reach the ceiling and are made of stone. The connection of stones was through a combination of various materials such as mortar, lime, grit, eggs and fat. These materials improved the jointing between stones and protected the wall from moisture. The house construction was of a wooden frame, called "hatulla", which was filled with clay. Pipes within the walls spread heat around the building from a wood-burning stove (qymleklëk) which was placed inside the room. Water used in the hamamgjik (bathroom) was warmed through these pipes. Retaining walls are made of clay. The roof is timber framed and covered with clay tiles.

Function – The house of the Mashkulli Family had been constructed on three levels, consisting of a ground floor and two upper floors. The function of the house is presented in the project drawings.

Area configuration and plan

The house was sited on an incline and the harem was located at a lower level than the guests' house. The river passed through the guests' house and directed through pipes into the centre of the town for the citizens' use. Because of the changes in the position of the Lumbardhi River, the building is now situated in an almost flat area.

Status and condition – Compared to its heyday, the building today is in very poor condition and lacking space for the numerous families living there.



DUKJE E DRITARES
WINDOW VIEW



DORËZ E VIETËR
OLD KNOB

Lumi ka kaluar kah Selamllëku dhe, nëpërmjet gypave, është orientuar kah qendra për nevoja të qytetarëve. Për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur më pozitën e shtratit të lumit, sot shtëpia gjendet në terren pothuajse të rrafshët.

Statusi dhe gjendja – Gjendja e shtëpisë, në krahasim me kohën e ndërtimit është e mjerueshme. Është hapësirë shumë e vogël për të jetuar disa familje në të.



DEKORIM NË ENTERIER
INTERIOR DECORATION



SHKALLËT E BRENDSHME
INTERNAL STAIRS



JYKLYK
JYKLYK



ROZETA
WOODEN CEILING



KONSTRUKSIONI
CONSTRUCTION

Banesa e shekullit XVIII - XIX

Qyteti i Prizrenit shquhet për vjetërsinë që ka me ndërtimet e vjetra të banimit. Duke filluar nga Kalaja që gjendet në maje të qytetit, duke zbritur poshtë përgjatë pjerrtësisë dhe deri në rrafshin e qytetit, Prizreni është i pasuruar me ndërtime të kohëve të vjetra. Qyteti i Prizrenit përmban banesa të tipologjisë qytetare tipike me vëllime më të mëdha në krahasim me ato të tipologjisë së fshatrave. Pikërisht tipi i banesës qytetare shqiptare që gjendet në qytetin e Prizrenit, nuk paraqitet si tip i banesës së pastër qytetare shqiptare për shkak të shfrytëzuesve. Shfrytëzuesit e banesës qytetare të Prizrenit dhe, gjithashtu, ndërtimet janë të ndikuara nga fryma e kulturës bizantine, islame dhe turke të shekujve XVIII – XIX. Shtëpitë me çardak i karakterizojnë shtëpitë tipike shqiptare në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit. Kushtet shoqërore, ekonomike, klimatike, relievoe kishin ndikim të madh në ndërtimin e banesave të asaj kohe, po ashtu familjet tregtare gjithnjë kishin ndikim për ndërtimet që do të bënin në mënyrë që të përmbushnin kushtet e tyre për jetesë sa më të mirë.

Dwellings of 18th – 19th century


Prizren is city famous for its old, traditional dwellings. Starting from the Castle, which dominates the city, and dropping down along the mountain-side to the part of the city that lies on the plain, Prizren's urban landscape is enriched with numerous historic buildings. Prizren has several urban residences, larger in volume than rural dwellings, but they do not represent a typical example of the urban house in Kosovo. The diversity of the town's inhabitants, influencing each other in social and cultural terms, also had an impact on building and construction and the legacy of Byzantine, Muslim and Ottoman culture during the 18th and 19th centuries is visible.

Houses with a gallery are representative of the typical Albanian house, in comparison to other places in Balkans. Social, economic and climatic conditions and topography influenced greatly the construction of dwellings during this period, but the lifestyle demands of individual families also had an important impact on the way of building.

Funksioni - Function Baza e përdhesës - Ground Floor



Pasi që familja kishte traditë tregtare kati përdhesë ishte shfrytëzuar si depo.
Ground floor was used as storage space, while family used to practice trade.





Këtu ka ekzistuar një derë
There used to be a door.

Lumi ka kaluar në mes të shtëpisë kryesore (harem) dhe shtëpisë mikpritëse (selamllëkut). Me anë të kanaleve të ujit është bartur nëpërmes shtëpisë kryesore deri te qendra ku është shfrytëzuar nga qytetarët.

The river passed through the main house (harem) and guest house (selamllëk). Water was spread to the city center for citizen's use, through channels.








FIRST FLOOR



Funksioni - Function Baza e katit I - First Floor



Përmes kësaj dërrë kalohej në oborrin që ka qenë i gjatë 8 m dhe është lidhur me Selarollëkun.
Through this door was the entrance to 8 m long yard, which linked the Guest House.



Hamangjiku
Bathroom

Dymëkllëku (kamini)
Stove

Sergjenllëk (mbajtja e enëve) dhe Ferashllëk (mjetet për pastrim).
Sergjenllëk (cupboards) and Ferashllëk (storage for hygiene tools).
Juklyk (mbajtja e jorganeve dhe jastëkëve) dhe sandëku.
Juklyk (board inside the wall for clothes storage).




- Dhoma dimërore + hamangjiku
Zakonisht është përdorur për martesë
-Winter room + hamangjik
Usually were used for wedding occasions
- 2 -Çardaku dhe hamangjiku i shtuar në vitet 1970
-Garret and hamangjik added in 1970
- 3 -Korridori
- 3 -Hall
- 4 -Aralëku - Vendi ku kanë qëndruar lëndët për gymëkllëk. Gjatë verës është shfrytëzuar si depo.
-Aralëk - storage space for fuels. During summer it was used as storage space.
- 5 -Hapësira në mur, ku janë mbajtur dhe sot mbahen, gjëra religjioze.
-Niche in wall, where were kept and are still kept religious books.
- 6 -Dollap dhe fiokë për mbajtjen e rrobave.
-Board for clothes storage.




Funksioni - Function Baza e katit I - Second Floor



- 1 - Dhoma dimërore e njëjtë si në katin e I-rë.
- Winter room same as in First floor
- 2 - Dhoma vërore, zakonisht kryeplaku ka qëndruar aty
- Summer room, place where the head of the family stayed.
- 3 - Korridori
- Hall
- 4 - Arallëku.
- Arallëk - storage space
- 5 - Dhoma e sandëqeve dhe e gardrobës.
- Wardrobe.








SECTION A-A






SECTION B-B



NORTH FACADE






SOUTH FACADE






EAST FACADE





WEST FACADE







DOOR DETAIL





JYKLYKU DETAIL







SKETCHES

Ekipi punues

Mbikëqyrës: i.d.a. Jusuf Xhibo – IMM Pz.

- Dafinë Gashi Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti IV
- Gentë Retkoceri Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti IV
- Everest Çorbaxhi Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Arkitekturë, Tiranë, Shqipëri, Viti V
- Faik Berisha Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Drejtimi Arkitekturë, Prishtinë, Kosovë, Viti III

Working Team

Supervisor: i.d.a Jusuf Xhibo – IPM Pz

- Dafinë Gashi University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year IV
- Gentë Retkoceri University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year IV
- Everest Çorbaxhi Polytechnic University of Tirana - Faculty of Civil Engineering, Section Architecture, Tirana, Albania, Year V
- Faik Berisha University of Prishtina – Faculty of Civil Engineering and Architecture, Section Architecture, Prishtina, Kosovo; Year III



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS



MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS

7. Shtëpia e Familjes QYSE House of Family QYSE

Rruga "Vatrat Shqiptare", nr.46, Kompleksi Marash, Prizren

Shtëpia e Familjes Qyse është vendosur në pjesën lindore të qendrës së Prizrenit. Kjo zonë quhet Marash dhe gjendet në zonën e parë të mbrojtur të Prizrenit. Shtëpia gjendet në rrugën e cila vazhdon kah Parku i Marashit dhe Lugina e Lumëbardhit. Rruga ka qenë e shtruar me kalldrëm deri në vitin 2003, kur u zëvendësua me blloqe të betonit. Pranë shtëpisë, në anën jugore, gjendet edhe një shtëpi e vjetër, e cila gjithashtu daton nga shek. XIX. Të dy këto shtëpi kanë pamje kah Lumëbardhi. Në anën lindore të shtëpisë gjendet shkëmbi i kodrës, mbi të cilin dominon Kalaja e qytetit. Konfiguracioni i terrenit ka ndikuar në formësimin asimetric të shtëpisë Qyse dhe shtëpive tjera në fqinjësi.

Shtëpia i ka dy etazha. Konzolla në fasadën ballore është realizuar përmes konstruksionit nga druri, i ashtuquajtur erkere, duke dalë nga gabariti i katit përdhesë. Fasada ballore është karakteristike më konzollën, strehën e kulmit dhe dritaret e mëdha simetrike në katin e parë që mundësojnë pamje të mrekullueshme të lumit. Vizurat e qytetit kanë luajtur rol të rëndësishëm në formësimin e arkitekturës së banimit në Kompleksin e Marashit dhe në Nënkala. Dritaret në katin përdhesë, me pamje kah rruga janë shtuar më vonë me rast të renovimit të shtëpisë.



SHTËPIA QYSE
QYSE HOUSE



SHTËPIA QYSE
QYSE HOUSE

Vatrat Shqipater Street, no.46, Marash Complex, Prizren

The private house of the Qyse Family is located in the eastern part of the city centre of Prizren, in the Marash area, and is in Protection Zone 1. The street continues to Marash Park and the Lumbardhi Valley. It was paved with kalldërm (cobble stones) until 2003, when these were replaced with concrete pavers. Another old house is located next to the Qyse Family house, on its south side, and dates from the 19th century. Both have views of the Lumbardhi River. The cliff, from which the Fortress dominates, forms the eastern edge of the house. This topography has generated the asymmetrical position of this and neighbouring houses.

The house has two storeys. The gallery of the front facade is of erkere wooden construction, arising from the volume of ground floor. The front facade is characterful, consisting of a gallery, roof eaves and large, symmetrical windows on the first floor which give onto a beautiful view of the river bank. This view was important in the residential architecture for many houses in Marash and the Lower Kalaja area. The openings in the ground floor facing the main road were added during the house's most recent renovation.



FASADA BALLORE
FRONT FACADE



FASADA ANËSORE
SIDE VIEW

Historia – Kjo shtëpi është pronësi private e Familjes Qyse, që nga viti 1956, kur Imer Ibrahim Qyse e bleu nga Ramiz Maksut Zhëllta. Imer Ibrahim Qyse (1926-1991) ka qenë nëpunës i lartë, dhe kjo tregon fuqinë e shtresave të caktuara shoqërore për të pasur në pronësi, shtëpi në qendër të qytetit. Këta dy persona kanë vdekur, por kontrata e shitblerjes së shtëpisë është ruajtur. Në kontratë, vlera e shtëpisë është shënuar 330.000 dinarë dhe shtëpia përshkruhet si dykatëshe.

Pronarja aktuale e shtëpisë është Besa Qyse (1962) – me të cilën e kemi bërë intervistën. Ajo jeton në këtë shtëpi nga viti 1978, kur është martuar me Ibrahim Qysen (1955-1995), i biri i Imerit. Djali i saj Edis, kunata Flanza dhe nipërit Ibrahim dhe Nisa jetojnë, po ashtu në këtë shtëpi.

Nga fotografitë familjare të vitit 1978, mund të shohim gjendjen e një pjese të shtëpisë, oborrin dhe rrugën, të cilët kanë pësuar disa ndryshime me kohë. Dëshmitarë të historisë së shtëpisë janë vetë shtëpia, e cila krahas disa intervenimeve ende e ruan origjinalitetin dhe anëtarët e familjes, të cilët besojnë së shtëpia mund të jetë ndërtuar para 180 viteve (rreth vitit 1830).

Në vitin 1996, shtëpia është renovuar, me ç'rast janë bërë disa intervenime në konstruksionin e shtëpisë për ta adaptuar atë, në mënyrë që t'i përmbush nevojat jetësore të banorëve.

Oborri ka qenë i shtruar me kalldrëm, por sot hapësirat ndërmjet gurëve janë mbushur me llaç. Deri në vitet 80, në oborr gjendej pusi, uji ka qenë i pranishëm në të gjitha oborret e shtëpive në Marash.

History – This house has been privately owned by the Qyse Family since 1956, when Imer Ibrahim Qyse bought the property from Ramiz Maksut Zhëllta. Imer Ibrahim Qyse (1926-1991) was an officer, and owning property in the centre of town was a marker of social standing. Although he is now deceased, the deeds to the property have been preserved, revealing that the price of the house was noted as 330,000 dinars and that it is described as a two storey building.

The current owner of the house, Besa Qyse (b. 1962), was interviewed. She has lived there since 1978, when she married Ibrahim Qyse (1955-1995), the son of Imer. Her son, Edis, sister-in-law, Flanza, and grandchildren, Ibrahim and Nisa, live there too.

Family photos from 1978 show the condition of one part of the house, courtyard and the street, which has changed over time. The house is a witness to its own history which, besides few interventions, has remained original. The family believes that house is around 180 years old, and built in the 1830s.

The house was renovated in 1996, with changes in its construction necessary to fulfil the everyday needs of its residents.

The courtyard was previously paved with traditional cobble stones, but today the joints are filled with mortar. Water was present in all house yards in the Marash Complex and there was a well in the yard until the 1980s.

The entrance gate was made of wood, with an old metal knob, before it was replaced in 1996 with a new one, without any aesthetic value.



PAMJE NGA OBORRI
VIEW FROM YARD



PAMJE E DRITARES
WINDOW VIEW



DETAJ I KONZOLLËS
CANTILEVER DETAIL



KONSTRUKSIONI I KULMIT
ROOF CONSTRUCTION

Dera e hyrjes ka qenë nga druri me një dorëz të vjetër nga metali, por është zëvendësuar në vitin 1996 me një derë të re që nuk ka ndonjë vlerë të veçantë estetike.

Planimetria e shtëpisë – Përdhesa ka pasur vetëm një dhomë, që ndriçohet nga një dritare e vogël kah rruga dhe një korridor të vogël të errët. Hyrja në korridor bëhet përmes oborrit të brendshëm kah ana veriore. Pas renovimit, në përdhese është shtuar edhe hajati, prej nga tani bëhet hyrja në përdhesë, ku gjenden dy dhoma (të vendosura linearisht me hajatin) dhe nyja sanitare me formë jo të rregullt, që gjendet në anën e majtë të dhomës së dytë (në anë lindore të shtëpisë). Nyja sanitare daton që nga koha kur është ndërtuar shtëpia. Në përdhesë ka ekzistuar vetëm një dritare e vogël, e cila kishte pamjen kah rruga. Gjatë renovimit në vitin 1996, dy dritare më të mëdha kah rruga janë hapur si dhe një dritare në hajat.

Hyrja e dytë në shtëpi është kah ana lindore të hajatit, përmes shkallëve që të shpien në katin e parë. Këto shkallë janë shtuar më vonë, ndërlidhja ndërmjet kateve bëhet përmes shkallëve të brendshme që kanë qenë në korridor, të cilat nuk ekzistojnë sot. Duke vazhduar ecjen nëpër oborr shohim një hyrje të dytë në përdhesë që na shpie në kuzhinën verore, mbi të cilën gjendet ballkoni. Gjatë vitit 1995, në vend të mutfakut të vjetër me dyer dhe dritare të drurit, është ndërtuar një kuzhinë e re verore, me njëny sanitare, ballkonin dhe shkallët në anën veriore të oborrit.

Plan of the house:

Ground floor – This used to contain only one room, lit by a small window facing the street, and a small dark corridor. Entrance to the corridor was through the north side, from an inner yard. After the renovation, a hajat (porch) was added to ground floor, marking the entrance. Two further rooms and an irregularly shaped bathroom were aligned with this porch, on the left side of a second room on the eastern side of house. The bathroom dates from the house's construction.

There was only one small window on the ground floor facing the street. During renovation in 1996, two bigger windows were opened onto the street, as well as a window in the porch.

The second entrance to the house is on the east side of the porch, via stairs which lead to the first floor. These stairs were added later; the storeys were earlier connected by internal stairs placed in the corridor, but which do not exist today.

Proceeding through the yard reveals another entrance on the ground floor, leading to a summer kitchen. The space is irregular, and had earlier been the location of a mutfak (summer kitchen), with timber windows and doors, and a terrace with metal railings. In 1995 a new summer kitchen replaced the old mutfak, above which is a bathroom and balcony with stairs on the north side.



PAMJE E DRITARES
WINDOW VIEW



DETAJ I DOLLAPIT
BOARD DETAIL

Kati i parë – Holli veri-perëndimor është hapësira e parë që e ndeshim pas hyrjes nga shkallët dhe ballkoni. Nga holli mund të ngjitemi në kulm, që është në gjendje të keqe. Gjithashtu, edhe tavani i hollit është në gjendje të keqe. Tavani është nga druri, me dërrasa paralele, të ngjyro-sura me ngjyrë të bardhë, por pa ndonjë dekorim specifik.

Në të kaluarën, në anën veri-perëndimore të katit të parë ka ekzistuar hamamgjiku, me stufën për ngrohje të ujit, nyjën sanitare, hapësirën për ndërrim dhe në pjesën e mbetur të katit ishte dhoma e ndejës. Pas renovimit, në katin e parë, janë bërë disa ndarje, me ç’rast tani janë dy dhoma të fjetjes, holli, depo dhe dy banjo.

Në anën perëndimore të katit të parë gjenden dy dhoma të fjetjes me pamje kah lumi. Tri dritare me dy krahë të vendosur në murin perëndimor, i ndriçojnë dhomat dhe mundësojnë një pamje të mrekullueshme të qytetit dhe lumit. Dritarja e vogël, e vendosur në dhomën jugore, mundëson pamjen kah Xhamia e Sinan Pashës. Dritarja e vjetër është zëvendësuar më vonë me një dritare të re, përderisa dritaret të tjera në katin e parë të gjitha janë origjinale. Gardëroba e vjetër – arallëk, ende e kryen funksionin fillestar dhe gjendet pranë dhomës jugore.

Konstruksioni dhe materialet – Konstruksioni i kulmit që mbulon tërë shtëpinë është gjithashtu në gjendje të keqe. Konstruksioni është nga druri, i ndërtuar me “një karrige”. Deri më sot, konstruksioni i kulmit ka pësuar shumë pak ndryshime. Kulmi mbulohet me tjegulla nga argjila, me një detaj specifik që rrethon fasadat e shtëpisë,

First floor – Ascending the stairs by the balcony arrives at the irregularly shaped hall at the northeast of the building. Windows onto the balcony are original. The roof is accessible from this hall but, as with the hall’s ceiling, is in poor condition. Made of wood and lined with boards, it is stained white and contains no decoration of note. In the past, a hamamgjik (bathroom), with stove, toilet and changing space, was located in the north-west side of the first floor. The rest of the storey was a living room. After the renovation, some changes were made to the first floor and today it consists of two bedrooms, a hall, storage and two bathrooms.

The west side of the first floor contains two bedrooms facing the river. Three double opening windows in the west wall provide light to the rooms and offer a beautiful view towards the city and river. A small window, placed in the southern room gives views of the Sinan Pasha Mosque. This old window was replaced with a contemporary fitting during the renovation, while the other windows on the first floor are all original. The old wardrobe has retained its original function and sits next to the southern room.

Construction and materials – The entire roof, constructed in timber with a single truss system, is in poor condition. There have been minor changes in the roof construction until now. The roof is covered with clay tiles, with a characteristic detail where the two layers of roofing above the facades are of stone tiles which were used for their self-weight. Stone is used also as the main construction material in the basement and walls. The thickness of the walls was intended to keep the interiors cool

ku dy shtresat e para të mbulesës së kulmit janë nga rrasat nga guri. Rrasat e gurit janë vendosur për shkak të peshës së tyre, për stabilitet. Guri, gjithashtu është përdorur si material ndërtimor në themele dhe mure. Trashësia e mureve është planifikuar në atë mënyrë, që të mbajnë freskinë në ditët e nxehta të verës, dhe të ruajnë nxehtësinë në ditët e ftohta të dimrit. Muret janë mbushur me qerpiç dhe druri është përdorur për sistemin bondruk, për dyshemetë, hajatin dhe konstruksionin e kulmit. Fasada kah rruga dallohet me erkeret e Shtëpisë Qyse, e cila së bashku me shtëpinë fqinje krijojnë një kompozim të jashtëzakonshëm të arkitekturës tradicionale në qytetin e Prizrenit.


during the hot summer months, and warm during cold winter days. They are filled with qerpiç-, a clay and wood combination used for bondruk system which forms the floor, gallery and roof construction. The street facade is articulated by the wooden cantilever of Qyse House, which together with neighbouring house creates a beautiful composition of traditional architecture in the city of Prizren.




MATJET NË TERREN
FIELD MEASUREMENTS




FOTOGRAFI TË VIETRA
OLD PHOTO



SITE PLAN 1: 750







SECTION A-A

0 1 2 3



SECTION B-B

0 1 2 3





NORTH FACADE






WEST FACADE





SOUTH FACADE





WINDOW DETAIL 1:20

Ekipi punues

Mbikëqyrës: BA. Senta Haliti - CHwB

- Arjon Kadillari Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Arkitekturë, Tiranë, Shqipëri, Viti III
- Almelda Toska Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Arkitekturë, Tiranë, Shqipëri, Viti IV
- Krenar Dauti Universiteti i Tetovës – Fakulteti i Arkitekturës, Tetovë, Maqedoni, Viti III
- Jelena Pavličić Universiteti i Beogradit – Fakulteti Filozofik – Departamenti i Historisë së Artit, Beograd, Serbi, Viti IV

Working Team

Supervisor: BA. Architecture Senat Haliti – CHwB

- Arjon Kadillari Polytechnic University of Tirana - Faculty of Civil Engineering – Section Architecture, Tirana, Albania, Year III
- Almelda Toska Polytechnic University of Tirana - Faculty of Civil Engineering – Section Architecture, Tirana, Albania, Year IV
- Krenar Dauti University of Tetova – Faculty of Architecture, Tetova, Macedonia; Year III
- Jelena Pavličić University of Belgrade – Faculty of Philosophy – Department of Art History; Belgrade; Serbia, Year IV

Evaluimi / Evaluation

Pas përfundimit të rilevimit në terren dhe përpunimit grafik të punimeve, puna e studentëve u vlerësuar nga ana e ekipit të përbërë prej: prof. Dr. Emin Riza, MA Teuta Jashari Kajtazi, ida. Jusuf Xhibo – IMMPPz, Enes Toska dhe Nora Arapi – CHwB.

Pesë grupet i prezantuan punimet e tyre, me ç'rast krahas prezantimit grafik të punimeve, studentët treguan edhe përvojat që i kanë hasur në terren.

Puna dyjavore e studentëve, në terren dhe në zyre, u vlerësua lart nga ekipi vlerësues, me ç'rast vlen të ceket se, secili grup ka prezantuar në mënyrë të veçantë anët karakteristike të shtëpive tradicionale, që i kanë hasur gjatë hulumtimit të objekteve.

Studentët pjesëmarrës në fund të projektit, janë pajisur me një certifikatë nga Universiteti Ndërkombëtar Veror i Prishtinës që njihet nga universitetet të tjera evropiane me sistem ECTS, dhe një certifikatë nga CHwB, për arritjet e bëra gjatë kursit. Një kopje e punimeve të studentëve u dorëzua në Institutin për Mbrojtje të Monumenteve në Prizren.



PROCESI I EVALUIMIT
EVALUATION PROCESS



PROCESI I EVALUIMIT
EVALUATION PROCESS



PROCESI I EVALUIMIT
EVALUATION PROCESS



PROCESI I EVALUIMIT
EVALUATION PROCESS

After the completion of field measurements and the graphic design of projects, the students' work was evaluated by a team consisting of: Prof. Dr. Emin Riza; MA Teuta Jashari Kajtazi; ida. Jusuf Xhibo from IPM Pz; Enes Toska and Nora Arapi from CHwB.

Each group presented their work where besides the graphical presentation of projects they also shared their experiences in field. Two weeks of student work, on site and at the office, was highly appreciated by the assessment team, and it should be noted that each group demonstrated in their own way characteristic elements of traditional houses that had encountered during the documentation process.

At the end of the project, students received a certificate from Prishtina International Summer University, which is a standard accepted by other European universities under the ECTS system, and a certificate of achievement from CHwB for their accomplishments during the course. A copy of the project drawings was delivered to Institute for the Protection of Monuments in Prizren.

Përvoja nga terreni / Experiences from the field

Rilevimi i një shtëpie tradicionale paraqet një proces kompleks, ku përpos njohurive për matje dhe rilevim, personat që e bëjnë rilevimin, njihen edhe me elementet sociale të familjeve që jetojnë në ato shtëpi. Krahas njohjes së formësimit arkitektonik, konstruktiv e urbanistik të shtëpisë, rilevuesi njihet edhe me mënyrën e jetesës, traditat dhe zakonet e familjes që jeton aty. Një udhëtim nëpër kohë, i mundësuar përmes tregimeve të pronarëve apo fotografive të vjetra, na mundëson ta krijojmë një përfytyrim se si dukej shtëpia në të kaluarën. Prandaj, procesin e rilevimit, nuk duhet ta shohim vetëm si një detyrë teknike, por si një studim i një historie që ngërthen secili objekt. Në këtë mënyrë, këto shtëpi tradicionale, përmes prezantimit po përjetësohen dhe po e fitojnë mundësinë e promovimit edhe për të tjerë.

Documentation of a traditional house is a complex process where, besides attaining knowledge of measurement and documentation techniques, the life and inhabitation of the house is experienced. In addition to a technical knowledge of architectural, constructional and urban elements of the house, the researcher is also introduced to the way of life, tradition and habits of the family. Stories told by residents or old photographs which show the life of the house in the past transport the researcher back in time. The documentation process is not only a technical process, but is a survey of a history that encompasses each house.



PUNA NË ZYRE
OFFICE WORK



PREZENTIMI TOTAL STATION
TOTAL STATION PRESENTATION

Rilevimet e shtatë shtëpive gjatë këtij viti do të ishin të pamundura, pa qasjen pozitive të pronarëve të shtëpive, të cilët na kanë hapur dyert e jetës së tyre pa hezitim.

Grupet e studentëve gjatë matjeve në terren janë familjarizuar me anëtarët e familjes që jetonin nëpër shtëpi.

Gjatë procesit të rilevimit, është prezantuar kombinimi i mjeteve tradicionale të matjes me mjetet moderne: metra të dorës, vagres, metra llaserik, nivelmatës llaserik, aparatet fotografikë etj. Një prezantim i shkurtër është bërë edhe në lidhje me metodën e rilevimit përmes Total Station – metodë e avancuar e matjes digjitale.

Kombinimi i mjeteve të ndryshme të punës me punën e palodhshme të studentëve në terren, të mbikëqyrur nga profesionistët, kanë dhënë në fund një rezultat të mirë, që po prezantohet tani në këtë publikim.

The documentation of the seven traditional houses would have been impossible without the positive approach of the house owners, who opened the doors of their lives without hesitation, becoming friendly with the visiting students. During the documentation process, a combination of traditional working methods and modern tools were presented to students: classic meter rules, spirit levels, laser meters, laser spirit levels, cameras etc. A short presentation related to documentation methods with Total Station – an advanced method of digital measurement - was held.

Combining these methods with the students' hard work in the field and supervised by professionals, allowed the good results presented in this publication.

The process of graphic documentation is allowing these traditional houses to be recorded, celebrated and perpetuated, and paves the way for a similar appreciation of historic buildings throughout Kosovo.



PROFESHESH SHQIPE NIXHA
PROFESSOR SHQIPE NIXHA



PROFESSOR EMIN RIZA
PROFESSOR EMIN RIZA



PROFESHESH TEUTA JASHARI KAJTAZI
PROFESSOR TEUTA JASHARI KAJTAZI



GRUPI PUNUES
WORKING GROUP



GRUPI PUNUES
WORKING GROUP

Falëndërimet

Falënderime të veçanta shprehim për:

- Hasan Hotin – drejtor i IMM Pz
- Emsale Limani – dokumentariste në IMM Pz
- Lulzim Pllana – Universiteti Ndërkombëtar veror i Prishtinës
- Familjen Bajmaku
- Familjen Bërlajolli
- Familjen Kirajtani
- Familjen Mashkulli
- Familjen Mullafazliu
- Familjen Rekathati

Acknowledgments

We would like to give special thanks to the following contributors:

- Hasan Hoti – Head of IPMPz
- Emsale Limani – Secretary of IPMPz
- Lulzim Pllana – Head of PISU programme
- The Bajmaku family
- The Bërlajolli family
- The Kirajtani family
- The Mashkulli family
- The Mullafuliu family
- The Rekathati family

Ekipi realizues i projektit dhe i publikimit

Publikuar nga:	CHwB
Redaktor:	Nora Arapi
Parathënia:	Sali Shoshi
Koordinatorët e projektit:	Nora Arapi dhe Enes Toska
Bashkëpunëtorët:	Prof. Dr. Emin Riza Mr. Sc. Shqipe Nixha MA. Teuta Jashari Kajtazi
Hyrja, Përmbledhja dhe Vlerësimi:	Nora Arapi - CHwB
Ekipi mbikëqyrës nga IMMPz:	ida. Jusuf Xhibo Ida. Fikret Tikvesh
Ekipi mbikëqyrës nga CHwB-ja:	Besart Dajçi, Senat Haliti, Nol Binakaj
Përgatitja finale e punimeve:	Kujtesa Godeni
Fotografitë:	Studentët pjesëmarrës në rilevim, IMM Pz dhe CHwB
Përkthimi:	Jehona Valla dhe Nora Arapi
Lekturimi në gjuhën angleze:	MA. Crystal Whitaker
Lekturimi në gjuhën shqipe:	Mr.sc. Agron Gashi
Dizajn:	Frakton

Project and publication team

Published by:	CHwB
Editor:	Nora Arapi
Foreword:	Sali Shoshi
Project coordinators:	Nora Arapi and Enes Toska
Main contributors:	Prof. Dr. Emin Riza Mr. Sc. Shqipe Nixha MA. Teuta Jashari Kajtazi
Introduction, Summaries and Evaluation:	Nora Arapi
Supervising team from IPMPz:	i.d.a. Jusuf Xhibo i.d.a. Fikret Tikvesh
Supervising team from ChwB:	Besart Dajçi, Senat Haliti, Nol Binakaj
Final preparation of the drawings:	Kujtesa Godeni
Images:	Participating students, IPM Pz and CHwB
Translation:	Jehona Valla and Nora Arapi
Text editing in English:	MA. Crystal Whitaker
Text editing in Albanian:	Mr.sc. Agron Gashi
Design:	Frakton

Dokumentimi
i shtatë shtëpive tradicionale
në Prizren

Documentation
of seven traditional houses
in Prizren

Arkitektura

Tradicionale dhe Metodat
e Dokumentimit

Traditional

Architecture and Documentation
Methodologies

The Project was financed by:



Swedish International Development
Agency - SIDA

Dokumentimi i shtatë shtëpive tradicionale në Prizren

Documentation of seven traditional houses in Prizren

